



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Ekonomi”, me profil:
“Administrim Biznesi” dhe “Finance Kontabilitet”**

ofruar nga

“Kolegji Universitar i Biznesit”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Dorina Kripa
Prof. Asoc. Dr. Etleva Leskaj

Tetor / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Ekonomi”, me profil: “Administrim Biznesi” dhe “****Finance Kontabilitet”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “I Biznesit” (KUB)
2	Njësia bazë që e ofron:	Dep. Manaxhimi dhe Dep. Financë Kontabilitetit.
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Ekonomi me profile: “Administrim Biznesi” dhe “Finance Kontabilitet”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 651, datë 14.09.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	MASR Nr. 2062/3 Prot., datë 18.05.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMSR Nr. 9, datë 25.03.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr 74 date 27.10.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli parë Bachelor
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 (tre)vite/6 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të Plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Për vitin 2020-2021: 16 PAE/ 9 PAK 2021-2022: 19 PAE/ 10 PAK 2022-2023: 18 PAE/ 7 PAK
18	Numri i studentëve:	Nr. Financë viti 2021-2022: 33 2022-2023: 20 2023-2024: 18 Nr. Administrimi viti 2021-2022: 33 2022-2023: 40 2023-2024: 32
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar i Biznesit (KUB) është institucion i arsimit të lartë jopublik që ofron shërbime publike në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. KUB është krijuar në zbatim të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” bazuar në VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 “Për licencimin si Institucion i Arsimit të Lartë” me Urdhër Nr.3, datë 05.01.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, ka filluar aktivitetin akademik në fillim të vitit mësimor 2011-2012.

KUB e ka filluar aktivitetin e vet me emërtimin “**Akademia Profesionale e Biznesit**” me dy fakultete, Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Drejtësisë dhe në të dy ciklet e studimeve Bachelor dhe Master. Aktualisht, **Kolegji Universitar i Biznesit**, me urdher nr.39 date 30.01.2018 KUB është riorganizuar me urdhër e zhvilluar duke e zgjeruar misionin e vet edhe me një njësi tjetër kryesore siç është Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale, bazuar në urdherin Nr.139 date 23.03.2018


KUB ka realizuar akreditimin institucional në vitin 2012, akreditimin periodik në vitin 2017 dhe në vitin 2022, sipas kërkesave të Kodit të Cilësisë. Në këtë kuadër, KUB ka respektuar të gjitha kërkesat ligjore dhe standardet përkatëse për të ofruar vetëm programe studimi duke qenë një institucion IAL dinjitoz në tregun e arsimit të lartë dhe duke respektuar standardet e cilësisë në çdo drejtim. Për këtë arsye KUB ka kërkuar në vijimësi akreditimin dhe riakreditimin periodik duke realizuar me rigorizitet rekomandimet dhe duke informuar në lidhje me standardet si IAL. Fakulteti i ekonomisë, si njësi kryesore e KUB, ka krijuar eksperiencën e tij në ofrimin e programeve të kerkuara në tregun e punësimit, të standartizuar në përmbajtje e strukturë, duke qenë koherent me IAL kombëtare e ndërkombëtare si dhe i orientuar për bashkëpunim vetëm me IAL që ofrojnë programe të standardeve Evropiane në kuadrin e Kartës së Bolonjës, por edhe të kërkuar nga studentët.

Programi i studimit i ciklit të Parë Bachelor në “Ekonomi” me profilet : “Administrim Biznesi” dhe “Financë Kontabilitet” është program i ciklit të par në Fakultetin e Ekonomisë dhe ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit si njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë. Programi i studimit i hapur në bazë të Urdhrit Nr.3, datë 05.01.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, është akredituar në vitin 2012 dhe riakredituar me Urdhërin Nr. 562 datë 30.11.2018 dhe me Urdhër BA Nr 74 date 27.10.2018. Ai është program studimi i cili zgjat 3 vite akademike, i organizuar sipas kërkesave e standardeve europiane për lëndë e module me 180 kredite.

Ky program studimi ofron konsulencën dhe ekspertizën e vet në fushën e menaxhimit dhe të financës. Në thelbin e tij është konceptuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të vendit, strategjinë e KUB dhe misionin e tij.

Si i tillë ai shpreh lidhjen dhe harmonizim të plotë me:

- a. programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor;
- b. kërkesën e tregut të punës dhe të arsimit në vend;



- c. standardet Evropiane të Arsimit të Lartë;
- d. pjesën teorike, vetëstudimin dhe praktikën profesionale;
- e. kërkimin dhe hulumtimin shkencor;
- f. kërkesën gjithnjë në rritje të zhvillimeve kombëtare e ndërkombëtare.

Ky program studimi është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat dhe trendin e tregut të punës, perspektivën e zhvillimit të FE dhe orientimin kostant të KUB drejt ndërkombëtarizimit të veprimtarisë akademike dhe integrimin e të gjithë procesit në kuadër të programit Erasmus+.

Stafi akademik i FE ka të gjithë kapacitetin dhe potencialin e vet për të marrë të gjitha përgjegjësitë për zhvillimin dhe realizimin cilësor të këtij programi. Ai në funksion të objektivave të tij ka përfshirë stafine vet efektiv të brendshëm dhe të jashtëm, personalitete nga institucionet publike e private, duke ofruar mundësinë e një harmonizimi më të plotë të aktualitetit të tregut të punës duke u përshtatur drejt zhvillimeve të reja në këtë treg me disiplinat shkencore të programit.

Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe marrveshjet e bashkëpunimit të cilat kanë qenë e janë të orientuara në shërbim të arsimimit dhe veçanërisht komponentit të praktikës profesionale e materializimit të dijeve në aftësi direkt profesionale të studentëve.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit *“Bachelor ne Ekonomi” me profile: “Administrim Biznesi” dhe “Finance Kontabilitet”, është përgatitur nga ekspertët; Prof. Dr. Dorina Kripa dhe Prof. Asoc. Dr. Etleva Leskaj të asistuar edhe nga kordinatori ASCAL Znj. Rajna Lila.*

Për të hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) grupi i ekspertëve u mbështet në një sërë dokumentash që u aksesuan nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, të cilat ishin të përfshira në Dosjen e Vetëvlerësimit për këtë program studimi, të ofruar nga Kolegji Universitar i Biznesit (KUB).

Gjithashtu, informacionet dhe të dhënat e nevojshme për hartimin e këtij raporti u plotësuan edhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të ekspertëve gjatë vizitës në institucion, nëpërmjet intervistave të zhvilluara me personelin akademik dhe administrativ si dhe studentët e institucionit dhe dokumentave shtesë të kërkuara gjatë vizitës.

Për të bërë vlerësimin e jashtëm të programit, grupi i ekspertëve është mbështetur në kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.*

Për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, ekspertët kanë ndje

KUB një metodologji bazuar tek analizimi i dokumentave dhe përputhja e tyre me kriteret e kërkesat ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit te ciklit te pare Bachelor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e Planit Mësimor sipas aktiviteteve dhe planit mësimor të detajuar, shpërndarjes së krediteve dhe orëve krahasuar me kërkesat e VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik në lidhje me këtë program studimi, infrastrukturës në mbështetje të programit, sigurimit të brendshëm të cilësisë, mbështetjes së studentëve, etj.

Vizitat në institucion u krye në datat 23, 26.02.202 dhe, sipas axhendës së përcaktuar duke përfshirë; takimet me Rektorin/Dekanin e FE te institucionit KUB dhe Përgjegjësit e Departamentit te Manaxhimit dhe Dep. Finance Kontabilitetit, GVB, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Njesisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), sekretarisë mësimore, Zyrës Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), Zyrës Kërkimit Shkencor dhe Projekteve (ZKShP), Zyrës Burimeve Njerëzore (ZBNj), si dhe vizitat në mjediset e IAL-KUB (sallat e leksioneve, seminareve, bibliotekë, laboratorë, etj.).

Këto vizita, si dhe i gjithë procesi i vlerësimit të jashtëm nga ekspertët u asistua nga koordinatorja teknike e ASCAL znj. Rajna Lila.

Kolegji Uiversitar “I Biznesit”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 01.08.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 81 / 16 Prot, datë 01.08.2024. Kolegji Universitar “I Biznesit”, njofton në ASCAL më datë 23.09.2024, me anë të shkresës me Nr.417 Prot, datë 23.09.2024 *“Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”,* ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 74 datë 27.10.2018, "Për akreditimin e programit të ciklit të parë "Bachelor" në Administrim Biznes dhe Financë – Kontabilitet, ishin:

1. Përpara fillimit të vitit akademik 2019-2020 të rishikojë planin mësimor me qëllim diversifikimin sa më qartë të profileve Banka dhe Institucione Financiare dhe Financë Kontabilitet brenda hapësirave ligjore ekzistuese.
2. Institucioni të shohë mundësinë e shtimit të stafit administrativ me qëllim uljen e numrit të veprimtarive administrative të mbuluara nga stafi akademik

II. Plotësimi i Rekomandimeve nga Institucioni

KUB ka reflektuar ndaj rekomandimeve të Vendimit të Bordit Nr. 74 date 27.10.2018, "Për akreditimin e programit të ciklit të parë "Bachelor" në Administrim Biznes dhe Financë - Kontabilitet për të cilin ka hartuar një plan konkret masash për përmbushjen e rekomandimeve të cilët konsistojnë në:

Bazuar në informacionin e dhënë, institucioni ka përmbushur rekomandimet.

1. Institucioni ka bërë ndryshime në kurrrikula, por mungesa e studentëve ka bërë të mundur mos funksionimin e këtij Profil studimi ne "Banka dhe Institucione Financiare". Kjo ka bërë që IAL të marrë vendimin për të mos kërkuar akreditimin e këtij profili në këtë proces akreditimi.
2. Sa i përket shtimit të stafit administrativ, KUB ka pasur rekrutime për disa pozicione me staf me kohë të plotë në administratë. Aktualisht janë 3 sekretari mësimore, specialiste e burimeve njerëzore, koordinatorë e institucionit, punonjëse protokoll arkiv, grafik dizajner, ndihmës ekonomiste, punonjësi i librarisë dhe kancelarisë, sekretari i përgjithshëm, etj. Kjo tregon një përpjekje për të ulur barrën administrative mbi stafin akademik, siç ishte rekomanduar.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të ciklit të parë “Bachelor në Ekonomi” me profile:
“Administrim Biznesi” dhe “Financë Kontabilitet”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteri përmbushet plotësisht pasi kjo pasqyrohet në Strategjinë e zhvillimit Institucional, ku citohet se: “Programi është i orientuar drejt mbështetjes së zhvillimeve strategjike në sektorin e ekonomisë dhe biznesit në Shqipëri, në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Arsimit dhe me Planin Strategjik të Kolegjit Universitar të Biznesit për vitet 2021-2026’ dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit mbështetur në LAL 80/2015.</p> <p><i>Evidenca 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2021-2026.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>GVJ konstaton që kriteri përmbushet plotësisht pasi IAL funksionon me strategji zhvillimi, në misionin dhe vizionin e të cilit janë parashikuar se profilet e studimit janë përzgjedhur me qëllim që studenti të reflektojë kërkesat e tregut të punës dhe të plotësojë nevojat intelektuale në të ardhmen.</p> <p>Referuar Nenit 4 të Statutit të KUB mes të tjerash pjesë e misionit të KUB është: të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkenctarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standarteve të demokracisë në vend. b. të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojnë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, veprimtarive inovative e profesionale për fushën e Ekonomisë, Drejtësisë, teknologjisë së informacionit, si dhe të fushave profesionale teknike dhe administrative.”</p> <p>Për sa më sipër, duke iu referuar këtij misioni si dhe përmbajtjes së programit “Bachelor në Ekonomi” me profile: “Administrim Biznesi” dhe “Financë Kontabilitet”, GVJ është e mendimit se ky program është hartuar në përputhje me</p>

	<p>msionin e IAL për të zhvilluar dhe përcjellë dijetmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në fushën e ekonomisë.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i KUB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar Biznesit 2021-2026.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteri përmbushet pasi organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje të plotë me objektivat dhe strategjinë 21-26 të IAL Programi në “Ekonomi”, me profil: “Administrim Biznesi” dhe “Finance Kontabilitet” e zhvillon veprimtarinë e vet në bazë të një strategjie zhvillimi institucional dhe programor. Programi i studimit është hartuar në përputhje dhe në zbatim të Statutit Rregulloren e Përgjithshme dhe Rregulloren e Fakultetit e njësisë kryesore dhe rregulloren e programit.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i KUB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2021-2026.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteri përmbushet. KUB-i ka eksperiencë të gjatë në fushën akademike. Stafit akademik i cili është i përfshirë në fushën e mësimdhënies (Evidenca 72, tabela 4, tabela 6.2) plotëson kriteret ligjore lidhur me gradat dhe titujt akademik. Departamentet që zhvillojnë këtë program studimi kanë staf me grada Profesor, Profesor i asociuar, Doktor, si dhe Master i shkencave, duke plotësuar kërkesat ligjore (Evidenca 72 tabela 1).</p> <p>Konstatohet se njësia kryesore përbëhet nga tre njësi bazë, Departamenti i Financë Kontabilitetit, Departamenti i Manaxhimit dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe i Informatikës. Njësia kryesore përbëhet nga 22 staf me kohë të plotë dhe 20 staf me kohë të pjesshme. Nga të dhënat, rezultojnë se 42 staf me kohë të plotë dhe të pjesshme që ka fakulteti, 25 prej tyre janë të kategorisë “profesor” ose mbajnë</p>

	<p>gradën “doktor i shkencave”, çfarë demonstroi për kapacitet e duhura numerike dhe cilësore të burimeve njerëzore disponibël</p> <p><i>GVJ është e mendimit se struktura akademike e FE ka kapacitetin për të marrë të gjitha përgjegjësitë për zhvillimin dhe realizimin cilësor të këtij programi.</i></p> <p><i>Evidenca 31. Lista e Pedagogëve në KUB për Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 72. Tabelat Permbledhese Aneks_ RVB Bachelor ne Ekonomi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se përmbajtja dhe organizimi i studimeve janë ndërtuar në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Ekonomisë, me legjislacionin dhe me aktet ligjore dhe nënligjore shqiptare dhe ato evropiane (<i>Evidencat 2,4,5,7</i>)</p> <p>Referuar planit mësimor, GVJ konstaton se programi BA në Ekonomi me profile, është hartuar në përputhje LAL nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41, date 24.01.2018 dhe VKM nr. 418 datë 10.05.2017, si dhe udhëzimin e MASR nr. 1 date 14.01.2020, të cilat përcaktojnë standardet dhe procedurat për hapjen dhe funksionimin e programeve të studimit në arsimin e lartë. GVJ konstaton se fusha e përgjithshme-Ekonomi dhe ajo specifike e këtij programi studimi, që përcaktohet nga profilet administrim biznesi dhe finance-kontabilitet, rezultojnë, në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë dhe se me përmbajtjen e tij programi ofron njohuri teorike dhe praktike në fushat e menaxhimit të biznesit, financave dhe kontabilitetit.</p> <p>Sipas verifikimit (Evidenca 26) programi është kodifikuar me V.SA duke vijimësuar procedurën për dërgim dhe miratim nga organet vendimmarrëse.</p> <p><i>Evidenca 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "I Biznesit" 2021-2026.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit".pdf</i></p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FE.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 26. Shkresa dërguar në MAS për kodifikimin e programeve të studimit.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit ka vite që ofrohet nga IAL, ka kaluar një proces të mëparshëm vlerësimi dhe është në</p>

	<i>përputhje të plotë me interesat kombëtare, strategjitë zhvillimore si dhe me profilin dhe dokumentat strategjike të KUB.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Gjatë vizitës GVJ por dhe vlerësimit të DVV konstaton se për zhvillimin e programit ka një angazhim dhe sinergji të stafit dhe me njësitë e tjera në IAL Gjatë takimit me drejtuesin e njësive kryesore dhe të njësive bazë dhe stafit përgjegjës për programin e studimit u konstatua se përgjegjësitë dhe rolet sipas qëllimit dhe objektivave të programit njihen dhe zbatohen si dhe janë subjekt analize periodike për arritjen e tyre. <i>Evidenca 31. Lista e Pedagogëve në KUB për Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i> <i>Evidenca 21.3. Analiza Mësimore Kërkimore DM 2022-2023.pdf</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	GVJ konstaton se për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, KUB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione publike dhe private për zhvillimin e praktikave mësimore. Rezultojnë 182 organizata me të cilat janë nënshkruar marrëveshje. Mes tyre rreth 100 janë organizata biznesi ose institucione publike dhe rreth 45 janë institucione/IAL jashtë vendit. GVJ është e mendimit se këto marrëveshje bashkëpunimi i shërbejnë institucionit, për mundësi të zhvillimit të praktikave të studentëve, simundësi për kërkimin praktik për zhvillimin e temave të diplomës, apo për përafrimin e studentëve me tregun e punës. <i>Evidenca 30.1. Lista e marrëveshje të bashkëpunimi me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.pdf</i>



<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ konstaton se për realizimin e programit të studimit, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me biznese, institucione publike dhe shoqata si : Albsig, Agna, Shoqata e kontabilistëve të miratuar, Praktika.al, Deloitte dhe kompani të tjera, për realizimin e praktikave mësimore të studentëve (Evidenca 26; Evidenca 27).</p> <p><i>Evidenca 30.1. Lista e marrëveshje të bashkëpunimi me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës me drejtuesit e njësisë bazë, GVJ konstatoi se njësitë bazë ndjekin vijueshmërinë e pëfitueshmërisë nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të objektivave formuese teorike dhe sidomos ato të formimit praktik të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Ekonomi”, me profil: “Administrim Biznesi” dhe “Finance Kontabilitet”.</p> <p><i>Evidenca 30.3. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët për Programe e Projekte në kuadër të Erasmus +.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se IAL, KUB ka një sërë marrëveshjesh me institucione publike dhe private. GVJ është e mendimit se këto marrëveshje bashkëpunimi i shërbejnë institucionit, për mundësi të zhvillimit të praktikave të studentëve, si mundësi për kërkimin praktik për zhvillimin e temave të diplomës, apo për përafrimin e studentëve me tregun e punës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELORNE KUB.

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) të Programit të Studimit Bachelor në Ekonomi, me profil Administrim Biznesi dhe Financë Kontabilitet, në KUB (Tabelat e RVB), GVJ konstaton se ky program studimi është i organizuar në lëndë/module, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Struktura e këtij program studimi përfshin të gjithë elementët kyç, të përcaktuar në VKM Nr 41 datë 24.01.2018, VKM 879/2019 dhe Vendimin Nr 185 datë 25.03.2021, si dhe në rregulloret e FE, Rregulloren e departamentit FK, Departamentit MB dhe Rregulloren e programit Bachelor Ekonomi.</p> <p>GVJ vlereson se ky program, që i takon ciklit të parë të studimeve, organizohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në 6 semestra (2 për çdo vit), në gjuhën shqipe dhe vlerësohet gjithsej me 180 kredite. Lëndët janë të ndara sipas kategorive referuar përcaktimeve ligjore. Raporti i krediteve është i balancuar dhe me tendencë rritëse në fushat kyçe si administrimi, financat dhe kontabiliteti.</p> <p><i>[Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Finance Kontabilitet, kreu 4; Evidenca 6.1 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit, kreu 4; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi"; Tabelat përmbledhese të RVB]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, GVJ konstaton se programi i studimit "Bachelor në Financë-Kontabilitet" ofron për studentët mbulim të hollësishëm të teorisë dhe njohurive teknike, nxit të menduarin kritik, përgatit specialistë me njohuri akademike dhe praktike të fushës së administrimit të biznesit, financës dhe kontabilitetit, si dhe mundëson studimet dhe specializimin e mëtejshëm në këto fusha.</p> <p>Ky program studimi synon të pajisë studentët me një formim akademik bazë, të përqendruar në njohuri teorike, empirike dhe kompetenca kyçe për t'u përdorur në karrierën profesionale, si dhe aftësimin e tyre në administrimin efikas të organizatave të</p>

<p>përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>ndryshme të biznesit, në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare.</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit (tabela të RVB), GVJ konstaton se ky program studimi përveçse përmban lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, ofron mundësinë që studentët të profilizohen ose në Administrim Biznesi ose në Financë Kontabilitet duke ofruar module studimi më të fokusuara për profilet përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, nga shqyrtimi i planit mësimor, syllabuseve të lëndëve dhe informacionit të marrë në takimet me pedagogët dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se në tërësi lëndët e ofruara në këtë program studimi si edhe përmbajtja e tyre mundësojnë ndërthurjen dhe integrimin e njohurive në mënyrë të tillë që, nga ana teknike, e aftësojnë studentin të përgatitet për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e programit të studimit. Përmbajtja e syllabuseve të lëndëve, në perceptimin e stafit akademik dhe studentëve kishte mundësuar një kombinim dhe korrelacion të plotë mes njohurive teorike dhe atyre praktike. Studentët u shprehën të aftë për të përballuar probleme reale në punësimin e ardhshëm të tyre duke bindur GVJ për cilësinë dhe thellësinë e njohurive të marra në programin e studimit</p> <p>Programi i studimit është i përshtatur me zhvillimet aktuale në fushën e ekonomisë.</p> <p>Programi ofron baza të rëndësishme për një zhvillim dhe aftësim të mëtejshëm të studentëve me programin e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave Kontabilitet Finance" me profile Kontabilitet Auditim, dhe "Master i Shkencave Menaxhim Biznes" me profile Menaxhim Marketingu, Administrim Publik. Kjo është një mundësi e vlefshme për studentët që dëshirojnë të vijojnë studimet e tyre në nivel më të lartë dhe të specializohen më tej në fushën e ekonomisë.</p> <p><i>[Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi", neni 3, pika 1, 2]</i></p> <p><i>[Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit, KUBrikula e programit të studimit Bsc në "Ekonomi" 2020-2023; Planet Mësimore të programit të studimit Bsc në "Ekonomi" 2020-2023]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar</p>	<p>Programi i studimit "Bachelor në Ekonomi me profile në Administrim Biznesi dhe Financë Kontabilitet" përmban të gjithë elementët e nevojshëm të strukturës së një programi studimi sipas kuadrit rregullator në fuqi si KUBrikula dhe plani</p>

<p>lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>mësimor, programet e lëndëve (syllabuset), si dhe rregulloren e programit të studimit. GVJ, nga shqyrtimi i Rregullores dhe KUBrikulës përkatëse të Programit të Studimit Bachelor në Ekonomi me profile Administrim Biznesi (AB) dhe Finance Kontabilitet (FK) konstaton se Programi përfshin një strukturë të plotë dhe të detajuar disiplinash, e cila ndahet në 22 lëndë dhe 27 module. Programi ka një zgjatje normale prej tre vitesh akademike, dhe studentët grumbullojnë gjithsej 180 kredite në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Në planin mësimor të programit të studimit është përcaktuar klasifikimi i lëndëve dhe vlerësimi i tyre me kredite sipas tipologjisë së përcaktuar në VKM nr.41:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kategoria A - Lëndë Bazë me 32 ECTS zënë 18% të krediteve (brenda kufijve ligjorë 15% - 20% të krediteve); ▪ Kategoria B - Lëndë Karakterizuese me 92 ECTS zënë 51% të krediteve (brenda kufijve 50% - 55% të krediteve); ▪ Kategoria C - Lëndë Ndërdisciplinore me 21 ECTS zënë rreth 12% të krediteve (brenda kufijve 12% - 15% të krediteve); ▪ Kategoria D - Lëndë Plotësuese me 27 ECTS zënë 15% të krediteve (brenda kufijve 10% - 15% të krediteve); ▪ Kategoria E – Detyrime Përmbyllëse me 8 ECTS zë 4.5% të krediteve (brenda kufijve 3% - 5% të krediteve). <p>Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese janë përlogaritur duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është përlogaritur 25 orë pune e studentit, ku përfshihen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekte/detyra KUBsi dhe veprimtari të tjera formuese praktike brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p><i>GVJ vlerëson se përfshirja e lëndëve në secilën kategori është në përputhje të plotë me fokusin e çdo lënde, si dhe pesha e lëndëve për secilën kategori është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore.</i></p> <p><i>[Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit, 2.KUBrikula e programit të studimit Bsc në "Ekonomi" 2018-2023]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), pasi u njoh me Rregulloren e Programit të studimit dhe KUBrikulën e Programit të Studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Financë Kontabilitet dhe analizoi situatën në fakt, konstaton</p>

<p>profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>lehtesisht se cdo gje eshte ndertuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM Nr. 41/2018, të ndryshuar me VKM 879/2019. GVJ u siguria dhe konfirmon se KUBrikula përfshin elemente të rëndësishme si Praktika Profesionale dhe Detyrimi Final i Mbrojtjes së Diplomës, të cilat kontribuojnë ndjeshëm në strukturën e krediteve akademike: Praktika Profesionale me 12 kredite dhe Mbrojtja e Diplomës me 8 kredite.</p> <p>GVJ vlereson se Praktikrat Profesionale janë një aspekt kyç i këtij programi. Me ndarjen e studentëve në praktika merret drejtpërdrejt njësia bazë dhe ato realizohen në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të Kolegjit Universitar të Biznesit (KUB) me institucione, organizata apo biznese. Gjatë vizitës në IAL dhe dokumentacionit, KUB harton raporte për ecurinë e këtyre marrëveshjeve. Mbrojtja e praktikës zhvillohet në komision me 3 staf akademikë, gjë që rrit përfitueshmërinë dhe ndërgjegjësimin e studentëve për të hedhur më tej hapin e kërkimit punë në treg.</p> <p>Gjithashtu një vlerë shumë të veçantë ka dhe zhvillimi dhe mbrojtja e diplomës. Ajo realizohet me temë diplome ose me anë të një provimi, në varësi të notës mesatare (mbi 9) e studentit gjatë të tre viteve të studimit.</p> <p><i>GVJ konfirmon se praktika dhe diploma kanë materialet orientuese të zhvillimit të tyre për studentët. KUB i vlerëson shumë të dyja këto detyrime përmbyllëse, si një mundësi më shumë në përgatitjen e studentëve për të hyrë me sukses në tregun e punës, duke i pajisur ata me njohuri të thella dhe përvojë praktike të vlefshme në fushën e Administrimit të Biznesit dhe Financës Kontabilitet.</i></p> <p><i>[Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit, Rregullore e Programit;</i> <i>2.KUBrikula e programit të studimit Bsc në "Ekonomi" 2018-2023</i></p> <p><i>Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse</i> <i>ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi;</i> <i>Tabela 13 - Ngarkesa Totale në Auditor e Studentëve për</i> <i>Format e Mësimdhënie</i></p> <p><i>Evidenca 59. Udhëzues për përgatitjen e diplomës]</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e</p>	<p>Në raport me standardet dhe kërkesat e cilësisë, ky program studimi organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse njelloj, si dhe për studentët e zakonshëm.</p> <p>Në situatën reale, KUB nuk ka patur dhe nuk ka studentë me status të veçantë në kete program studimi.</p>

<p>arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Ky Kriter nuk aplikohet në KUB.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>KUB ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione të IAL në Shqipëri dhe një pjesë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ka kontribuar me opinione në hartimin e planit mësimor (KUBrikulës) dhe syllabuseve (programeve lëndore).</p> <p>GVJ vlerëson se plani mësimor i programit të studimit është hartuar bazuar edhe në KUBrikulat që ofrohen nga institucione të tjera të arsimit të lartë në vend dhe se në tërësinë e tij ky program studimi është i ngjashëm së paku në masën 70% - duke konsideruar të gjithë lëndët e planit mësimor (lëndët bazë, karakterizuese, me zgjedhje, praktikën dhe detyrimet përmbyllëse) me programet me emër të ngjashëm të ofruar në IAL të tjera në vendin tonë.</p> <p><i>Në KUB nuk ofrohen programe studimi të tjera të ngjashme brenda IAL-së.</i></p> <p><i>[Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit, Rregullore e Programit; Vizita në institucion.]</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Sipas analizës së rregullore së programit të studimit, GVJ konfirmon se Programi i studimit Bachelor ne Ekonomi me profile: Administrim Biznesid he Finance Kontabilitet, është program studimi i ciklit të parë të studimit, referuar nivelit të 6 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (shtojca 1, VKM 879); organizohet me 180 ECTS dhe kohëzgjatje normale tre vite akademike me kohë të plotë, i ofruar në gjuhën shqipe dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015.</p> <p>KUB ka realizuar kodifikimin e programit të studimit dhe e ka derguar per miratim në MAS.</p> <p><i>[Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi"; Evidenca 26. Shkresa dërguar në MAS për kodifikimin e programeve të studimit]</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Nga RVB dhe nga kontaktet e GVJ ne KUB, kostatohet se deri tani KUB nuk ka implementuar programe studimit në bashkëpunim me institucione të tjera. Megjithatë, aktualisht KUB është në një Fazë aktive të komunikimit me dy universitete me qëllimin e zhvillimit dhe ngritjes së programeve për Diploma të dyfishta të arsimit të lartë në të ardhmen. Këto bisedime po behen në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe synojnë të zgjerojnë dhe të pasurojnë ofertën akademike,</p>

	<p>si dhe të krijojnë më shumë mundësi për studentët në aspektin ndërkombëtar.</p> <p><i>[Evidenca 30.5. Marrëveshjet me Universitete e huaja për diplomat e dyfishta, Webster University, USA]</i></p>		
Konkluzione	<p>GVJ konfirmon se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>programi Bachelor ne Ekonomi me profile: Administrim Biznesi dhe Finance Kontabilitet ne KUB është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore si Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë; VKM Nr. 41/2018, te ndryshuar dhe Shtojcën me aktivitetet formuese, VKM nr 879/2019, VKM nr 185/2021, VKM nr 310 etj.</i> • <i>Programi zgjat 3 vite akademike dhe është i organizuar në 180 kredite, i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara me kredite dhe i kodifikuar.</i> • <i>Përmbajtja e planit mësimor është e ngjashme së paku 70% me programe me emër të ngjashëm të ofruar në IAL të tjera në vendin tonë.</i> • <i>Programi i studimit jep njohuri në nivel të specializuar të Administrim Biznesit, Financës, kontabilitetit, garanton punësimin dhe ekuivalentimin e transferimin e studimeve për shkak të hartimit të tij në një format të përputhshëm me aktet rregullatore në fuqi dhe në ngjashmeri me programe te tjera.</i> • <i>GVJ vlerëson dhe përpjekjet aktuale të KUB për zhvillimin e diplomave të dyfishta me IAL të huaja të rëndësishme.</i> 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për	GVJ nga analiza dhe vlerësimi i dokumentave në Dosjen e Vetevlerësimit konstaton se, KUB është IAL jopublike dhe është krijuar në zbatim të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” bazuar në VKM nr. 651, dt 14.09.2011 “Për licensimin si Institucioni Arsimit të Lartë” me

organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Urdhër nr. 3 dt 05.01.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

KUB ka filluar aktivitetin akademik në vitin mësimor 2011–2012 fillimisht me emërtimin “Akademia Profesionale e Biznesit” me dy fakultete, Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Drejtësisë, në të dy ciklet e studimit, Bachelor dhe Master.

Me urdhrin nr. 39, dt. 30.01.2018 është riorganizuar me emërtimin aktual Kolegji Universitar i Biznesit, duke shtuar edhe një njësi tjetër kryesore, Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale.

GVJ nga vlerësimi i tërësisë së Vendimeve të Akreditimit që gjenden në DVV, konfirmon se KUB plotëson kriteret ligjore pasi është akredituar institucionalisht në vitin 2012 (Urdhri nr 557), 2017 (Vendimi nr. 100) dhe 2022 (Vendimi nr.03). Vendimi i fundit i akreditimit është dhënë për katër vite deri në 06/01/2026 duke përmbushur këtë kërkesë ligjore për akreditim.

Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor ne Ekonomi me 2 Profile, është Fakulteti i Ekonomisë i cili, duke qenë i organizuar në 3 departamente si më poshtë, plotëson kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi sipas të cilit një njësi kryesore organizohet në të paktën tre njësi baze/departamente:

1. Departamenti i Menaxhimit
2. Departamenti i Financë dhe Kontabilitetit.
3. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës

Secili departament plotëson kërkesën ligjore për të patur në përbërje të tij të paktën tre anëtarë stafi akademik me gradë shkencore. Gjithashtu, një tjetër standard i rëndësishëm që respektohet është prania e të paktën shtatë pedagogëve me kohë të plotë (full time) në secilin departament.

Çdo departament është i angazhuar për të garantuar zhvillimin normal dhe efikas të procesit mësimor, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të vendosura nga IAL 80/2015, Neni 45.

GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë ofron gjithsej 8 programe studimi (tabelat në anekset e RVB): 3 programe studimi në nivelin bachelor, 3 programe studimi në Master i Shkencave, 2 programe studimi në Master Profesional.

Njësia bazë që ofron programin Bachelor ne Ekonomi është

Departamenti Manaxhim Biznesit dhe Departamenti Financë Kontabilitet. Departamenti Manaxhim Biznesit, ofron programet/profilet që kanë drejtimin e administrimit, manaxhimit, administrimit dhe marketingut, në të dy Ciklet e studimeve (Bachelor dhe Master). **Departamenti i Financë Kontabilitetit**, ofron programet /profilet e fushës së Kontabilitetit dhe Auditimit në të dy Ciklet e studimeve dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës, ofron programet/profilet e të dy Cikleve të studimit (Bachelor dhe Master), në fushën e Informatikës dhe Teknologjisë së Informacionit. Programi i studimit Bachelor në Ekonomi është akredituar në vitin 2012, në vitin 2018 dhe tani në proces në vitin 2024 për riakreditim.

GVJ vlereson se angazhimin e KUB për përfshirjen e pedagogëve me gradë dhe titull shkencor si titullarë të lëndëve në programin studimor “Bachelor në Ekonomi, me profilet: Administrim Biznesi dhe Finance Kontabilitet’

Gjithashtu, përsa i takon raporteve sasiore të ngarkesës së pedagogëve, në këtë program studimi, ngarkesa me staf efektiv për programin është rreth 80 % e Planit Mesimor.

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit

Kualifikimi i stafit akademik për DAP	2022-2023		2021-2022		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	2	1	2	1	3
Prof. Asoc.	1	2	1	1	1	1
Dr./PhD.	4	1	3	1	2	1
MSc.	2	1	2	3	3	4
Totali	7	6	7	7	7	9

Departamenti i Menaxhimit

Kualifikimi i stafit akademik për DAP	2022-2023		2021-2022		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	1	-	1	-	1
Prof. Asoc.	1	1	-	2	-	3
Dr./PhD.	2	-	3	2	3	3

	MSc.	5	3	4	1	4	1
	Totali	8	5	7	6	7	8
	<p><i>[Evidenca 1. Statuti i KUB, Evidenca 4. Rregullore e Njesisë Kryesore FE, neni 4; Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit; Planet Mësimore të programit të studimit Bsc në "Ekonomi" 2020-2023;</i></p> <p><i>Tabela 9 - Plani Mësimor i Ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E); Tabela 10 - Plani Mësimor për Programin e Studimit;</i></p> <p><i>Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Finance Kontabilitet, neni 6; Evidenca 6.1 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit, neni 6]</i></p>						
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>GVJ nga analiza e dokumentacionit të RVB konstaton se KUB ka angazhuar një ekip të kualifikuar të personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Ky personel përfshin specialistë me përvojë në fushat e ekonomisë, administrimit të biznesit dhe financës kontabilitet, të cilët kontribuojnë për monitorimin e mbarëvajtjes së aktiviteteve mësimore të lidhura me programin e studimit.</p> <p>GVJ vlereson se Praktikat Profesionale janë një aspekt kyç i këtij programi. Me ndarjen e studentëve në praktika merret drejtpërdrejt njësia bazë dhe ato realizohen në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të Kolegjit Universitar të Biznesit (KUB) me institucione, organizata apo biznese. Gjatë vizitës në IAL dhe dokumentacionit, KUB harton raporte për ecurinë e këtyre marrëveshjeve. Në perfundim të Praktikes, sipas paketes se dokumentave që shoqerojne studentin dhe sipas parashikimeve të Marrëveshjes së bashkëpunimit, Kompania pergatit raportin e realizimit të praktikës për studentin, e cila depozitohet pranë komisionit të mbrojtjes, ku me urdhër të posaçëm para tij do të bëhet prezantimi dhe vlerësimi përkatës. Mbrojtja e praktikës zhvillohet në komision me 3 staf akademikë, gjë që rrit përfitueshmërinë dhe ndërgjegjësimin e studentëve për të hedhur më tej hapin e kërkimit punë në treg.</p> <p>KUB vlerëson rregullisht cilësinë dhe efektivitetin e personelit ndihmës akademik dhe administrativ si dhe programet e praktikave mësimore.</p> <p>Nga kontaktet me studentet dhe stafi akademik konfirmohet se kryerja e praktikave dhe mësimdhënia në përgjithësi janë relevante, inovative dhe përgjigjen nevojave të vazhdueshme të sektorit të biznesit dhe financave.</p> <p>GVJ nga kontakti me Personelin ndihmës akademik dhe</p>						

	<p>administrativ informohet se ata kryejne trajnime per zhvillim profesional te tyre.</p> <p>Gjithashtu gjate vizites ne institucion, GVJ konfirmon perpjekjet e institucionit per sigurimin e hapësirave cilësore dhe moderne per praktika mësimore dhe laboratorike. Këto mjedise janë të pajisura me teknologji dhe pajisje të përshtatshme për të mbështetur mësimdhënien praktike, duke u mundësuar studentëve të përjetojnë situata reale të punës që reflektojnë sfidat dhe nevojat e sektorit të biznesit dhe financës.</p> <p><i>[Evidenca: Dosja e Programit te Studimit; Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi, Tabela 5 - Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese; Evidenca 55. Udhëzues për përgatitjen e Praktikës Profesionale, Marrëveshje bashkëpunimi për Praktikën Profesionale TIP; Vizita në institucion.]</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ sipas dokumentacionit të RVB-së dhe vizitës në institucion, konstatoi se për Programin Bachelor në Ekonomi me profilet AB dhe FK, koordinatori i programit është përgjegjës për të siguruar që programi i studimit të jetë në përputhje me objektivat akademike dhe profesionale dhe të përshtatet me nevojat e ndryshme të studentëve si dhe me tendencat e tregut të punës.</p> <p>Pyetur gjatë vizitës në Institucion, drejtues të tij u shprehën se rolin kryesor dhe të përditshëm të koordinatorit të programit të studimit e luan dhe vetë përgjegjësi i njësisë bazë që ofron programin. Në çdo rast funksionet dhe kompetencat e tij edhe si kordinator janë të parashikuara në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se Koordinatorin e programit është i dedikuar për përmirësimin e programit, në drejtim të cilësisë së mësimdhënies dhe përshtatjes me kushtet e tregut. Vëmendje e veçantë i dedikohet praktikave profesionale për të qenë sa më cilësore dhe në funksion të aftësisë të mëtijshme të studentëve.</p> <p>GVJ vlerëson se KUB siguron që, programi Bachelor në Ekonomi me profile në Administrim Biznesi dhe Financë Kontabilitet është i udhëhequr dhe i zhvilluar në mënyrë të efektshme dhe efikase, duke kontribuar në suksesin akademik dhe profesional të studentëve të tij.</p>



	<p>[Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Finance Kontabilitet, neni 9; Evidenca 6.1 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit, neni 9;</p> <p>Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomi me 2 profile: AB,FK]</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konfirmon se në KUB:</p> <ul style="list-style-type: none"> • njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, Fakulteti i Ekonomisë dhe njësia bazë DMB dhe DFK janë në përgjithësi të organizuara konform kërkesave ligjore në fuqi. KUB ka dy fakultete dhe një njësi kryesore tjetër, Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale. • Fakulteti i Ekonomisë ka tre departamente në përbërjen e tij, secili me minimumin 7 pedagogë staf akademik efektiv. DMB dhe DFK plotësojnë kriterin që të ketë të paktën 7 pedagogë akademikë efektivë nga të cilët të paktën 3 janë me tituj/grada. • Institucioni KUB dhe Fakulteti i Ekonomisë, si njësi kryesore kanë të angazhuar staf ndihmës akademik dhe administrativ për ndjekjen e praktikave mësimore dhe orëve laboratorike apo aktiviteteve të tjera të programit. • GVJ vlerëson vëmendjen e veçantë që KUB i dedikon praktikave profesionale për të qenë sa më cilësore dhe në funksion të aftësisht të mëtejshëm të studentëve. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ shqyrtoi dokumentacionin e Dosjes së Vlerësimit të Brendshëm për akreditimin e Programit Bachelor në Ekonomi me profilet; AB dhe FK, si: Rregullorja e Programit të Studimit, KUBrikulat e programit, Plani Mësimor i Programit të Studimit, Udhëzime për studentët, etj dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programit të studimit në KUB disponohen nga Fakulteti i Ekonomisë (njësia kryesore) dhe Departamenti Manaximi Biznesi dhe Financë Kontabilitet (njësi bazë) si edhe janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht.

	<p><i>GVJ konfirmoi publikimin e Rregullores dhe të Përmbajtjes së Programit të studimit dhe informacione të tjera rreth tij edhe në faqen e internetit të institucionit në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.</i></p> <p><i>[Evidenca 7: Rregullore e programit të studimit Bachelor Ekonomi me profilet: AB,FK; Evidenca 15 Plani Mësimor i Programit të Studimit]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë shqyrtimit të DVV, se elementët e rëndësishëm të programit të studimit janë parashtuar në Rregulloren e Programit të Studimit. Sipas kësaj rregulloreje (neni 4), shihet se ky program është i organizuar me 180 ECTS, në gjashte semestra dhe në tre vite akademike që kanë kohëzgjatje normale 30 javë dhe 60 kredite në cdo vit.</p> <p>Në fund të cdo semestri ka një sezon provimesh dhe në fund të vitit akademik ka një sezon vjeshte. Programi mësimor zhvillohet nga dita e Hënë deri në ditën e Premte të çdo jave (konfirmuar gjatë vizitës në Institucion) dhe jo më shumë se 25 orë mësimore në javë.</p> <p>Orari mësimor është përshtatur për të akomoduar nevojat e studentëve.</p> <p>GVJ konstaton se Plani mësimor i programit të studimit sipas rregullores, ofrohet në dy profile: Administrim Biznesi dhe Finance Kontabilitet dhe për çdo profil janë renditur lëndët përkatëse të vlerësuara në kredite.</p> <p>Çdo lëndë ka midis 5 dhe 6 kredite. Për të dy profilet parashikohet që në semestrin e gjashte të kryhen praktika mësimore me 12 ECTS dhe mikroteza ose provimi final me 8 ECTS.</p> <p>Plani mësimor përmban informacion të plotë në lidhje me orët në auditor dhe jashtë auditorit për secilën prej lëndëve.</p> <p>Sipas rregullores së programit të studimit, studenti është i detyruar të frekuentojë leksionet dhe seminarët jo më pak se 50% të tyre KUB se detyrimet e tjera duhet të shlyhen në masën 100%.</p> <p><i>[Evidenca 7: Rregullore e programit të studimit Bachelor Ekonomi me profilet: AB, FK; Evidenca 15 Plani Mësimor i Programit të Studimit]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret e përgjithshme të pranimit në programin e studimit Bachelor ne Ekonomi në KUB, kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë përshkruar në Rregulloren e këtij programi studimi.</p>



<p>që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregullore percaktohet detyrimi ligjor se, në kete program me profilet e tij pranohen studentë që kanë mbaruar me sukses studimet në shkollen e mesme dhe të kenë plotësuar Notën mesatare sipas VKM për këtë qëllim.</p> <p>Në lidhje me transferimet, në programin e studimit Bachelor ne Ekonomi, me profilet perkatese, në KUB kanë të drejtë të transferohen studentë nga institucione të tjera të arsimit të lartë vendase ose të huaja, publike ose private si edhe lejohet transferimi në dalje i studentëve të saj për në institucione të tjera të arsimit të lartë. Kushtet e realizimit te transferimit percaktohen sipas Udhëzimeve të përvitshme të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe në përputhje me Statutin, Rregulloren e Institucionit dhe Rregulloren për Ekuivalentimin. GVJ konstaton dhe vlerëson se, në lidhje me transferimet dhe ekuivalentimin e programeve të studimeve, KUB ka hartuar një Rregullore të posacme sipas së cilës ekuivalentimi kryhet nga një Komision i Ekuivalentimit të Studimeve, qe është një organ kolegjal me jo më pak se tre anëtarë në përbërjen e tij, nga një anëtar prej cdo njësi baze të çdo njësie kryesore në KUB. Përbërja e Komisionit miratohet nga Dekani i Fakultetit.</p> <p>Objekti i punës i Komisionit është ekuivalentimi i diplomave dhe programeve të plota apo të pjesshme të studimit.</p> <p>GVJ konfirmon se Rregullat e ekuivalentimit dhe dokumentat që duhet të dorëzohen nga studentët për të garantuar një process ekuivalentimi sa më të plotë dhe transparent, përshkruhen me hollësi në Rregulloren e Ekuivalentimit në KUB. Aktualisht programi i studimit ka pasur transferime në vitin akademik 2022 – 2023 (tabelat e RVB).</p> <p><i>[Evidenca 7. Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Ekonomi me 2 profile ; Evidenca. 48.1. Rregullore për Ekuivalentimin e Studimeve; Evidenca 48. Paketa e Regjistrimit të studentit Bsc_Ekonomi; Evidenca 72. Tabelat Permbledhese Aneks RVB]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe</p>	<p>Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar jo vetëm Planin Mësimor që është pjesë e tabelave të RVB, por edhe programet lëndore përkatëse të programit të studimit Bachelor ne Ekonomi në KUB të cilat janë pjesë e DVV. Referuar këtyre të dhënave GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me leksionet, seminarët, praktikat në auditor, orë laborator (nëse ka) në përputhje kjo me VKM nr.41 si edhe mënyrën e vlerësimit që ndiqet në çdo lëndë.</p>

<p>jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Komponentët formues të programit të lëndës, janë formuluar konform formateve të kërkuara sipas VKM nr. 41/2018 të ndryshuar nga VKM nr. 879/2019.</p> <p>Sipas tabelës përkatëse në RVB dhe konfirmuar nga GVJ, edhe në programet lëndore të programit të studimit, nota përfundimtare e studentit në kete program në KUB është rezultante e këtyre elementëve të vlerësimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive (10%+10% e vlerësimit), - detyrat e kursit (10% e vlerësimit), - testimet gjatë vitit (10% e vlerësimit) dhe - provimi përfundimtar (60% e vlerësimit). - Përqindja e rëndësisë për cdo komponent vlerësimi është e përcaktuar edhe në cdo syllabus, në përgjithësi konform edhe nenit te rregullores së programit të studimit. <p><i>[Evidenca 7. Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Ekonomi me 2profile; Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 14 - Model Syllabus, elementët sipas VKM Nr. 41/2018; Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit; Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve 2020-2023; Evidenca 9. Rregullore e zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, neni 6]</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konfirmon se sipas Rregullores së programit të studimit BSc Ekonomi në KUB, programi i studimit mund të rishikohet me kërkesë të njësisë bazë që ofron programin ose të zyrës së kurrikulave si rezultat i kërkesave të tregut të punës, dinamikave të brendshme, por edhe me kërkesë të secilit pedagog.</p> <p>Riorganizimi mund të parashikojë bashkime të lëndëve apo ndarje të tyre, pa cënuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në program. Njësia bazë ka të drejtën të propozojë ndryshime deri në masën 20% të krediteve të programit duke krijuar edhe profile. Këto propozime shqyrtohen nga dekanati dhe miratohen nga Senati akademik.</p> <p>Në RVB, GVJ konstaton ndryshimet e Planit Mësimor të cilat konsistojnë kryesisht në ndryshim dhe sistemim të krediteve, përvec një ndryshimi të lëndës dhe në gjykimin e GVJ janë në drejtim te përmirësimit të përmbajtjes dhe organizimit të programit të studimit.</p> <p>Përmirësimet dhe ndryshimet në programet dhe syllabuset e lëndëve kryhen me shqyrtim të thellë të të gjitha elementëve të</p>

	<p>tyre shqyrtim të thellë të të gjitha elementëve të tyre. Ky proces përfshin vlerësimin e literaturës bazë, ndihmëse dhe plotësuese, ndarjen e lëndëve dhe moduleve në semestra, përcaktimin e raportit mes orëve leksione/seminare dhe lëndëve, përdorimin e mjeteve didaktike të nevojshme, si dhe analizën e rezultateve të anketimeve të studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>GVJ krijoi bindjen se stafi akademik ka synim kryesor që të gjitha përmirësimet të reflektojnë zhvillimet e fundit në tregun e punës në fushën e ekonomisë. Për këtë arsye, ndryshimet në kurrikula dhe syllabuset janë të përcaktuara për të përmbushur standardet më të reja dhe të përditësuara në përputhje me nevojat aktuale.</p> <p>Permiresimet bëhen edhe për të përafuar kurrikulat e KUB me ato të IAL ndërkombëtare, me qëllim edhe mbështetjen e mobiliteteve të studentëve në kuadër të Programit Erasmus plus.</p> <p>GVJ gjithashtu pyeti stafin e angazhuar në programin e studimit në lidhje me praktikën e përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit dhe konfirmon angazhimin e vazhdueshëm të stafit në këtë drejtim.</p> <p>Kërkesa nga pedagogu i drejtohet përgjegjësit të departamentit dhe ndjek procedurën përkatëse.</p> <p>Institucioni është i hapur të përshtatet me kërkesat e pedagogut. Sipas stafit akademik, kurrikula është diçka dinamike që duhet të reflektojë ndryshimet e vazhdueshme në treg ose në profesion në mënyrë që të qëndrojë konkUBruese.</p> <p><i>[Evidenca 24: Ndryshimet ne kurrikula dhe miratimi nga MAS; Evidenca 72: Tabelat Permbledhese te RVB]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së kriterëve të këtij standardi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>ky program studimi paraqitet i detajuar me elementet përkatëse të kërkuara në kuadrin ligjor dhe është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të pare bachelor niveli 6 i kualifikimeve sipas Kornizës të KSHK.</i> • <i>Ai është një program me 180 ECTS i shtrirë në gjashtë semestra dhe tre vite akademike me 15 javë secili. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim të vazhdueshëm sipas një procedure të parashikuar në rregulloren përkatëse dhe që sipas konfirmimeve të GVJ ndiqet në mënyrë rigoroze dhe së cilës i kushtohet vëmendje e posacme nga profesorati.</i>

	<ul style="list-style-type: none"> • Programi dhe plani mësimor kanë informacione mjaftueshëm për studentët, lidhur me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë. • Rregullorja e Programit ka të përcaktuara qartë kriteret e pranimit, transferimit, ekuivalentimit të studimeve. Në rregulloren e programit parashikohet dhe zbatohen rregullat, procedurat dhe modalitetet e përmirësimeve të Programit të lëndëve dhe krejt programit të studimit. • Programi ka informon e nevojshme për secilën lëndë (Syllabuset e lëndëve), sa orë janë në auditor leksione, seminare, sa praktike, laboratore etj. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së Planit Mësimor të programit të studimit (në tabelat e RVB), dhe përmbajtjes edhe të syllabuseve të vecanta, GVJ mund të konfirmojë se programi i studimit përfshin një gamë të pasur lëndësh të ndryshme të formimit të nevojshëm profesional dhe njohuri në disiplina të lidhura me administrimin e biznesin, financën dhe kontabilitetin dhe disiplina mbështetëse të tyre.</p> <p>Ne gjykimin e GVJ, Veprimtaritë e parashikuara në cdo lëndë, mundësojnë formimin teorik dhe praktik të nevojshëm të studentëve në funksion të punësimit të tyre, por edhe në vazhdimësinë e mëtejshme të studimeve. GVJ nga takimet me stafet konfirmon se Departamenti i Financë Kontabilitetit (DFK) dhe Departamenti i Menaxhimit (DM) kujdeset për ofrimin e lëndëve dhe moduleve bazë dhe karakterizuese, të cilat arrijne mbi 70% të programit të studimit.</p> <p>Nga takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës rezulton se kjo zyrë informon studentët për mundësitë në tregun e punës dhe duke mbledhur kërkesat e punësimit të tyre, duke i ndihmuar ata në procesin e gjetjes së punës dhe përshtatjes me kërkesat e tregut të punës. Edhe stafi akademik ndihmon në përmirësimin e aftësive të studentëve</p>

	<p>drejt kërkesave të tregut. Kështu nga takimet me stafin, GVJ vlerësoi këmbënguljen e pedagogëve të lëndës Shkrim akademik dhe të lëndës Sociologji, me qëllim që që në vitin e parë të studimeve, studentët nxiten për shfrytëzimin e bibliotekës dhe mënyrat e përdorimit të bibliotekave online. Gjithashtu studentët përfshihen në kërkimin shkencor, me pjesëmarrje me punime të përbashkëta në konferenca të zhvilluara nga KuB. Gjithashtu, stafi akademik ndihmon studentët me rekomandimet dhe udhëzimet në lidhje me mundësitë e punësimit dhe i ndihmon ata në gjetjen e punës në kompani të ndryshme.</p> <p><i>[Evidenca 5. Plani Mësimor i programit të studimit; Evidenca 54. Te dhena per diplomimin dhe Punesimin e studenteve]</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ, nëpërmjet njohjes dhe analizës së dokumenteve të Dosjes së RVB, konfirmon se Objektivat formues specifike të programit të studimit janë listuar në Rregulloren përkatëse dhe janë formimi i specialistëve të lartë në fushën e administrimit dhe biznesit, të Financës dhe Kontabilitetit; dhënia e eksperiencës së nevojshme për të mundësuar formimin e profesionistëve të aftë; thellime në disiplina si planifikimi dhe manaxhimi i burimeve dhe performanca e elementëve të bizneseve, të financës dhe të kontabilitetit dhe të raportimit financiar apo të disiplinave mbështetëse të tyre si manaxhimi i SME, manaxhim operacionesh, burimet njerezore, formimi i përgjithshëm i figurës së profesionistit të lartë me etiken profesionale dhe të biznesit etj.</p> <p>Një përforsim më i detajuar i këtyre objektivave formuese përsëritet në trajtën e rezultateve të të nxënit në çdo program lëndor.</p> <p>Nga shqyrtimi i KUBrikules dhe Planit Mesimor dhe shpërndarjes së lëndëve në vite e semestra dhe nga organizimi i tyre, GVJ formoi bindjen se, në këtë formë që paraqiten, Plani Mësimor mundëson arritjen e objektivave formues të programit.</p> <p>Ky program i ciklit të parë organizohet në 6 semestra dhe 3 vite akademike. Ngarkesa javore është deri 25 orë mësimore në javë dhe viti akademik zgjat 30 javë mësimore.</p> <p>Të dyja departamentet që mbulojnë këtë program studimi, kontribuojnë aktivisht në arritjen e objektivave specifike të programit, të cilat janë hartuar për të zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca të caktuara tek studentët. Çdo vit akademik, Departamentet realizojnë një analizë vjetore e cila shërben si bazë për rishikime dhe përmirësime të elementëve të ofrimit të</p>

	<p>programit të studimit.</p> <p><i>[Evidenca 72: Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 12 Plani Mësimor i programit të studimit; Evidenca 7. Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Ekonomi me 2profile; Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit; Dosja e Syllabuseve.]</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi tabelat e RVB, Planet Mësimore të cdo periudhë të përfshirë në akreditim dhe ndryshimet përkatëse gjatë periudhës, si edhe programet lëndore të lëndëve të ofruara në programin e studimit në KUB, konfirmon se struktura e programit, lëndët e përfshira në të dhe raportet mes torisë dhe praktikës janë të përshtatshëm për profilet administrim biznesi dhe finance kontabilitet.</p> <p>GVJ qartësohet se emërtimi i lëndëve të programit të studimit, përmbajtja e tyre dhe literatura e parashikuar është e ngjashme me programe studimi ndërkombëtare në fushën e administrimit, manaxhimit dhe finances e kontabilitetit.</p> <p>Të dyja departamentet që mbulojnë këtë program studimi, kontribuojnë aktivisht në aspektin e rishikimit të KUBrikulës, evidentojnë nëse elementët janë në përputhje me LAL dhe udhëzimet përkatëse dhe me standartet e univerisiteteve ndërkombëtare dhe europiane.</p> <p>Çdo vit akademik, Departamentet realizojne një analizë vjetore e cila shërben si bazë për rishikime dhe përmirësime të elementëve të ofrimit të programit të studimit.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion me studentët, GVJ u informuan se ata shprehen në lidhje me përmbajtjen e lëndëve dhe njohuritë e transmetuara nga profesorët e lëndëve i bënin të sigurt për të përballuar kërkesat e punës.</p> <p><i>[Evidenca 72: Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 12 Plani Mësimor i Programit të Studimit BSc Ekonomi me 2 profilet; Evidenca 21.1 Analiza Mësimore Kërkimore Fakulteti i Ekonomisë 2022-2023; Evidenca 21.2 Analiza Mësimore Kërkimore DFK 2022-2023; Evidenca 21.3 Analiza Mësimore Kërkimore DM 2022-2023]</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e</p>	<p>GVJ nga analiza e dokumentave te Dosjes se Programit te studimit, konfirmon se Struktura e programit Bachelor ne Ekonomi me 2 profilet dhe ndarja e veprimtarive formuese dhe ngarkesa totale në auditor paraqiten si në tabelat e RVB.</p>

<p>objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Raporti Teori (leksione) / Praktikë (sem+usht+proj+prakt. Prof) afërsisht është në favor të praktikës. (40% / 60%.) Këto raporte me fokus veprimtaritë praktike, si kryerja e seminareve, praktika mësimore dhe përgatitja e diplomës, çka u mundëson studentëve të formohen nga ana profesionale, të zgjerojnë njohuritë e tyre dhe të arrijnë objektivat e të nxënimit në këtë program studimi duke garantuar aftësimin për punësimin e tyre.</p> <p>Në dijeninë e GVJ duke qenë se kjo shpërndarje e veprimtarive formuese është e ngjashme edhe me programe të tjera studimi me të njëjtën fushë apo fokus, bën të mundur transferimin e studimeve dhe lehtësimin e kryerjes së mobilitetit të studentëve.</p> <p>Komisioni i Transferimeve dhe Ekuivalentimit merret me vlerësimin e dokumentacionit dhe njohjen e lëndëve me ekuivalencë, përcakton vitin që do të ndjekë studenti në përputhje me lëndët dhe kreditet e fituara, si dhe vendos detyrimet që do të ketë studenti nëse pranohet.</p> <p>GVJ vlerëson se Vendimi i komisionit dhe lehtësimi i procesit të transferimeve dhe ekuivalentimeve çon në shtimin e mundësive për mobilitet të studentëve dhe mundësisë për punësim në përfundim të studimeve.</p> <p><i>[Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e Studentëve; Tabela 23 - Të dhëna për Diplomimin dhe Punësimin e Studentëve; Evidenca 48.2. Model TIP për Vendimin e Komisionit të Ekuivalentimit]</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Sipas RVB për këtë pikë përmirësimi i syllabuseve është një përgjegjësi e drejtpërdrejtë e pedagogëve të lëndës të cilët duke u nisur nga eksperiencia e tyre apo literatura të reja me të cilat përballen mund të përmirësojnë vazhdimisht përmbajtjen e lëndëve, natyrisht pa cënuar qëllimin dhe objektivin e lëndës.</p> <p>Nga ana procedurale GVJ konstaton se në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në ekonomi në KUB, parashikohet që programi i studimit mund të rishikohet me kërkesë të njësisë bazë që ofron programin ose të zyrës së KUBrikulave dhe si rezultat i kërkesave të tregut të punës, e dinamikave të brendshme.</p> <p>Më tej, nga shqyrtimi më i detajuar që GVJ u bëri përmbajtjes së dosjes së syllabuseve, u konstatua se këto syllabuse në</p>

	<p>përgjithësi garantojnë marrjen e aftësive në përputhje me kërkesat e tregut të punës për profesionistë të administrimit të biznesit, si dhe për ata të finances e kontabilitetit.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ gjithashtu dëshmoi angazhimin serioz të profesoratit në drejtim të të qenit gjithmonë të përditësuar përsa i përket kërkesave të këtij programi. Nga takimi me stafin, u identifikuan raste të përditësimit të syllabuseve nga pedagogët e lëndës në lidhje me: përfshirjen e një teme të re për shembull tema E-government, në lëndën Manaxhimi publik; apo përditësimi me aftësitë dixhitale apo me praktika në laborator, i lëndës Informatike; apo përditësimi me përdorimin e platformave dixhitale në lëndën Tregje Financiare, si dhe përfshirjen e temës për Kriptomonedhat, etj.</p> <p>Gjithashtu, GVJ nga vizita ne biblioteke krijoi bindjen se literatura bazë dhe ndihmëse ishte kryesisht e viteve të fundit, nga autorët më të njohur në vend në fushat e manaxhimit dhe financës dhe kontabilitetit dhe paraqitet cilësore dhe e përditësuar me elementet e nevojshme për marrjen e njohurive kritike në manaxhim, financë e kontabilitet. Çdo vit ne KUB alokohen 200-300 mijë lekë për blerje librash.</p> <p><i>[Evidenca 72: Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 12 Plani Mësimor i programit të studimit; Evidenca 7. Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Ekonomi me 2profile; Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit; Dosja e Syllabuseve. Evidenca 39. Relacioni Buxhetit per fondin e blerjes se Librave te rinj]</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Në gjykimin e GVJ dhe mbështetur në njohurinë dhe formimin e tyre, përmbajtja e programit të studimit Bachelor ne Ekonomi me 2 profilet në KUB dhe elementet e tij garantojnë plotësisht përfitimin e dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave të synuara sic edhe janë formuluar në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>GVJ vlereson se Lëndët e ofruara në program garantojnë që studentët të mund të marrin njohuri teorike dhe praktike në fusha të përgjithshme të administrimit dhe biznesit, te finances dhe kontabilitetit, si edhe njohuri specifike psh në lidhje me manaxhimin e burimeve njerezore, taksimin, etikën në biznes dhe ne profesion, drejtimin financiar, tregjet financiare, kontabilitetin publik, etj, të cilat rrisin aftësitë dhe kompetencat e parashikuara në objektivat e programit të studimit.</p>

	<p><i>[Evidenca 72: Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 12 Plani Mësimor i programit të studimit; Evidenca 7. Rregullorja e programit të studimit Bachelor ne Ekonomi me 2profile; Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit; Dosja e Syllabuseve.]</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga analiza e përmbajtjes së programit të studimit Bachelor ne Ekonomi në KUB, GVJ konstaton se ky program, në mënyrën sesi është organizuar dhe strukturuar jep mundësinë që studentët që e përfundojnë atë të mund të zgjedhin midis dy mundësive, ose vijimin e mëtejshëm të studimeve në programet Master i Shkencave apo Master Profesional, apo studime tjera brenda dhe jashtë vendit; ose punësimin në përshtatje me profilin dhe pritshmëritë e tregut të punës për të punuar si punonjës në shërbim të administrimit dhe manaxhimit, të financës apo të kontabilitetit, në biznese të ndryshme, në organizata jofitimprurese, në administratën publike, në zyra dhe studio profesionale finance, kontabilitet auditimi, etj.</p> <p>GVJ nepermjet te dhenave ne Tabelat permbledhse per Programin e studimit, te kontakteve ne IAL, me studentet, departamente dhe Zyren e studentit dhe keshillimit te karrieres, konstaton se niveli i njohurive teorike e praktike qe student kane marre ne kete program studimi, iu mundeson atyre te ndjekin normalisht studimet ne Programin Master 60-70% te numrit te studenteve qe perfundoje ciklin Bachelor. Pjesa e mbetur kalojne ne Tregun e punes si profesioniste te fushave perkatese, prene kompanive, bizneseve, OJF dhe entiteteve te Sektorit Publik, duke shfrytesuar Marrveshjet e Bashkepunimit me partneret e KUB, si dhe Platformat e ndryshme qe kontribuojne ne procesin e punesimit te studenteve, si GRADUA ku bashkohet Oferta me Kerkesen e Tregut te Punes per studentet e sapodiplomuar etj.</p> <p><i>[Evidenca 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2021-2026, pika 1.1; Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e Studentëve; Tabela 23 - Të dhëna për Diplomimin dhe Punësimin e Studentëve; Evidenca 30.6. Marrëveshje bashkëpunimi KUB-UBT; Evidenca 69. Marrëveshje bashkëpunimi dhe regjistrimin në Platformën GRADUA]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së këtij standardi GVJ shqyrtoi me vëmendje organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e elementeve të programit të studimit Bachelor</i></p>

	<p>ne Ekonomi me profilet: Administrim Biznesi dhe Finance Kontabilitet, shpërndarjen mes veprimtarive formuese, shpërndarjen kohore, syllabuset e lëndëve dhe përputhshmërinë e tyre me synimet dhe misionin e programit të studimit, për sigurimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p>GVJ në mënyrë të përmbledhur pas analizës dhe vlerësimit të dokumentacionit, por edhe nga takimet gjatë vizitave në KUB me studentët, stafin akademik, zyrat përkatëse, duke vlerësuar Marrëveshjet e formalizuara dhe marrdhëniet e ndërtuara me partnerët brenda dhe jashtë vendit, për kryerjen e Praktikave profesionale dhe në kuadër të Mobiliteteve; si dhe duke vlerësuar dhe Raportin e Diplomimeve dhe Punësimet e Studentëve dhe Listat e studentëve që ndjekin studimet në Programet Master kryesisht në KUB, del qartazi konkluzioni se, Programi i Studimit Bachelor në Ekonomi, me profilet Administrim Biznesi dhe Financë Kontabilitet, plotëson objektivat dhe pritshmëritë e tij në nivelin më të mirë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Sic theksohet në RVB të përgatitur nga KUB për këtë kriter, përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së programit të studimit është në fokus të vëmendjes dhe orientohet nga zhvillimet e tregut.</p> <p>Zakonisht ky proces kryhet çdo vit akademik në bazë të vlerësimeve të studentëve por edhe të partnerëve me të cilët KUB ka Marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave mësimore dhe mundësive të punësimit të studentëve, me të cilët konsultohen edhe nevojat e përmirësimeve që i duhen bërë Programeve të studimit.</p> <p>GVJ e ka verifikuar këtë proces të punës që kryhet për përmirësimin e programit të studimit edhe gjatë vizitave në IAL.</p> <p>GVJ konfirmon se gjatë vizitës në Institucion, janë pyetur përfaqësues të departamenteve të cilët u shprehën se përditësimi i përmbajtjes së programit ishte një aktivitet periodik dhe në një farë mënyre i detyruar nga kërkesat e</p>

	<p>tregut dhe studentëve të programit të cilët vijnë nga eksperiencia praktike në profesion.</p> <p>Perditesimi dhe permiresimi i materialeve mesimore bëhet në ndjekje të përmirësimit të vazhdueshëm të profesionit edhe për shkak se një pjesë e mirë e stafit akademik te ftuar (PAK), janë përfaqësues me emër në fushat profesionale, si të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit por edhe të Manaxhimit dhe Administrimit në biznes, të punës në organizata jofitimprurese apo në sektorin publik në vend. Drejtues të Institucionit u shprehën gjithashtu se ruajtja e kontakteve të vazhdueshme me institucionet partnere me të cilat KUB ka marrëveshje bashkëpunimi, është një praktikë e zakonshme dhe me interes.</p> <p>Në fund të çdo viti akademik, KUB mbledh dhe analizon vlerësimet e bëra nga partnerët dhe studentët e vet, për të identifikuar ku programet e studimit mund të përmirësohen dhe të përshtaten më mirë me kërkesat e tregut.</p> <p><i>[Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 5 - Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese] [Dok. 55. Udhëzues për përgatitjen e Praktikës Profesionale;</i></p> <p><i>Raport mbi kryerjen e Praktikës Profesionale; Marrëveshje bashkëpunimi për Praktikën Profesionale_TIP; Urdhër dekani për ndjekjen e praktikave mësimore; Tabela e vlerësimit të Praktikës Profesionale]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin KUB ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ, nga analiza dhe vlerësimi i dokumentacionit mbështetës dhe RVB e përgatitur nga KUB lidhur me këtë kriter konstaton se në KUB, përmenden shumë fakte dhe dokumenta që konfirmojnë, angazhimin e studentëve si përfaqësues në Senatën Akademi, anëtarë të NJSBC, anëtar në Grupet e Punës për hartimin e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm, për akreditimet e Programeve dhe Institucionit, etj. Ndërkohë të gjithë studentët përfshihen për të dhënë mendimet dhe propozimet e tyre për përmirësimin e Programeve të studimit, nëpërmjet pyetësoreve të përgatitura çdo vit nga NJSBC.</p> <p>GVJ shqyrtoi Rregulloren e NJSBC dhe në nenin 4, pikat 2, 3 dhe 4 ndeshi evidencë për parashikimin e procedurës së vlerësimit të programeve të studimit mbështetur edhe tek sondazhet me studentët. Gjithashtu një raport përmbledhës mbi analizën e sondazhit bazuar tek studentët dhe kryer nga IQE ishte pjesë e DVV. Sipas këtyre dokumenteve dilnin në</p>

	<p>pah perceptimet e studentëve në lidhje me procedurat mësimore të programit të studimit Bachelor ne Ekonomi, me profile; AB dhe FK.</p> <p>Stafi akademik i programit të studimit i pyetur gjatë vizitës në Institucion, u shpreh se ruhen kontakte dhe kryhen takime me studentët te alumnit të KUB, të cilët rezultojnë të punësuar mbi 90% në profesion.</p> <p>Të gjitha konstatimet mbi eksperiencat e para të punësimit, përballjet dhe sfidat profesionale, që has çdo student në fillimet e punësimit, parashtrihen dhe diskutohen në takimet që realizohen edhe me strukturat drejtuese të DFK, DM dhe stafet akademike.</p> <p><i>[Evidenca 14. Rregullorja e NJSBC; Evidenca 41. Raport per rezultatet e analizes se Pyetesorit te studenteve; Evidenca 44. Raporti nga IQE Evidenca 58.1 Emerimi Isa Llanaj ne Senatin Akademik; Evidenca 54. Raport per punësimin e Studentëve /Alumni në KUB 2022-2023]</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se gjatë aktiviteteve të ndryshme si tryeza të rumbullakta, workshop-e e takime me sipërmarrës, profesionistë të fushës dhe drejtues të institucioneve publike, DFK dhe DM angazhohen edhe për përmirësimin dhe përditësimin e programeve të studimit në përputhje me zhvillimet e reja në fushën e studimit dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p>KUB ka marrëveshje bashkëpunimi me partnerë të ndryshëm si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, industria e Bizneseve Italiane në Shqipëri, Megatek, Delta Group, etj. Konsultimet me këta partnerë janë thelbësore për të siguruar që programet e studimit janë të përshtatshme me kërkesat aktuale të tregut dhe për të përfshirë zhvillimet e reja në fusha të ndryshme.</p> <p>KUB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me studio e zyra profesionale, qendra, shoqata, IAL publike dhe jopublike prane të cilave realizojnë kryerjen e praktikave profesionale studentë të programit të studimit Bachelor në Ekonomi. Këtu përmendim disa partnerë me të cilët KUB ka lidhur marrëveshje të fushës së Ekonomise Finances Kontabilitet, tek të cilët studentët tanë kryejnë paktikat mësimore janë si më poshtë: Bilanc Shpk, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptar, organizata IEKA, SHKM, KKK si dhe disa kompani e studio profesionale shërbimesh profesionale kontabiliteti dhe raportimi financiar</p>



	<p>GVJ konstaton nga dosja e CV e stafit të angazhuar në këtë program studimi, PAE por sidomos PAK, një pjesë e tyre janë anëtarë të rrjeteve profesionale dhe shoqatave me emër në kontabilitet dhe auditim në vendin tonë. Përfshirja e stafit cilësor mundëson shfrytëzimin e lidhjeve të tyre në funksion të përshtatjes sa më të afërt të përmbajtjes së programit të studimit me kërkesat e tregut.</p> <p>Në të vërtetë, GVJ vlerëson që stafi akademik cilësor dhe lider në fushën e kontabilitetit dhe auditimit në vend është një ndër pikat më të forta të këtij program studimi. Profesorë PAK në program janë pjesëtarë të organizmave politikëbërëse të kontabilitetit dhe auditimit në vend si Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, ose shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit.</p> <p>Përgjatë kryerjes së këtyre praktikave, të gjithë bashkëpunëtorët partnerë përcjellin propozime të konstatuara praktikisht të cilat reflektohen në syllabuset individuale të lëndëve/moduleve apo edhe në KUBrikulën e programit të studimit.</p> <p><i>[Evidenca 22. Studimi i Tregut të Punës për Programin e Studimit Bsc në Ekonomi; Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 5: Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese Evidenca 15: CV e Stafit akademik për programin BSC Ekonomi]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi përmbajtjen e DVV dhe për më tepër pas kontakteve me stafin dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion, shprehet për përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</p> <ul style="list-style-type: none"> • KUB është i angazhuar në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të KUBrikulave të të gjitha programeve që ai ofron duke u konsultuar me përfaqësues të tregut dhe biznesit, të cilët kontaktohen gjatë aktiviteteve të ndryshme të përbashkëta institucionale. • KUB gjithashtu reflekton kërkesat për përmirësim të programit nga studentët aktualë dhe të diplomuar të cilët duke qenë në një masë të madhe të diplomuar në profesion, paraqiten si një trysni positive ndaj KUB që ky i fundit të përmirësojë pa reshtur KUBrikulat e tij. • Së fundmi, bashkëpunimi i pasur i Institucionit me shoqata dhe rrjete profesionale të fushës garanton maksimumin e cilësisë përse i perket përmirësimit në vijimësi të programit të studimit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e KUBsit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>GVJ, Mbështetur në Dokumentacionin e Dosejes së RVB, kryesisht në Rregulloren e Programit të studimit, KUBrikulat dhe Planet mësimore të Programit të studimit Bachelor në Ekonomi, me profile: Administrim Biznesi dhe Finance Kontabilitet dhe syllabuset e lendeve/moduleve perkatese, konstaton se: Veprimtaria mësimore zhvillohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe në bazë të dokumenteve të rëndësishme të institucionit si Statuti, Rregulloret e ndryshme të fakulteteve dhe departamenteve, dhe në veçanti, me Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomi. Ky program përfshin zbatimin e një plani mësimor të përshtatur për këto profile, duke pasur parasysh nevojat dhe objektivat specifike të fushës së ekonomisë.</p> <p>GVJ konfirmon se gjatë procesit mësimor, aplikohen elementë të ndryshëm formues për studentin, përfshirë leksionet, seminarët, ushtrimet, projektet, detyrat e KUBsit, praktikat profesionale, detyrat me shkrim dhe provimet. Veçanërisht vemendje i jepet mësimdhënies interaktive dhe të orientuar drejt studentit, me qëllim nxitjen e mendimit kritik dhe krijues. Ky model mësimor shtrihet në një gamë të gjerë formash, duke përfshirë edhe leksionet e hapura me personalitete të ftuar të fushës së ekonomisë. Gjithashtu lëndët pasurohen edhe me raste studimi për ndërtimin e kopetencave të studentëve; me aftësimin dixhital përmes përdorimit të platformave të</p>



	<p>ndryshme financiare dhe programuese, etj. <i>GVJ konfirmon se në KUB ka një shpërndarje të formave të mësimdhënise dhe kontrollit të njohurive mes kategorive të ndryshme, por edhe të shtrira në kohë përgjatë semestrit.</i></p> <p><i>[Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor "Ekonomi", Kreu II; Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit; Syllabuset e Lëndëve/Moduleve 2020-2023]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion, GVJ mori konfirmimin se personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta dhe pa dallime diskriminuese, për të gjithë studentët në arritjen e objektivave të tyre akademike. Stafii akademik është i angazhuar në respektimin dhe përgjigjen ndaj diversitetit dhe nevojave të studentëve. Kjo realizohet përmes ofrimit të një vargu të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të përshtatura me natyrën dhe specifikat e programit dhe aktiviteteteve formuese.</p> <p>Në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies, duke integruar teknologjinë në mësimdhënie dhe duke nxitur përfshirjen aktive të studentëve përmes projekteve dhe detyrave të KUBsit, punës në grup për të nxitur diskutimet dhe bashkëpunimin sipas roleve, si dhe për të përmirësuar programin e studimit në bazë të reagimeve dhe opinioneve të studentëve.</p> <p>GVJ vlerëson gjithashtu edhe infrastruktura në KUB që është në funksion të këtij program studimi, dëshmon për kushte optimale të zhvillimit të programit mësimor. Çdo klasë ishte e pajisur me tabela dhe mjete audiovizive (kompjuter dhe laptop) të cilat, sipas studentëve të programit të studimit përdorëshin paralelisht nga stafii akademik dhe zgjonin interes tek studentët. Nëpërmjet portalit të KUB, pedagogët ofrojnë informacione të nevojshme për studentët, si leksionet, literatura e rekomanduar, ushtrimet, praktikat, projektet e KUBsit, syllabuset e lëndëve dhe CV-të personale. Këto faqe dhe adresa janë krijuar që nga viti 2011 dhe përditësohen vazhdimisht.</p> <p><i>[Evidenca 11. Rregullore e Këshillit të Etikës, neni 2, 4; Evidenca 3. Plani i masave të Kolegjit Universitar i Biznesit”, për vitin akademik 2022-2023; Evidenca 62. Udhëzues në nivel</i></p>

	<p><i>institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative "GOOGLE APPS", portali KUB]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri, GVJ gjykon me rëndësi konfirmimin e përmirësimit të vazhdueshëm të aftësive pedagogjike – didaktike të stafit PAE dhe PAK. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ dëshmoi faktin që, prezenca e stafit për një kohë të gjatë dhe fakti që nuk ka rotacion të shpeshtë dëshmon për seriozitetin e institucionit në angazhimin e stafit.</p> <p>Stafi dëshmon se punon me pasion për të dhënë njohuri studentëve dhe angazhohet për të qenë vazhdimisht në mbështetje të studentëve nëpërmjet informimit të vazhdueshëm të tyre në lidhje me mundësitë – si internship, dhe komunikimi i hapur në lidhje me feedback të studentëve.</p> <p>GVJ vlerëson se Stafi akademik i këtij programi përgatitet dhe përsoset nëpërmjet një sërë aktiviteteve si takimet, vizitat studimore, pjesmarrja në konferenca shkencore dhe leksionet e hapura, falë bashkëpunimeve të shumta me institucione arsimore të tjera vendase dhe ndërkombëtare.</p> <p>KUB, në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, inKUBajon mobilitetin dhe shkëmbimin e stafit për të përmirësuar mësimdhënien përmes trajnimeve dhe kërkimit shkencor, si dhe pjesmarrjes në projekte të ndryshme. Ky proces kontribuon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe në zhvillimin e stafit akademik dhe nivelit të tyre të ekspertizës .</p> <p>Pyetësorët e studentëve janë një instrument kyç për të vlerësuar dhe evidentuar praktikën më të mirë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Bazuar në rezultatet e këtyre pyetësorëve, KUB harton raporte të detajuara akademike dhe financiare, të cilat përfshijnë analiza të thella të procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>Përpos pjesës akademike dhe praktike stafi akademik e shihte fort të rëndësishëm edhe rolin e mentorit dhe këshilluesit të karrierës për studentët. Këta të fundit vazhdimisht kërkojnë opinion për orientimin e tyre në lidhje me situatat e caktuara, si psh si të pozicionohen në tregun e punës, si të rriten në karrierë dhe si të zgjedhin vende pune të mira dhe afatgjata.</p> <p>Të pasurit e një qasje fleksibël dhe idetë inovatore nga ana e institucionit është shumë mirë për të përfshirë studentët dhe për t'i motivuar ata.</p> <p><i>[Evidenca 30.3. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet me partnerët për Programe e Projekte në kuadër të Erasmus +;</i></p>

	<p><i>Evidenca 40. Vendim BA për mbështetjen financiare për Kërkimin Shkencor të stafit akademik KUB; Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021- 2022; Evidenca 44.1. Format Pyetësi i Stafit IQE; Evidenca 36.3. Program trajnimi ISAB SKK/SNK & Çertifikatë]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ shqyrtoi kuadrin e formimit akademik dhe profesional të stafit të angazhuar në programin e studimit BSC në Ekonomi dhe duke gjykuar nga backgroundi i tyre konfirmon kompetencën dhe përgatitjen e stafit për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve në funksion të arritjes së objektivave të të nxënit.</p> <p>Stafi i KUB jo vetëm janë emra të njohur në profesion në vendin tonë por kanë një nivel të lartë të arsimimit dhe trajnimeve profesionale jashtë vendit.</p> <p>Nga takimi me stafin GVJ, konfirmon se ata përdorin metoda të larmishme në mësimdhënie për të nxitur pjesëmarrjen e studentëve.</p> <p>Theksi nga ana e pedagogëve është edhe tek parimet etike të profesionit kontabël dhe auditues cka ofrohet jo vetëm si kapitull në cdo lëndë të profesionit në programin e studimit por është edhe si lëndë e vecantë.</p> <p>Sipas shprehjeve të vetë stafit gjatë vizitës në Institucion, procesi mësimor konsiderohet i shenjtë dhe është proces serioz dhe marrëdhënia me studentët është për të nxitur mendimet e lirshme të studentëve.</p> <p>GVJ konstaton se Metodatat ndërvepruese me studentin janë në qendër të qasjes së mësimdhënies në KUB, me teknika si puna në grupe, diskutimi dhe debati, të cilat janë shumë të rëndësishme në një kohë të karakterizuar nga një fluks i madh i informacionit. Këto metoda bëjnë mësimdhënien më tërheqëse, duke aktivizuar studentët dhe duke rritur qëndrueshmërinë e dijeve të tyre. Aktivizimi i studentëve është thelbësor, dhe syllabuset e lëndëve përcaktojnë se studentët do të vlerësohen bazuar në pjesëmarrjen dhe aktivizimin e tyre gjatë leksioneve dhe seminareve, si dhe në hartimin e detyrave të KUBsit.</p> <p>Nga ana e pedagogëve merren situata konkrete dhe diskutohen me studentët, ngrihen pyetje kërkimore dhe bëhen kërkime shkencore serioze duke ndjekur metoda interaktive.</p> <p>Kjo angazhon studentët dhe i bën ata më të lirshëm gjatë orëve të mësimimit.</p>

	<p><i>[Evidenca 34. Lista e stafit akademik të arsimuar dhe kualifikuar jashtë vendit; Evidenca 50.1. Vendim i Bordit të Administrimit për miratimin e Buxhetit; Evidenca 41. Raporti i NjSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023; Evidenca 41.1. Vendim i SA për miratimin e raportit vjetor të NjSBC]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi si pjesë të DVV edhe pyetësorët për vlerësimin e procesit mësimor nga ana e studentëve për disa programe studimi të ofruara në KUB.</p> <p>Sipas këtyre pyetësorëve, studentët vlerësojnë përmbajtjen e lëndës, si edhe angazhimin e stafit akademik në përcimin e informacionit të lidhur me lëndën.</p> <p>Pyetësorët me studentët administrohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sipas rregullores së kësaj të fundit dhe në përputhje me qëllimin e funksionimit të njësisë për të garantuar cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p>GVJ vlerëson se këto pyetësorë realizohen dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, përpara zhvillimit të provimeve përfundimtare. Ata trajtojnë çështje si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, kushtet e mësimi, pajisjet në sallat e mësimi dhe laboratorët, vlerësimi i bazës didaktike, dhe vlerësimi i shërbimeve nga personeli ndihmës.</p> <p>Rezultatet e këtyre pyetësorëve bëhen pjesë e raporteve të NjBSC, të cilat shpërndahen në departamentet dhe fakultetet dhe më pas prezantohen në rektoratin e KUB. Në bazë të vlerësimeve dhe ankesave të studentëve, drejtuesit e KUB ndërmarrin masa përfshirë takime dhe ballafaqime, dhe në raste të nevojshme, masa disiplinore ndaj stafit akademik që nuk plotëson standardet e mësimdhënies.</p> <p>Në lidhje me vlerësimin e njohurive, studentëve u ofrohet mundësia e ankimit dhe përmirësimit të notave bazuar në procedurat e specifikuar në rregulloren për zhvillimin e provimeve, duke ndje KUB hapat dhe afatet e caktuara. Gjatë vizitës në Institucion u konfirmua me stafin dhe studentët se këta pyetësorë shpërndahen dhe plotësohen gjatë javës së fundit të mësimi dhe para organizimit të provimit përfundimtar të lëndës.</p> <p><i>[Evidenca 43. Format Pyetësori i Studentëve KUB; Evidenca. 43.1. Format Pyetësori i Stafit KUB; Evidenca 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FE, Kreu VII; Evidenca 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve, Kreu IV]</i></p>



<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Siç GVJ konfirmon nga përmbajtja e DVV, Institucioni ka miratuar ngritjen e disa strukturave në funksion të garantimit të cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre.</p> <p>Me vendim të Senatit Akademik, KUB ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), Këshillin e Etikës, Zyrën e KUBrikulave dhe Komisionin e Promovimit të Veprimtarive Shkencore dhe Kualifikuese të Stafit Akademik. Në gjykimin e GVJ këto struktura ndihmojnë Institucionin në garantimin e një procesi cilësor didaktik.</p> <p>Më tej nga shqyrtimi i Rregullores së NJSBC, shihet se kjo njësi mbështet zhvillimet inovatore të procesit mësimor dhe ndjek problemet që kanë lidhje me aktivitetet dhe dokumentet për vlerësimin e programeve të studimit në nivel institucional.</p> <p>GVJ konstaton se nga takimi me anëtarët e saj se NJSBC është e angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në procesin e përmirësimit të cilësisë në të gjitha fushat e veprimtarisë së KUB. Njësia monitoron dhe vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të stafit akademik, përmes matjeve të performancës dhe pyetësorëve të rregullt, të cilët realizohen dy herë në vit.</p> <p>NJSBC gjithashtu harton dhe paraqet raportet e vlerësimit të pyetësorëve, të cilët përpilohen nëpërmjet njësive bazë dhe atyre kryesore, në Senatin Akademik të KUB-it. Ky organ akademik bën vlerësimin përfundimtar dhe cakton detyrat për masat që duhen marrë për të garantuar arritjen dhe mbajtjen e standarteve dhe cilësisë në institucion.</p> <p>GVJ vlerëson pozitivisht faktin që, KUB angazhon edhe ente të pavarura si Instituti për Cilësi në Edukim (IQE), për të kryer pyetësorë dhe raporte të hollësishme nga studentët dhe stafi akademik, për të vlerësuar realisht cilësinë e mësimdhënies dhe të aftësive të stafit akademik. Rezultatet nga këto studime janë thelbësore për informimin dhe vlerësimin nga Senati Akademik, i cili më pas cakton detyrat për përmirësimin e situatës dhe adresimin e problemeve të identifikuara.</p> <p>Vlerësimi i performancës së pedagogëve nga drejtuesit e njësive kryesore është një element tjetër kyç në procesin e sigurimit të cilësisë, duke u bazuar në kritere të qarta dhe të dokumentuara në rregulloren e marrëdhënieve të punës.</p> <p><i>[Evidenca 44. Raporti i IQE për Staf Akademik, 2021; Evidenca 45. Raporti i IQE për student, 2021; Evidenca 2. Plani Strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar i Biznesit” 2021-2026, faqe 15; Evidenca 42. Vlerësim Performance</i></p>
---	--

	<i>stafi TIP; Evidenca 41. Raporti i NjsBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023, faqe 11, 12]</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Kolegji Universitar i Biznesit ka ngritur strukturat e nevojshme që garantojnë kryerjen cilësore të procesit mesimor dhe didaktik në programet e studimit që ofron.</i> <i>Pyetësorët 2 herë në vit dhe analiza e rezulteteve të realizuara nga NJSBC, si dhe po këto pyetësorë të realizuar edhe nga një organizëm i pavarur IQE, ndihmojnë mjaft mirë në përcaktimin e nivelit të cilësisë së procesit të mësimdhënies, por edhe të kapaciteteve të stafit akademik. Mbi këtë bazë përcaktohen nevojat për masat që duhen marrë për përmirësimin e situatës.</i> <i>Institucioni gjithashtu angazhohet në trajnime të vazhdueshme të stafit në kuadër të marrëveshjeve të shkëmbimit Erasmus + me partnerë të tjerë jashtë vendit, sic dëshmohet gjatë vizitës në Institucion.</i> <i>GVJ gjithashtu konfirmon aplikimin e metodave të ndryshme të kontrollit të njohurive tek studentët dhe modelet të larmishme mësimdhënie të cilat nxisin një atmosferë bashkëpunuese.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ nga analiza e dokumentacionit të Dosjes së RVB, konfirmon se kriteret, mënyrat dhe format e kontrollit të dijeve përcaktohen në mënyrë shumë të qartë në Rregulloren KUB, Rregulloren e Fakultetit, Rregulloren e Departamentit dhe në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Ekonomi. Ato janë të publikuara në web në hapësirat e dedikuara rregulloreve të studimeve përkatëse si dhe të vendosura në standat e KUB. Gjithashtu ato janë të përcaktuara në programet e çdo moduli.



GVJ vlereson se në rregulloret e KUB konfirmohet qarte se kontrolli i dijeve realizohet me shkrim, me gojë, ose në mënyrë të kombinuar. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe pikët për notën finale janë rezultat i kombinimit të elementëve si më poshtë:

1. **Vlerësimi i vazhduar** (1 – 40 pikë) (pjesëmarrje 10 pikë, aktivizim 10 pikë, teste e detyra KUBsi, 20 pikë).

2. **Provimi përfundimtar** (1 – 60 pikë)

Sipas rregullores, vlerësimi i vazhduar në masën 40% është i detyrueshëm, por në raste të lëndëve aplikative, pedagogu dhe titullari i modulit kanë të drejtën të organizojnë një shpërndarje të ndryshme të peshës së elementeve të vlerësimit të vazhduar duke e përcaktuar atë në programin lëndor.


Sic GVJ konstatoi, kriteret e testimit dhe vlerësimit të njohurive ishin përfshirë gjithashtu edhe në programet lëndore sipas kërkesave të kuadrit përkatës ligjor dhe ishin të njohura nga ana e studentëve të programit në orën e parë të çdo lënde ku bëhet shpjegimi i përmbajtjes së lëndës dhe i detyrimeve të studentit.

Vlerësimi me notë realizohet nga 4(katër) deri në 10(dhjetë). Pedagogu ka të drejtë të organizojë një shpërndarje të ndryshme të peshës së elementëve të vlerësimit të vazhduar brenda 20 %-it. Kjo mënyrë vlerësimi përveçse u bëhet e ditur studentëve që në orën e parë të zhvillimit të modulit, është gjithashtu e pasqyruar në syllabusin përkatës të modulit që ndodhet në faqen personale të web-it të çdo pedagogu.

Gjithashtu, kriteret lidhur me procedurat e testimeve/vlerësimeve të studentëve janë pjesë përbërëse e rregullores për procedurat e provimeve në KUB të cilat zbatohen dhe ndiqen nga sekretaritetë mësimlore të Fakulteteve.

[Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit; 4. Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve 2020-2023; Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit", neni 33, 94; Evidenca 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE, Kreu VII; Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Financë Kontabilitetit, neni 30; Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit, neni 30; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi", nenet 14-16; Evidenca 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve, neni 10-13; Evidenca 46. Rregullore e Sekretarisë Mësimore, nenet 3-13]

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ informohet nga dokumentacioni i Dosjes se VV se mënyrat e vlerësimit të njohurive, përcaktohen në programin/syllabusin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor. Studentët informohen nga pedagogu përkatës mbi programin/syllabusin e modulit, mënyrën e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe provimin përfundimtar që në leksionet e para të fillimit të mësimimit. Studentëve iu bëhet me dije struktura e lëndës dhe përqindjet e pikëve për të gjithë elementët.</p> <p>Nga takimi me studentët e programit të studimit GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo lënde/moduli me elementet e lëndës, ndër të tjera edhe me metodologjinë e vlerësimit. Programet lëndore vendosen gjithashtu në dispozicion të studentëve që në fillim të semestrit nëpërmjet mënyrave të brendshme të komunikimit mes studentëve dhe pedagogëve të programit që ishin emailt institucionale me të cilën pajisen të gjithë studentët e programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu, mënyra e përgjithshme e vlerësimit me notë bëhet me dije edhe në Guidën Studentore që është një material publik dhe lehtësisht i aksesueshëm.</p> <p>Është praktikë e KUB, FE por dhe e DFK dhe DM që studenti të jetë gjatë gjithë kohës interaktiv duke iu lehtësuar atyre kohën dhe mundin që do t'iu nevojitet në sezonin e rregullt ku atyre ju mbetet thjesht të përsërisin çfarë kanë përgatitur gjatë semestrit për modulet që zhvillojnë.</p> <p><i>[Evidenca 72 Tabelat përmbledhëse, Tabela 14 - Model Syllabus, elementët sipas VKM Nr. 41/2018, Tabela 15 - Format e Kontrollit të Njohurive; Evidenca 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE, neni 47, pika 3; Evidenca 63. Guida studentore]</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ shprehet se, nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të Studimit, Bachelor në Ekonomi me profile, AB dhe FK, rezulton se programi ofron mënyra të larmishme të testimit dhe vlerësimit të njohurive.</p> <p>GVJ konstatoi se këto forma vlerësimi janë përmbledhur edhe në tabelat e RVB dhe se respektohet në pothuajse të gjitha programet lëndore që pati mundësinë të shqyrtonte.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës 10% dhe pjesëmarrja aktive 10% • Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj) 10% • Testimet gjatë vitit 10% • Provimi përfundimtar 60% • Totali 100% <p>GVJ gjykon se përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin njohuritë dhe kompetencat e fituara në njërin ose disa prej formave të</p>



	<p>zgjedhura të vlerësimit të njohurive (me shkrim, ose me gojë), të cilat duke qenë edhe të shpërndara përgjatë semestrit paraqesin vlerësim të vazhduar për studentët duke u dhënë mundësinë të angazhohen në forma të përshtatura për ta.</p> <p>GVJ vlereson se gjatë gjithë vitit studentët janë në një proces të pandërprerë të mësuarit dhe vlerësimit nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave dhe projekteve të kursit, rasteve të studimit dhe provimit përfundimtar. Detyrat e kursit janë elementë të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve dhe zhvillohen gjatë semestrit. Provimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore është një moment kyç në punën e pedagogut, prandaj i kushtohet mjaft rëndësi hartimit të testit duke hartuar një test që të kontrollohet një sasi e madhe njohurish nëpërmjet hartimit të pyetjeve larmishme, me alternativa, pyetjeve që kërkojnë interpretim, zhvillim, renditje etj., duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> <p><i>[Evidenca 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve, neni 12; Evidenca 7: Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi"]</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ nga analiza dhe vlerësimi i dokumentacionit rregullator të KUB, konstaton se Drejtuesi i Njesisë Kryesore/Bazë është përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Sipas strukturës organizative të KUB është edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë (NJSBC) përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin e cilësisë dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor.</p> <p>GVJ, nga vizita ne IAL dhe kontaktet me stafin dhe studentët dhe NJSBC, rezulton se merren dhe konsiderohen mendimet e studentëve në lidhje me metodat e mësimdhënies.</p> <p>Në vijim të procesit mesimor, por sidomos në fund të semestrit, KUB u shpërndan studenteve pyetësorë, të cilët plotësohen nga ana e tyre në mënyrë anonime ku ata japin mendimet dhe sygjërimet e tyre lidhur me stafin akademik dhe metodat e mësimdhënies.</p> <p>Të dhënat e pyetësorëve përpunohen nga NJSBC, e cila harton çdo vit akademik raportin përkatës. Ky raport u vëhet në vëmendje titullarëve, apo Senatit akademik, të cilët sipas situatës dhe problematikave, përcaktojnë masat që duhen marrë për të përmirësuar gjendjen.</p> <p>GVJ konstaton se të tilla vlerësime por të pavarura në KUB realizohen edhe me vlerësues të jashtëm, si rasti IQE.</p>

	<p><i>[Evidenca 41. Raporti i NjSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023, faqe 11-12; Evidenca 43.1. Format Pyetësori i Stafit KUB; Evidenca 44. Raporti i IQE për Staf Akademik, 2021; Evidenca 44.1. Format Pyetësori i Stafit IQE]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inKUBajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Gjithashtu gjatë vizitës në institucion, personeli akademik konfirmoi se në procesin mësimor përdoren metoda të ndryshme të mësimdhënies, duke kombinuar metodat tradicionale me ato bashkëkohore. Fokusi kryesor është përfshirja aktive e studentëve në diskutime praktike, objektive dhe me sens kritik gjatë orëve të leksioneve dhe të seminareve.</p> <p>Studenti, që në fillim të zhvillimit të lëndës, njihet me mënyrën e vlerësimit të dijeve të tij, pikët për pjesën e vlerësimit të vazhduar dhe pikët dhe notën për vlerësimin final, si dhe detyrimet për frekuentim të lëndës. Gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi marrëdhënie respekti të ndërsjellë mes personelit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>GVJ vlerëson se pedagogët nxiten nga strukturat e institucionit për të marrë pjesë në trajnime brenda ose jashtë vendit, nga universitetet partnere të huaja dhe vendase në kuadër të programit Erasmus +, për të qënë pjesëmarrës në trajnime, sidomos ato për përmirësimin e mësimdhënies, përdorimit të metodave të larmishme mësimdhënëse e mësimnxënëse, me në qendër studentin, punën me grupe, diskutimin etj.</p> <p><i>[Evidenca 70. Vendim Bordi Akademik për Komisionin dhe Promovimit të Stafit Akademik KUB; Evidenca 62. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative "GOOGLE APPS", portali KUB; Evidenca 27.2. Plan i Veprimtarive Akademike e Shkencore 2022-2023; Evidenca 28.1. Raporti Vjetor i Punës Kërkimore Shkencore dhe Projektet, Kolegjit Universitar i Biznesit; Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 19 - Të dhëna për Kërkimin Shkencor të Stafit Akademik; Evidenca 27. Rregullore e zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve; Evidenca 30.3. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët për Programe e Projekte në kuadër të Erasmus +]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe informacionet e lidhura me mënyrën e vlerësimit të studentëve të programit Bachelor në Ekonomi me profile:AB dhe FK ne KUB, si Rregulloren e Programit të Studimit, Programet Lëndore dhe tabelat e RVB formoi bindjen se mënyra e vlerësimit në këtë program përfshin forma të ndryshme kontrolli dhe testimi.</p>



	<p><i>Këto forma të ndryshme të vlerësimit të njohurive, bëhen pjesë e rregulloreve të posaçme dhe u komunikohen studentëve para fillimit të lëndës.</i></p> <p><i>Ato mund të garantojnë një shpërndarje dhe mbulim të mirë të vlerësimit të çdo studenti në këtë program pasi janë të shpërndara gjatë semestrit dhe kanë modalitete të ndryshme testimi.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se Departamentet dhe stafi përkatës i tyre, vlerësojnë dhe përmirësojnë në vijimësi format e mënyrat e mësimdhënies ndaj studentëve duke marrë dhe konsideruar edhe mendimet dhe propozimet e tyre, të grumbulluara në takime direkte ose nëpërmjet plotësimit dhe përpunimit të Pyetësorëve që IAL shpërndan 2 herë në vit studentëve, apo edhe duke angazhuar organizata të pavarura për këtë qëllim (IQE).</i></p> <p><i>GVJ vlerëson se Institucioni mundëson dhe nxit stafin për të aplikuar metoda dhe forma të shumëllojshme mësimdhënies në përputhje edhe me rezultatet e pritshme të të nxënit dhe me objektivat formues të programit të studimit, duke formuar tek studenti autonominë dhe mbështetjen për të ndërtuar marrëdhënie të respektit të ndërsjelltë dhe për të qenë i aftë për tregun e punës në përfundim të studimeve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>GVJ nga studimi dhe njohja me Dosjen e dokumentacionit të RVB për akreditimin periodik të Programit të studimit Bachelor në Ekonomi me profile; Administrim-Biznesi dhe Financë-Kontabilitet konstaton se: Në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Departamenteve dhe të këtij Programi, përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të studentëve duke zbatuar një sistem vlerësimi të vazhdueshëm të studentëve gjatë gjithë periudhës semestrale dhe në përfundim duke e integruar edhe rezultatin e Provimit përfundimtar.</p> <p>GVJ kofirmon se Format e testimit/vlerësimit të njohurive janë: zhvillim testi i ndërmjetëm vlerësuar me 10% të pikëve totale të lëndës, detyrë KUBsi 10%, angazhime në seminare 10% dhe frekuentim lënde 10%, të cilat kanë një peshë prej 40 % të totalit</p>

	<p>të rezultatit të lëndës, ndërsa provimi përfundimtar ka një peshë prej 60 % të rezultatit të lëndës. Pedagogu i modulit i komunikon studentit nëse ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në provimin final, KUB ka shlyer detyrimet që lidhen me atë lëndë për frekuentimin dhe kërkesat e tjera të parashikuara në syllabusin e lëndës.</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit"; kreu XII, neni 94; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi", neni 12; Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit; 4. Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve 2020-2023; Evidenca 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve, kreu IV, nenet 10-13]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ qartëson se, lidhur me këtë kriter në RVB e IAL, përcaktohet se në procesin e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentëve në KUB, zbatohen me rigorozitet procedurat dhe rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Programit, Rregulloren e Provimeve dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>GVJ konfirmon se KUB ka përcaktuar qartë në rregulloren e programit të studimit metodat e vlerësimit dhe testimit e njohurive të fituara në modulet e ndryshme, duke u siguruar që procesi të jetë i drejtë, i qartë dhe i paanshëm për çdo student që ndjek programin Bachelor në Ekonomi.</p> <p>Kështu përgatitja dhe shumëfishimi i tezave, kryhet nën përgjegjësinë direkte të pedagogut përkatës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit - shumëfishohen dhe sekretohen nga sekretaria mësimore në sallën e provimit.</p> <p>Procesi i korrigjimit të provimeve kryhet nga pedagogu i lëndës dhe rezultatet publikohen sipas ID të studenteve, brenda një periudhe të shkurtër, zakonisht brenda javës.</p> <p><i>[Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi", nenet 14-16; Evidenca 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve, kreu IV, nenet 10-13; Evidenca 46. Rregullore e Sekretarisë Mësimore, kreu I]</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ lidhur me mënyrë e vlerësimit të studentëve në programin e studimit Bachelor në Ekonomi me profile: AB dhe FK në KUB sqaron se, është shtjelluar në kriteret e trajtuara me sipër. Mënyra e vlerësimit është e paraqitur qartë në Rregulloren e Programit të studimit si edhe në Syllabuset/programet lëndore përkatëse.</p> <p>GVJ nënvizon se vlerësimi me notë në KUB bëhet mbështetur në totalin e vlerësimeve gjatë vitit dhe të provimit</p>



	<p>përfundimtar. Sipas rregullores së programit të studimit, neni 12, pika 2, vlerësimi bëhet me nota kaluese nga 5 deri në 10 dhe me intervale prej 10 pikësh për çdo notë.</p> <p>Kjo mënyrë vlerësimi përfshihet gjithashtu edhe në syllabuset e çdo lënde tek seksioni i Tabelës së Vlerësimit.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi me stafin dhe studentët e programit se, vlerësimi përfundimtar i lëndës ndjek formën dhe mënyrën e parashikuar në rregullore dhe në syllabus dhe nuk ka shmangie nga ky rregull.</p> <p><i>[Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi", nenet 14-16; Evidenca 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve]</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konfirmon se, sipas RVB për këtë kriter, Institucioni kërkon kujdesin që duhet të bëjë pedagogu i lëndës për të bërë vlerësime me komentet e nevojshme të cilat diskutohen individualisht me çdo student, në mënyrë që këta të fundit të informohen për performancën e tyre në një element të caktuar të vlerësimit si edhe të mund të japin një feedback nëse kjo është e nevojshme.</p> <p>Notat dërgohen në sekretari dhe hidhen në regjistrat e vlerësimeve vetëm pasi bëhet ballafaqimi me studentin.</p> <p>Kjo praktikë u konfirmua nga GVJ gjatë vizitës në Institucion në bisedat me stafin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>GVJ konfirmon se ky Kriter përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>[Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi"; Evidenca 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ nga Dokumentacioni i Dosjes së RVB të këtij program studimi, konstaton se, bazuar në Rregulloren Institucionale të KUB, nenet 13 e 14, janë parashikuar procedura të posaçme në lidhje me zhvillimin e provimeve, dhe disa nga këto rregulla janë në funksion të shmangies së plagjiaturës dhe kopjimit.</p> <p>Studentëve nuk u lejohet të përdorin pajisje celulare në provim, për çdo provim që në sallë ka mbi 40 studentë shtohet edhe një tjetër pedagog për administrimin e sallës, tezat e provimit përgatiten në më shumë se një variant, tezat e provimit sekretohen dhe ndryshohen në çdo sezon provimi etj.</p> <p>Në këtë proces, pedagogu merr masa duke mos lejuar përdorimin e telefonave mobile, për të shmangur mundësinë e</p>

	<p>kopjeve dhe monitoron me vëmendje sallën e provimit për të parandaluar çdo komunikim mes studentëve. Gjithashtu, studentët janë të detyruar të hyjnë në sallën e provimit me mjet identifikimi, në përputhje me rregullat e përcaktuara në rregulloren e programit.</p> <p>Përveç sa parashikohet në Rregulloren Institucionale dhe në Rregulloren e Programit të Studimit dhe Rregulloren e Zhvillimit të provimit, GVJ u bind edhe gjatë vizitës në institucion, se plagjiatura merrej seriozisht dhe ndaj studentëve merreshin masa deri në përjashtimin e tyre nga salla e provimit.</p> <p>Edhe në përgatitjen e Detyrave të Kursit, studentëve u kërkohet të përgatisin punimet me shkrimin e tyre dhe mbrojtja e detyrës bëhet fizikisht nga studenti. Për punimet e diplomave, zbatohet Udhëzuesi i posaçëm i miratuar në Senatin Akademik, për përgatitjen e diplomës i KUB. Në Udhëzues janë parashikuar të gjitha kriteret dhe standardet e caktuara nga institucioni.</p> <p><i>[Evidenca 33.2. Model Tezë Provimi Formati TIP; Evidenca 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve, kreu IV, nenet 14-15; Evidenca 57. Rregullore "Për procedurën e mësimdhënies online, në Kolegjin Universitar të Biznesit (KUB), në kushte situatë të jashtëzakonshme dhe fatkeqësie natyrore"; Evidenca 59. Udhëzues për përgatitjen e diplomës]</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren e përgjithshme të institucionit, rezultati i provimit i komunikohet studentëve brenda afateve të parashikuara (neni 14) që është jo më vonë se një javë nga data e kryerjes së provimit.</p> <p>Ky afat përgjithësisht u konfirmua se respektohej edhe gjatë vizitës së GVJ në Institucion ku nuk u konstatuan shmangie. Kominukimi i rezultatit të provimit bëhet individualisht për çdo student nga pedagogu i lëndës ose nga sekretaria mësimore dhe me numër ID të çdo studenti, në faqen e pedagogut në Portalin e KUB ose duke ia dërguar secilit student në adresën email që ai ka në KUB (neni 14, rregullorja e programit të studimit).</p> <p><i>[Evidenca 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE, kreu VII, neni 47; Evidenca 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve, kreu V, nenet 16,17].</i></p>



<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se, në Rregulloren e Programit të studimit (nenet 14, 15, 16) është përcaktuar procedura e vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve të provimit për studentët. Gjithashtu në këtë rregullore si dhe në Rregulloren e Zhvillimit të Provimeve është parashikuar se pas shpalljes së rezultateve paraprake, studenti ka të drejtë të kërkojë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij.</p> <p>GVJ konstatoi se rezultatet e provimit përfundimtar publikohen në Portalin e KUB nga sekretaria akademike, jo më vonë se një javë nga data e zhvillimit të provimit. Studentët kanë të drejtën e plotë për të kërkuar sqarime në lidhje me çdo paqartësi në rezultatin e tyre, ose për të paraqitur ankime lidhur me rezultatet e provimit brenda një afati prej 72 orëve ose tre ditësh pas shpalljes së rezultateve, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Zhvillimin e Provimeve. Ky proces siguron një trajtim të drejtë dhe transparent për të gjithë studentët, duke u ofruar atyre mundësinë për të adresuar çdo shqetësim që mund të kenë rreth vlerësimit të tyre</p> <p>GVJ vlerëson se, ankesa nga studentët bëhet me shkrim pranë sekretarisë mësimore e cila ka edhe përgjegjësinë për të arkivuar dokumentacionin shoqërues (ankimimin e studentit dhe procesverbalin e provimeve).</p> <p>Procedura e ankesave dhe rikontrollimit të vlerësimeve siguron një proces të drejtë dhe transparent, duke ofruar studentëve mundësinë për të adresuar çdo shqetësim që kanë në lidhje me rezultatet e tyre akademike.</p> <p>Procedurat e zhvillimit të provimeve u bëhen me dije studentëve dhe ndiqen rigorozisht nga Institucioni sic edhe e konfirmon GVJ.</p> <p><i>[Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi"; Evidenca 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve]</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjeKUB duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Bazuar në rregulloret përkatëse, GVJ konstatoi se nga ana procedurale ishte parashikuar se studentët kanë të drejtë të apelojnë për vlerësimin e provimit përfundimtar duke paraqitur një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë mësimore jo më vonë se tre ditë pune nga data e shpalljes së rezultateve të provimeve në sekretari.</p> <p>GVJ konstatoi se, kërkesa e studentit duhet t'i drejtohet Departamentit përkatës që është përgjegjës për programin përkatës të studimit. Në këto raste, Departamenti ngre një komision i cili ngarkohet të rishikojë vlerësimin e dhënë nga</p>

	<p>pedagogu dhe jep përgjigje e cila sipas rregullores do të konsiderohet e formës përfundimtare.</p> <p>Sipas rregullores së KUB, dokumentacioni mbështetës për administrimin e procedurës së ankimimit ruhet në një kopje pranë sekretarisë mësimore si edhe i dërgohet në një kopje edhe përgjegjësit të njësisë kryesore që është përgjegjëse për programin e studimit të ofruar.</p> <p><i>Kjo procedurë u konfirmua nga GVJ gjatë vizitës në Institucion.</i></p> <p><i>[Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi"; Evidenca 33. Rregullore për zhvillimin e provimeve neni 16, pika 4.]</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ shqyrtoi dokumentacionin në DVV si Rregulloren e Institucionit dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor ne Ekonomi me profile: Administrim Biznesi dhe Finance Kontabilitet, duke konstatuar:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>parashikimin në to të gjitha procedurave të nevojshme në lidhje me vlerësimin e studentëve, procedurën e ankimimit dhe rishikimit të vlerësimit, si edhe vlerësimin përfundimtar të tyre dhe arkivimin e dokumentacionit shoqërues.</i> <i>Vlerësimi i studentëve në këtë program studimi bëhet me notë kaluese nga 5 deri në 10. Nota duhet të shpallet deri në një javë pas provimit dhe studentët kanë tre ditë afat për procedurën e ankimimit.</i> <i>Gjatë procedurës, departamenti ngre një komision të posacëm i cili shqyrton kërkesën e studentit dhe merr një vendim të formës përfundimtare për vlerësimin.</i> <i>Dokumentacioni i plotë administrohet një kopje nga sekretaria mësimore dhe një kopje nga njësia kryesore e cila ofron programin e studimit.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë	GVJ duke vlerësuar strukturën e lëndëve të Programit të Studimit BSc Ekonomi me profile AB dhe FK, si dhe

<p>thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>përmbajtjet e detajuara të tyre në çdo program lënde/moduli, siç GVJ, gjykon se garantohet përfitimi njohurive bazë dhe thellimi i njohurive profesionale aplikative në fushat e Administrimit të Biznesit dhe të Financës Kontabilitetit, por edhe aftësimi i studentëve për t'u angazhuar në veprimtari me fokus të vecantë sipas interesave të tyre.</p> <p>GVJ vlerëson gjithashtu se programi i studimit ka potencialin që të përgatisë profesionistë të aftë për të punuar në Fushat e Administrimit dhe Financës e Kontabilitetit, nëpërmjet detyrave, projekteve dhe praktikave profesionale si dhe ofrimin e lëndëve të tjera si, Bazat e ekonometrise, Tregjet dhe Institucionet Financiare, Manaxhim Projektsh, Kontrolli dhe auditimi brendeshem, Kontabilitet Publik etj.</p> <p>GVJ vlerëson se edhe drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë, në përputhje me Rregulloren përkatëse të njësisë, me përgjegjësinë e tyre ndihmojnë në kontrollin dhe përmirësimin e cilësisë dhe në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ata janë përgjegjës për zbatimin e planeve dhe programeve të mësimdhënies.</p> <p>Një prej detyrave thelbësore të drejtuesit është të sigurojë përmirësimin e cilësisë nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, të identifikojë pikat e dobëta dhe të paraqesë propozime për përmirësimin e mësimdhënies.</p> <p>GVJ konfirmon se Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe për rritjen e vetëdijes të pedagogëve dhe studentëve për çfarë programi i studimit Bachelor në Ekonomi ofron. Gjithashtu, ndjekja me seriozitet e realizimit të Praktikës Profesionale apo e mobiliteteve të realizuara në kuadër të programit Erasmus+ me studentët të gjitha se bashku çojnë me siguri dhe mjaftueshmëri në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve dhe kontribuojnë në rritjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>GVJ konfirmon se Kriteri përmbushet plotësisht.</i></p> <p>Referenca: <i>[Evidenca 4. Rregullore e Njësisë Kryesore FE, kreu 10, neni 60; Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të MB dhe FK, neni 7, 9 dhe 35, Evidenca 15, Dosja e PS]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimin.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i Planit Mësimor (tabelat në RVB), konstatoi se ka disa lëndë të cilat fokusohen në trajtimin e elementeve që lidhen me teknologjinë dhe kompjuterizimin, si: lënda Sistemet e informacionit të menaxhimit, Kontabilitet i Aplikuar (i Informatizuar) apo edhe Etika në Biznes, IAS/IFRS(SKK/SNK), Shkrim dhe Komunikim Biznesi, Sociologji Psikologji, në përshtatje këto me zhvillimet e</p>

profesionit të kontabilistit dhe audituesit në vitet e fundit, por edhe të raporteve ndërmjerëzore.

GVJ vlerëson pozitivisht ofrimin e lëndës së Etikës së Avancuar, e cila synon të zgjojë tek studentët ndërgjegjësimin për dimensionin human e social të profesionit të kontabilistit në përputhje kjo edhe me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit në profesionin përkatës.

GVJ konstaton se Trajnimi dhe kualifikimi i stafit akademik në Kolegjin Universitar i Biznesit nëpërmjet ISAB, (Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes), si strukturë në mbështetje të tij, ofron një spektër të gjerë shërbimesh trajnuese, duke përfshirë edhe stafin akademik të KUB si trajnerë. Këto trajnime përfshijnë fushën ekonomike deri tek fusha e informatikës.

Në kuadër të përgatitjes së stafit të DFK dhe DM, ISAB ka realizuar trajnime të ndryshme, dhe së fundmi ka zgjeruar ofertën e trajnimeve përveç atë të Fushës së Standardeve Kontabël kombëtare dhe ndërkombëtare, edhe trajnimet në Fushën e Profesionit të Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme (NPP).

Edhe bashkëpunimi me partneret e huaj gjithashtu përfshin aktivitete të zhvilluara me stafin dhe studentët si dhe me përfaqësues të institucioneve arsimore të larta partnere, në kuadër të veprimtarisë Erasmus +, të cilat nxisin dhe zhvillojnë aftësi të vecanta të komunikimit dhe nderveprimit, në shërbim të studenteve dhe plotësimit të objektivave të Programit të studimit.

GVJ konfirmon se kriteri përmbushet plotësisht.

Referenca:

[Evidenca 36.3 Program trajnimi ISAB SKK/SNK & Çertifikatë; Evidenca 41.2. Plani i aktiviteteve për përmbushje të rezultateve të pyetesorëve në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB;

Evidenca 27.1 Raport i zhvillimit të aktiviteteve nga Marrëveshjet Erasmus +;

Evidenca 27.3 Raport mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentët në KUB si dhe përfaqësues të IAL-të partnere në kuadër të veprimtarisë Erasmus +]



<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga analiza e programeve lëndore, GVJ konstatoi se në to është parashikuar një përmbledhje e lëndës në javën e fundit (të 15të) të zhvillimit të procesit mësimor. Vecë kësaj, të gjitha programet lëndore kanë të përfshira si një seksion të vecantë në fillim të tyre “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit”, kjo në përputhje edhe me kërkesat e VKM nr.41 të ndryshuar.</p> <p>Ky element liston përfitimet e realizuara nga çdo lëndë e programit për të mbërritur në përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu, GVJ gjatë vizitës në Institucion konstaton se stafi akademik ia dedikon javën e fundit të semestrit një përmbledhjeje të njohurive të marra dhe përgatitjes së studentëve për provimin përfundimtar të lëndës që është edhe detyrimi përmbyllës i çdo lënde.</p> <p>GVJ konstatoi të njëjtën gjë edhe nga kontakti që realizoi me stafin akademik, gjatë vizitave të IAL. Çdo pedagog që ka zhvilluar një lëndë apo modul në programin Bachelor në Ekonomi, në fund të procesit mësimor, bën një analizë dhe përmbledhje të të gjithë aktiviteteve të realizuara me studentët, duke theksuar çështjet më të rëndësishme dhe duke udhëzuar studentët për zbatimin e tyre dhe vëmendjen e shtuar për plotësimin e detyrimeve përmbyllëse.</p> <p><i>[Evidenca 7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi", kreu II; Evidenca 15. Dosje e PS: Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve 2020-2023; Evidenca 21.2 Analiza Mësimore Kërkimore DFK dhe DM 2022-2023; Evidenca 32.1 Kontrate Pune FT_TIP; Kontrate Pune PT_TIP]</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime</p>	<p>Plani Mësimor i Programit të Studimit BSC Ekonomi në KUB parashikon praktika profesionale në semestrin e fundit të studimeve si një instrument për praktikimin e njohurive teorike të përfuara gjatë studimeve.</p> <p>Nga diskutimet me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, GVJ konstatoi se, ata ishin të hapur për të nxitur bashkëpunimin e studentëve, punën e tyre në grup me qëllim aftësimin për zgjidhjen e problemeve dhe të çështjeve komplekse.</p> <p>Stafi përmendi përdorimin e metodave interaktive si puna në laboratore të informatikës, të Ekonometrise, të Standardeve të Aplikuara të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar, me platforma të fokusuar në menaxhimin e portofoleve dhe menaxhimin financiar, cka i angazhon studentët gjatë procesit mësimor; raste studimore dhe detyra kursi si që nxisin</p>

<p>të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>studentët për të punuar në grup dhe për të ndarë përvojat e tyre; përdorimi i software-ve kontabël në mësimdhënien e lëndëve me profil kontabël (raportim financiar ose taksimi), studentët janë aktivë nëse angazhohen me metoda interaktive gjatë procesit mësimor.</p> <p>GVJ vlerëson se studentët angazhohen me internship dhe praktika.</p> <p>Vetë studentët u shprehën pozitivisht për klimën suportuese nga stafi i Institucionit dhe dëshmojnë për mbështetjen që kanë pasur në këtë drejtim.</p> <p>Puna e kujdesshme në Institucion e adresuar në funksion të programit të studimit referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Nga komunikimi me pedagogët dhe studentet GVJ konstatoi se, formimi i studentëve dhe marrja e njohurive nëpërmjet një mësimdhënie të bazuar në kompetenca është një prioritet në KUB. Kjo qasje u mundëson studentëve që të aplikojnë njohuritë teorike në praktikë, veçanërisht përmes zhvillimit të laboratorëve ose praktikave profesionale.</p> <p>Në Programin Bachelor në Ekonomi, orët mësimore të lëndëve aplikative zhvillohen kryesisht në dy laboratorët e informatikës të KUB, ndërsa praktikat profesionale realizohen në kompani ose institucione me të cilat KUB ka marrëveshje bashkëpunimi, duke përfshirë kompanitë profesionale në fushën e Financave Kontabilitetit.</p> <p>Rritja e numrit të laboratorëve ka lejuar aplikimin më efektiv të bazës teorike të mësuar gjatë leksioneve. Stafi i DFK dhe DM diskuton brenda departamentit për përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie, përfshirë përdorimin e mjeteve audio-vizive, ndërthurjen e teorive me shembuj praktikë, nxitjen e ideve nëpërmjet punës në grup, përfshirjen në projekte kursi dhe vizitave në zyra profesionale, etj.</p> <p><i>[Evidenca 7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi", kreu II; Evidenca 15. Dosje e PS: Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve 2020-2023; Evidenca 21.2 Analiza Mësimore Kërkimore DFK dhe DM 2022-2023; Evidenca 42 Vlerësim Performance stafi_TIP; Evidenca 42.1 Vlerësim Performance stafi personalizuar]</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionin e RVB, për Programin e studimit BSC në Ekonomi me profile, AB dhe FK, identifikoi dhe listën dhe evidencën përkatëse për leksione të hapura, që janë zhvilluar në KUB dhe që demonstrojnë ndërthurjen e mësimdhënies nga stafi i institucionit me të tjerë partnerë bashkëpunues, për të mundësuar trajtimin e</p>

<p>brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>ideve mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë lidhur me programin specifik të studimit.</p> <p><i>Gjatë vizitës në Institucion dhe diskutimeve me stafin e programit të studimit dhe studentët përkatës, GVJ konfirmoi jetën aktive akademike në KUB, çka dëshmon për përmbushjen e këtij kriteri.</i></p> <p>GVJ nga takimi me përfaqësues të zyrave, konstatoi se, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës dhe Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën për organizime në lidhje me maturantë; caktojnë për çdo student një tutor për mbikqyrje; bëjnë nje plan vjetor për një sërë eventesh që janë në mbështetje të edukimit kurrikular dhe ekstrakurrikular si: trajnime, workshope, leksione të hapura, konferenca studentonte etj.</p> <p>Pjesë e këtyre eventeve kanë qënë gjithmonë stafi pedagogjik i brendshëm dhe/ose i jashtëm i KUB-it, partnere, personalitete, të ftuar të cilët ndajnë me studentët e KUB-it ekperiencat/përvojat më të mira në jetën e tyre profesionale. Gjithashtu alumni të KUB janë pedagogë, duke dhënë kështu më së miri shembullin e rëndësisë që kanë studentet për institucionin.</p> <p><i>[Evidenca 27.2 Plan i Veprimtarive Akademike e Shkencore 2022-2023]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>institucioni tregon nëpërmjet evidencave në DVV, se ka një shkallë të lartë të garancisë për thellimin e njohurive, dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, te komunikimit dhe ndërveprimit.</i> • <i>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, nëpërmjet këtij programi studimi dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës, me studentet duke i keshilluar ata për përmbylljen me sukses të detyrimeve të tjera.</i> • <i>Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i</i>

	<p><i>mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, dhe të tjerë të ftuar, realizojnë orë dhe leksione të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</i> • <i>Mësimdhënia kryhet në mënyrë profesionale nga një staf cilësor akademik dhe profesional i njohur në këtë fushë.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konstaton se, mbështetur në Rregulloren e Programit të Studimit BSC në Ekonomi me profile AB dhe FK në KUB, detyrim përmbyllës i studimeve në këtë cikël studimesh është përgatitja e mbrojtja e diplomës në mënyrë individuale me provim formimi të përgjithshëm ose me punim diplome. Diploma në përfundim të ciklit të parë të studimeve “Bachelor në Ekonomi” me profile: Administrim Biznesi dhe Finance Kontabilitet, mbrohet me Provim formimi të përgjithshëm ose me temë diplome. Tema e diplomës vlerësohet me notë dhe me kredite ECTS sipas Planit Mësimor.</p> <p>Fakulteti vendos në dispozicion të studentëve udhëzimin për mbrojtjen e diplomës me provim formimi të përgjithshëm ose me punimin e temës së diplomës. Po aty përcaktohen dhe fazat e përgatitjes së punimit sipas përcaktimeve të rregullores së programit të studimit. Përveç sa është parashikuar në rregulloren e programit të studimit, institucioni përgatit edhe një urdhër të rektorit për mbrojtjen e diplomave ku caktohen komisionet përkatëse, datat dhe modalitete të tjera në përputhje me rregulloren përkatëse.</p> <p>GVJ konstaton se, në përfundim të programit të studimit Bachelor në Ekonomi, për të orientuar dhe ndihmuar studentët, departamenti përcakton dhe shpall brenda afateve të parapara në kalendarin akademik, temat orientuese për mbrojtjen e diplomës</p>

	<p>si dhe nje një bankë me pyetje për provimin e formimit. Studentët që synojnë të përfundojnë studimet me Punim Diplome duhet të kenë një notë mesatare mbi 9 për të tre vitet e studimit.</p> <p>Udhëheqësi dhe tema e diplomës miratohet nga Dekani i fakultetit. Udhëheqësi i temës së diplomës duhet të jetë i kualifikuar me gradën shkencore "Doktor i Shkencave". Kriteret dhe procedurat për provimin përfundimtar \përfundimin e studimeve janë të detajuara në Udhëzuesin e KUB, për provimin e mbrojtjes së Diplomes dhe në rregulloret bazë të KUB-it.</p> <p><i>GVJ konstaton se Departamentet informojnë studentët për programin e provimit të formimit përmes sekretarisë mësimore, e cila i njofton studentët rreth detajeve dhe organizimit të provimit.</i></p> <p><i>[Evidenca 59. Udhëzues për përgatitjen e diplomës; Evidenca 7. Rregulloret e Programit të Studimit Bachelor"Ekonomi neni 18, p. 5; Evidenca 59.1. Miratimi i temës së diplomës dhe udhëheqësit nga dekani FE]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, si dhe vëzhguar gjatë vizitës në institucion, studenti ka të drejtë të zgjedhë si udhëheqës një pedagog me eksperiencë sipas përcaktimeve të drejtuesit të njësisë bazë. Për realizimin e punimit, dekani nxjerr urdhrin përkatës për caktimin e udhëheqësve të temave të studentëve. Sipas rregullores, studenti është i detyruar të respektojë afatet e përcaktuara në programin e punimit të diplomës dhe të këshillave të udhëheqësit shkencor.</p> <p>Pedagogët udhëheqës në KUB asistojnë studentët në përgatitjen e temës së diplomës. Ata ndihmojnë studentët duke ofruar orientim në aspekte të ndryshme si struktura e temës, ndarja në çështje dhe nënçështje, literatura përkatëse, vihet në dispozicion biblioteka e KUB dhe adresa JSTORE e bibliotekës on line e kontraktuar nga KUB dhe materiale referuese për zhvillimin e programeve. Gjithashtu, ata ndihmojnë në formulimin e konkluzioneve dhe sigurojnë që materiali përfundimtar të përmbushë standardet e kërkuara.</p> <p>Studentët që nuk plotësojnë kriteret për mbrojtjen e diplomës me punim, ose ata që zgjedhin të mos zhvillojnë një punim, u nënshtrohen një provimi të përgjithshëm. Nga vizita dhe takimi me studentet dhe stafin akademik në IAL, GVJ informohet se studentët orinetohen për provimin final duke iu dhënë një set pyetjesh dhe ushtrimesh nga lëndët e zhvilluara bazë dhe ato specifike të fushës së Ekonomisë. Ky material është i</p>

	<p>disponueshëm në Sekretarinë Mësimore dhe publikohet për të informuar studentët.</p> <p><i>[Evidenca 59. Udhëzues për përgatitjen e diplomës; Evidenca 4. Rregullore e Programit të studimit BSC në Ekonomi; Evidenca 60. Fusha Kërkimi Orientuese për Tema Bachelor/ Listë Pyetje Orientimi për Provim Formimi]</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Mbështetur në Rregulloren e programit të studimit GVJ konstaton se komisioni i provimit përfundimtar në KUB përbëhet dhe funksionon në bazë të propozimeve të bëra nga dekani dhe miratimit me Urdher të Rektorit.</p> <p>GVJ konstaton se Komisioni i Provimit të formimit të përgjithshëm është përgjegjës për organizimin e provimit përfundimtar.</p> <p>Komisioni kujdeset që në provim të ketë në dispozicion teza provimi me pyetje dhe ushtrime që i perkasin njohurive që studentët kanë fituar gjatë tre viteve akademike të formimit të tyre. Përpilimi i pyetjeve për të gjitha lëndët dhe modulet bëhet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe më pas miratohet nga Dekani.</p> <p>Më tej, plotësohen procesverbalet me rezultatet e provimit përfundimtar, plotësohen dhe firmosen nga anëtarët e komisionit dhe më pas dorëzohen në sekretari. Ky informacion është i disponueshëm në sekretarinë e fakultetit dhe publikohet në mënyrë që të gjithë studentët të jenë në dijeni të përmbajtjes dhe rezultateve të tij.</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit, kreu XIV, neni 105; Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit në Dosjen e RVB, konstaton se paketa udhëzuese për përgatitjen e diplomës përmban dokumentacion të përmbledhur, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programin e Punës; 2. Kërkesën e studentit për miratimin e udhëheqësit; 3. Afatet e procesit për punimin e diplomës; 4. Ballinën e punimit të diplomës; 5. Listën e temave orientuese; 6. Udhëzimin për procedurat e përgatitjes së temës për mbrojtjen e diplomës në programin e studimit të KUB. <p>KUB ka përcaktuar kërkesat e detajuara në "Udhëzimin për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës në KUB", i cili është miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 18, datë 26.11.2018.</p>

<p>është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ, mbështetur në Rregulloren e Programit të studimit dhe Udhëzimit për përgatitjen e diplomës në KUB, konfirmon se, udhëheqësi i studentit për realizimin e Punimit të diplomës, asiston studentët në procesin e diplomimit duke përcaktuar grafikun e konsultimeve përgjatë të cilave kontrollohet ecuria e përgatitjes së punimit dhe i udhëzon ata për elemente të nevojshme të këtij procesi. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga student dhe lejon mbrojtjen e punimit duke plotësuar një formular të vlerësimit të studentit. Mbrojtja e diplomës bëhet para komisionit me një prezantim në PowerPoint dhe ruhet në Sekretarinë Mësimore të FE.</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit; Evidenca 59. Udhëzues për përgatitjen e diplomës]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ, referuar parashikimeve të Rregullores së Programit të Studimit në lidhje me përfundimin e ciklit të parë të studimeve me punim diplome, konstaton se, institucioni i kushton rëndësi të veçantë kërkimit shkencor dhe sidomos aplikimit të tij në fazën e përgatitjes së punimit të diplomës. Vetë studentët dhe stafi i programit të studimit, gjatë vizitës në institucion u shprehën pozitivisht për mbështetjen institucionale në këtë fazë qoftë nëpërmjet shfrytëzimit të ambienteve të KUB, aksesit në bibliotekën fizike apo online për shfrytëzimin e materialeve.</p> <p>GVJ nga studimi i dokumentacionit të Dosjes së RVB, konstaton se tema e diplomës përgatitet bazuar në kritere të ndryshme si kapitujt e përgatitur, numri i faqeve, dhe kritere të tjera të specifikuar në procesin e mbrojtjes së temës. Këto kritere janë në përputhje të plotë me kërkesat e udhëzuesit të KUB për Provimin dhe Mbrojtjen e Diplomës.</p> <p><i>[Evidenca 7. Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Ekonomi; Evidenca 59. Udhëzues për përgatitjen e diplomës]</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të punimit të temës së diplomës, studentët vlerësohen me nota sipas sistemit shqiptar, mbështetur në Rregulloren e programit të studimit dhe të vlerësuar gjithashtu edhe në kreditë ECTS. Nota iu komunikohet studentëve në përfundim të mbrojtjes me gojë të punimit të diplomës para komisionit të ngritur për këtë qëllim.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në Institucion, konfirmoi pranë sekretarisë mësimore vlerësimet me notë të studentëve dhe regjistrin e posaçëm të notave të diplomës. Punimet dhe temat e diplomës ruhen në sekretarinë mësimore.</p>

	<p><i>[Evidenca 7. Rregullore e programit te studimit; Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit, kreu XIV, neni 105]</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e Përgjithshme e KUB dhe Rregullorja e Programit të studimit parashikojnë se studentët të cilët përfundojnë me sukses studimet në programin e studimit të Ciklit të Pare Bachelor ne Ekonomi me profile: AB dhe FK, në zbatim të kësaj rregulloreje pajisen me diplomën përkatëse universitare e cila përmban emërtimin e fakultetit dhe të programit të studimit.</p> <p>Pajisja me diplomë e studentëve konfirmohet nga GVJ në bazë të verifikimit në vend të regjistrimit të lëshimit të diplomave verifikuar në sekretarinë mësimore të KUB.</p> <p>KUB pajis studentët me suplementin e diplomës, ku gjendet programi i zhvilluar me kreditet dhe vlerësimin përkatës gjatë tre viteve akademike sipas standardeve europiane me 180 kredite. Studentët mund të pajisen edhe me syllabuset përkatëse të lëndëve të zhvilluara sipas programit në bazë të një kërkesë të depozituar në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit, neni 106; Evidenca 23. Model Diplome Bsc_Ekonomi; Evidenca 23.1. Model Diploma Supplement Bsc_Ekonomi]</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Sipas RVB të plotësuar nga Institucioni për këtë kriter, dokumentacioni i plotë në lidhje me studentët në KUB, administrohet nga sekretaria mësimore. KUB studenti diplomohet apo largohet, dosja e tij transferohet në arkivën e institucionit në përputhje me bazën përkatëse ligjore.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pati mundësinë që të kërkonte informacione për studentët aktualë dhe ata të diplomuar pranë sekretarisë mësimore. Ndër këto informacione, u kërkuan të dhëna edhe në lidhje me studentët e diplomuar dhe u konstatua përmbushja e kërkesave për informacion të paraqitur nga ana e tyre.</p> <p>GVJ konstaton se sekretaria mësimore mban në mënyrë të rregullt informacionet për studentët si të dhëna të përgjithshme në lidhje me ta që nga momenti i fillimit të studimeve si formularët e regjistrimit, kopje e dokumentit ID, kontrata e lidhur me studentët, ashtu edhe evidenca gjatë studimeve si evidencat për vlerësimet dhe notat, etj.</p> <p><i>[Evidenca Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; evidence 46. Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Evidenca 10. Rregullore e zyrës së Arkivit]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • në dokumentacionin e DVV të paraqitur nga Kolegji Universitar i Biznesit janë përshkruar në mënyrë të detajuar procedurat që ndiqen për përgatitjen për detyrimet përmbyllëse dhe mbrojtjen e diplomës në Programin e studimit Bachelor në Ekonomi me profile: Administrim Biznesi dhe Finance Kontabilitet. • Punimi i diplomës është individual dhe punohet në drejtimin e udhëheqësit shkencor, pedagog me eksperiencë nga KUB. Gjatë punës, studenti ka të drejtën të orientohet dhe asistohet nga pedagogu udhëheqës dhe të shfrytëzojë infrastrukturën e institucionit për këtë qëllim. • Në përfundim të procesit të diplomimit, studenti pajiset me diplomë "Bachelor në Ekonomi me profil: Administrim Biznesi ose Financë Kontabilitet, si edhe me suplementin e diplomës. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit	GVJ pasi shqyrtoi dhe analizoi dokumentacionin e Dosjes së vetëvlerësimit (DVV) për Programi Bachelor në Ekonomi me profil në Administrim Biznesi, Finance Kontabilitet në Kolegjin Universitar të Biznesit (KUB), konstaton se ky program studimi realizohet nga personel akademik i kualifikuar, i cili përmbush kriteret e LAL 80/2015.

akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Përgjegjësit e Departamenteve të këtij programi mbajnë gradën shkencore Prof. Asoc. Dr, për Departamentin e Manaxhimit të Biznesit dhe “Doktor i Shkencave”, për Departamentin Financë Kontabilitet. Struktura e personelit akademik përfshin pedagogë në kategorinë e Profesorit, pedagogë në kategorinë Prof i Asociuar, pedagogë me gradën “Doktor i Shkencave” dhe pedagogë me gradën “Master i Shkencave”.

Ky personel përfshin akademikë të punësuar me kohë të plotë dhe të pjesshme, të cilët janë zgjedhur bazuar në nivelin e tyre të kualifikimit akademik dhe specializimin në fushat përkatëse. Mësimdhënia në këtë program kryhet nga lektorë, ndihmës lektorë dhe specialistë të fushës, të cilët përputhen me fushën kryesore formuese dhe kërkimore të modulit. Ngarkesat mësimore të stafit akademik janë shpërndarë në përputhje me fushën e tyre kërkimore, ekspertizën dhe përvojën praktike. GVJ vlereson se në KUB, kontratat e punësimit për personelin akademik janë në përputhje me kategorizimin e tyre akademik, siç përcaktohet nga LAL 80/2015 dhe rregulloret e tjera relevante. Kjo përfshin edhe miratimin e normave të ngarkesës së punës në bazë të gradës shkencore ose titullit akademik që mban personeli, në përputhje me ligjin, statutin dhe vendimet e marra nga Senati Akademik.

Sistemi i ngritur në KUB për stafin akademik siguron qëndrueshmëri dhe një mjedis mësimor dhe një klimë bashkëpunuese dhe produktive mes studentëve, stafit akademik dhe kolegëve.

GVJ konstaton se stafi akademik që angazhohet në **Programin Bachelor në fushën e Ekonomisë**, me profile në **Administrim Biznesi dhe Financë dhe Kontabilitet**, në KUB, përmbush kërkesat ligjore në fuqi.

Kualifikimi i stafit akademik për DAP	2022-2023		2021-2022		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	1	1	1
Prof. Asoc.	1	2	1	3	1	4
Dr./PhD.	9	2	11	5	9	3
MSc.	7	2	6	1	5	1
Totali	18	7	19	10	16	9

	<p><i>[Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor"Ekonomi; Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BScEkonomi;</i></p> <p><i>Tabela 1,2 - Numri i Personelit Akademik për Njësinë Bazë DFK DM; Evidenca 31. Lista e Pedagogëve në KUB për Vitin Akademik 2022-2023; Evidenca 47. Vendim SA mbi normën e stafit akademik bazuar në kualifikimin e tyre;</i></p> <p><i>Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 7 - Raporti i Personelit PAE/PAK sipas Titujve/Gradave për Programin Bsc në Ekonomi; Tabela 8 - Personeli PAE/PAK sipas Titujve/Gradave dhe Moshës për Programin Bsc në Ekonomi;</i></p> <p><i>Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 12 - Plani Mësimor i lidhur me Personelin Akademik përkatës]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga takimi i realizuar nga GVJ me përgjegjësit e 2 Departamenteve dhe Personelin akademik, rezultoi se stafi akademik efektiv mbulon 74% të ngarkesës mësimore. Ndërkohe kofirmohet se i gjithë stafi akademik i KUB ka përputhje me fushat akademike-kërkimore të përgjithshme dhe specifike dhe me objektivat e programit të studimit. Fushat kryesore kërkimore të personelit akademik janë biznesi, administrimi, drejtimi i SME, drejtimi financiar, tregjet financiare, kontabiliteti, raportimi financiar dhe auditimi, të cilat pasurohen dhe me fushat specifike si, taksimi, etika, kontabiliteti i aplikuar, etjera.</p> <p>Fusha akademike-kërkimore e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program sipas fushës së kualifikimit që ka, angazhohet edhe në programet e studimit të ciklit të dytë dhe për këtë arsye ata kanë një ngarkesë të vlerësuar në këto programe studimi. Ata janë kryesisht të kategorisë Profesor dhe Doktor.</p> <p><i>[Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi;</i></p> <p><i>Tabela 6.1 & 6.2 - Stafit Akademik për Programin e Studimit Bsc në Ekonomi për 3 vite, Tabela 7 - Raporti i Personelit PAE/PAK sipas Titujve/Gradave për Programin Bsc në Ekonomi; Tabela 8 - Personeli PAE/PAK sipas Titujve/Gradave dhe Moshës për Programin Bsc në Ekonomi;</i></p> <p><i>Tabela 4 - Ngarkesa Totale e Personelit Akademik të Programit Bsc në Ekonomi]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit, dhe kontakteve me stafin dhe departamentet përkatëse GVJ konstaton se Personeli akademik në këtë program studimi ka qëndrueshmëri e</p>

<p>e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>jetëgjatësi në angazhimin e tij në procesin mësimor në KUB, duke përbërë një avantazh të rëndësishëm të këtij program studimi. Në funksion të plotësimit të këtij avantazhi, kontratat e punës lidhen pa afat për pedagogët me Gradën Shkencore “Doktor” dhe titullin “Profesor” dhe “Prof. Asoc.”, deri në moshën 65 vjeçare dhe 68 vjeçare për titullin “Prof. Dr.”. Për Masterat. marrëdhënia mbështetet me kontrata një vjeçare të rinovueshme sipas nevojës së KUB.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kontratat individuale të punës dhe zyra e programimit dhe raportimit financiar realizon të gjithë detyrimet ekonomike dhe financiare në përputhje me këto kontrata dhe legjislacionin në fuqi mbi pagat dhe pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore periodike mujore.</p> <p><i>[Evidenca 32.1. Kontrate Pune FT_TIP; Evidenca 32.2. Kontrate Pune PT_TIP; Evidenca 5, Tabelat përmbledhëse për personelin akademik në njesinë kryesore dhe njesinë përgjegjëse/ bazë: 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, duke analizuar dokumentat rregullative të KUB, Statutin e IAL, Rregulloren e Marrëdhënieve të Punës për procedurat e rekrutimit të stafit akademik, dosjet e stafit akademik në zyrën e burimeve njerëzore, si dhe duke vlerësuar takimin me stafin akademik që janë të angazhuar në realizimin e programi Bachelor në Ekonomi me 2 profile për akreditim, konstaton se; procedura e rekrutimit të stafit akademik është në përputhje me synimet e institucionit dhe programin e studimit perkates. Në përputhje me nenin 59, të Ligjit 80/2015, të gjithë pedagogët e angazhuar në programin që është për akreditim, mbajnë gradë minimalisht të ciklit pasardhës në raport me programin ku janë angazhuar në mësimdhënie.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore, konsultimi me formatin e dosjes se stafit, statutin e institucionit, rregulloren e marrëdhënieve të punës për procedurat e rekrutimit të stafit akademik si edhe duke iu referuar bazës ligjore e nënligjore në fuqi, GVJ konstaton se përcaktohen qartë procedurat për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me bazen ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit</p> <p>Sipas parashikimeve në Statutin e IAL, si dhe nenit 7-13 të rregullores Për marrëdhëniet e punës, Përgjegjësi i Departamentit të njësisë bazë, bën propozimin rektoratit për nevojat për rekrutimin e Stafit Akademik. Procedura e zhvillimit të konKUBsit si dhe kriteret e përzgjedhjes të kandidatëve,</p>

	<p>bëhen publike nga Zyra e Burimeve Njerëzore në faqen e ëeb-it të institucionit. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision “ad hoc” i ngritur nga rektori, ku pjesë e tij, janë drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i burimeve njerëzore dhe përgjegjësi i departamentit/njësisë bazë.</p> <p>Përzgjedhja dhe rekrutimi kalon në disa faza, duke i bërë prezent rezultatet e vlerësimit për secilin kandidat. Pas përfundimit të procesit, kandidatët që janë përzgjedhur dhe vlerësuar pozitivisht nga komisioni, njoftohen zyrtarisht për të nënshkruar kontratën e punës.</p> <p>Nga verifikimi i dosjeve të personelit akademik, rezultoi se ato kishin të gjithë dokumentacionin përkatës.</p> <p><i>[Evidenca 32.3. Një praktikë e rekrutimit të stafit akademik në KUB; Evidenca 70.1. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës, neni 19; Evidenca 70. Ligji i Arsimit të Lartë, Nr. 80/2015, kreu 6, neni 57-68; Evidenca 1. Statuti i KUB, kreu 5, neni 41-53]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ, referuar dokumentacionit përkatës, Dosjes së Programit të Studimit si dhe të dhënave për personelin akademik dhe ndihmës akademik, konstaton se Fakulteti i Ekonomisë si një njësi kryesore ka në përbërjen e tij dhe një personel ndihmës akademik, që ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies dhe koordinimin e aspekteve praktike. Personeli ndihmës akademik ndihmon në realizimin e praktikave mësimore si dhe kujdeset për mirëmbajtjen e mjediseve të laboratorëve dhe pajisjeve përkatëse. Nga vizita e realizuar në ambjentet e KUB, rezultoi se në funksion të këtij program studimi dhe programeve të tjerë, janë 2 laboratorë të informatikës me kapacitet me 50 dhe 20 PC, në të cilët janë të instaluar programet aplikative të kontabilitetit (Financa 5, Alpha web, Bilanc), dhe programe të tjera për realizimin e praktikave mësimore.</p> <p>GVJ vlerëson se këto mjete teknologjike lejojnë studentët të zhvillojnë dhe të thellojnë njohuritë e tyre në aplikacionet praktike si Microsoft Office, softuare për analizën statistikore, dhe sisteme për menaxhimin e të dhënave financiare.</p> <p>Këto mundësira laboratorike jo vetëm që mbështesin programin e studimeve Bachelor në Ekonomi, por janë gjithashtu të përshtatshme për programe të tjera të studimit në nivelet Bachelor dhe Master.</p>

	<p><i>[Evidenca 61. Relacion mbi infrastrukturën e KUB; Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 16 - Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë]</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga konsultimi me Rregulloren e Institucionit, Rregullores për marrëdhëniet e punës, Formatin e Dosjes personale të Stafit Akademik, si dhe vizitën në Zyrën e Burimeve Njerëzore, administratës dhe arkivit pranë institucionit, GVJ konstaton se kjo zyrë disponon listën dhe dosjet e stafit akademik dhe personelit administrativ të institucionit, të detajuar sipas njësive kryesore dhe njësive bazë. Nga përzgjedhja rastësore e dosjeve për anëtarët e stafit akademik, të dhënat për dosjet janë të plota dhe të përditësuara me dokumentacionin shoqëruës. Në KUB ndodhen të dhënat e personelit për programin e studimit që nga koha e hapjes së programit në vitin 2012, në atë të akreditimit të parë të po atij viti, të riakreditimit të vitit 2018 dhe deri në ditët e sotme.</p> <p><i>[Evidenca 32.4. Përmbajtja dokumentare e dosjes së stafit FT; Evidenca 32.5. Përmbajtja dokumentare e dosjes së stafit PT; Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 1 - Numri i Personelit Akademik për Njësinë Bazë DFK DM; Tabela 2 - Lista e Personelit Akademik për Njësinë Bazë DFK DM; Evidenca 6. Rregullore e Departamentit të Finance Kontabilitet dhe Departamentit të Menaxhimit; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi; Evidenca 37. Lista e përgjithshme e Stafit Akademik sipas njësive kryesore/bazë]</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, KUB mbështetet në një bashkëpunim të gjerë me një sërë institucioneve publike dhe biznese private, të cilat mundësojnë kryerjen e praktikës profesionale dhe përgatitjen e mikrotezës për studentët e këtij programi studimi. Një praktikë tjetër e rëndësishme e ndjeKUB nga institucioni janë edhe leksionet e hapura që zhvillohen nga lektorë vendas, si profesionistë të fushës së administrimit të biznesit, të financës dhe kontabilitetit, të adiministratës publike ne Shqipëri, por edhe lektorë të huaj, të ftuar në kuadër të programeve Erasmus +.</p> <p>Nga takimi i realizuar me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi u konfirmua se Departamenti i Manaxhimit të Biznesit dhe Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, për të siguruar mbarëvajtjen dhe respektimin e detyrimeve të</p>

	<p>studentit, ngarkon një pedagog përgjegjës për mbikqyrjen e kryerjes së praktikës profesionale nga studentët. Edhe për udhëheqjen e diplomës për studentët që mbyllin studimet me Temë diplome caktohet ose miratohet një pedagog me gradë shkencore për të udhëhequr studentin.</p> <p><i>[Evidenca 55. Udhëzues për përgatitjen e Praktikës Profesionale; Evidenca 30. Marrëveshje bashkëpunimi për Praktikën Profesionale_TIP; Evidenca 59. Udhëzues për përgatitjen e diplomës; Evidenca 38. Lista e personaliteteve të ftuar për Leksione të Hapura KUB]</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues të DVV (lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, Evidenca për praktikën mësimore etj), GVJ konstatoi se janë përcaktuar në mënyrë të detajuar organizimi dhe vlerësimi i praktikave profesionale për këtë program studimi. Praktika profesionale është pjesë përbërëse e planit mësimor e kategorizuar si lëndë e formimit plotësues. Praktika profesionale nga studentët kryhet pranë firmave të biznesit që janë të shumta, si dhe të studiove të financës dhe kontabilitetit, të konsulentëve të bankave dhe shoqërive të sigurimit, subjekteve/bizneseve të ndryshme private, institucioneve publike, etj., me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Për realizimin e praktikës KUB, bashkëpunon me institucione publike qendrore dhe lokale si, dhe një sërë bizneseve private. Departamenti i Manaxhimit të Biznesit dhe ai i Financës dhe Kontabilitetit, ngarkon një pedagog përgjegjës për mbikqyrjen e praktikës profesionale nga ana e studentëve.</p> <p>Në përfundim të praktikës, përfaqësuesi i kompanisë ku kryhet praktika përgatit një vlerësim për punën e kryer nga studenti gjatë praktikës. Ky vlerësim merret parasysh nga komisioni i mbrojtjes së praktikës për studentin përkatës.</p> <p>Pedagogët që ndjekin dhe monitorojnë praktikën e studentëve janë gjithashtu pjesë e komisioneve të vlerësimit të praktikave profesionale në programin Bachelor në Ekonomi, me profil në Administrim Biznesi dhe Finance-Kontabilitet.</p> <p><i>[Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Ekonomi", neni 13; Evidenca 55. Udhëzues për përgatitjen e Praktikës Profesionale; Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit për Praktikën Profesionale; Tabela e vlerësimit të Praktikës Profesionale]</i></p>

Konkluzione	<p><i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të stafit akademik, konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>fusha akademike-kërkimore e pedagogëve të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit, Bachelor ne Ekonomi me profile, Administrim Biznesi dhe Finance Kontabilitet, janë në përputhje me natyrën dhe specifikat e programit të studimit dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi.</i> <i>Institucioni garanton qëndrueshmërinë e stafit dhe personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Procedura e rekrutimit të stafit akademik, është në përputhje me objektivat e KUB dhe programit te studimit.</i> <i>Institucioni ka një bashkëpunim të gjerë me një sërë institucionesh publike dhe biznese private, që mundësojnë kryerjen e praktikës profesionale për studentët e këtij programi studimi.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ pasi analizoi dokumentacionin shoqërues të DVV (Të dhëna për infrastrukturën dhe mjediset e KUB), si dhe të dhënavë të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVBP), konstaton se KUB disponon hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor për studentët e Programit te studimit Bachelor ne Ekonomi, me profilet: Administrim Biznesi dhe Financë Kontabilitet.</p> <p>Nga vizita në institucion e GVJ rezulton se, ambientet për zhvillimin e procesit mësimor (sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët, etj.), janë të pajisura me teknologjinë e duhur, kompiuter (PC) dhe projektorë për të lehtësuar dhe zhvilluar sa më mirë leksionet, seminarët, praktikat mësimore si dhe aktivitetet e punës në grup të studentëve. Zyrat e stafit akademik dhe administrativ janë të pajisura me PC, dhe infrastrukturën e nevojshme për t'i shërbyer sa më mirë procesit mësimor dhe nevojave të studentëve.</p> <p>Nga takimi me përfaqësues të institucionit GVJ konfirmon se KUB ofron, infrastrukturën e nevojshme dhe të mjaftueshme</p>

	<p>për studentët, stafin akademik dhe administrativ. KUB ka lidhur kontrata qeraje afatgjata, me qëllim garantimin në vijimësi të zhvillimit normal të procesit mësimor. Së fundmi, ka edhe një kontratë të re për rreth 800 metër katrorë shtesë, për programet e reja që do të hapen.</p> <p>Nga takimi me studentët rezultoi se ata dhe stafi kanë akses të plotë në sisteme që mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore, lehtësojnë komunikimin pedagog-student dhe i shërbejnë realizimit të programit të studimit (Portali i KUB).</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSc. Ekonomi me 2 profile: AB dhe FK; Evidenca 61. Relacion mbi infrastrukturën e KUB; Evidenca 62.3 Kontratat e Qerasë së Godinave në përdorim KUB]</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe njohurive specifike të GVJ, konstatohet se kërkesat e këtij kriteri plotësohen nga KUB. Infrastruktura sa i përket mjediseve mësimore, (sallave të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve) janë të pajisura me mjete dhe pajisje bashkëkohore për t'i shërbyer sa më mirë procesit mësimor dhe nevojave të studentëve dhe është në përputhje me nivelin e njohurive të stafit akademik e ndihmës akademik. Sallat e leksioneve, laboratorëve janë të pajisur me kompjuter (PC) dhe projektorë. Studentëve u mundësohet akses në internet falas dhe Wi-Fi ishte funksional.</p> <p>Të gjitha ambientet e KUB janë të kondicionuara dhe në kushte optimale për të zhvilluar procesin mësimor.</p> <p>Në KUB në mbështetje të cilësisë së procesit mësimor në godina funksionojnë edhe sisteme burimi rezervë për energjinë elektrike; me ujë, sistemin i mbrojtjes kundër zjarrit, shoqëruar dhe me shkallët e emergjencës; sistemi i fonisë dhe aksesorëve të tjerë të nevojshëm.</p> <p>GVJ nga vizita në institucion konstaton se laboratorët janë në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për studentët e programeve bachelor dhe master të cilët kryejnë praktikat mësimore, në mbështetje të punimeve kërkimore-shkencore dhe temave të diplomave, për lidhjen e teorisë me lëndët aplikative. Ndërkohë në KUB, disponon edhe mjedise të Studios Profesionale (Bezo Consulting) për Shërbime Kontabiliteti, Raportimit Financiar dhe Auditimit, të pajisura me programe aplikative informatike Bilanc, Financa 5, Alpha, ku studentëve u ofrohet mundësia e plotësimit të kërkesave të tyre për module të ndryshme të programit.</p>

	<p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSC në Ekonomi me 2 profilet; Evidenca 62.4 Relacioni për infrastrukturen e KUB; Evidenca 72. Tabelat përmbledhse Anekse të KUB]</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të Dosjes së Vetëvlerësimit dhe RVB, si dhe nga vizita e realizuar në ambientet e KUB, rezultoi se në funksion të këtij program studimi janë 2 laboratorë të informatikës me kapacitet me 50 dhe 20 vende të pajisur me PC, në të cilët janë të instaluar programet aplikative të kontabilitetit (Financa 5, Alpha ëeb, Bilanc), dhe programe të tjera për realizimin e praktikave mësimore të studentëve.</p> <p>Pajisjet kompjuterike ishin të parametrave optimalë për nevojat e punës të stafit akademik dhe zhvillimit të procesit mësimor. Programet kompjuterike në sallat e laboratorëve janë instaluar në përshtatje me programet mësimore sipas fushave dhe programeve që mbulojnë departamentet përkatës.</p> <p>Labororet përdoren për programet e financës, informatikës së biznesit dhe Menaxhim Biznesi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSC në Ekonomi me 2 profilet; Evidenca 62.4. Relacioni për infrastrukturen e KUB; Evidenca 5. Tabelat përmbledhse Anekse të KUB]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se KUB disponon mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin normal të procesit mësimor.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ambientet për zhvillimin e procesit mësimor (sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët, etj.), janë të pajisura me kompjuter (PC) dhe projektorë për të lehtësuar dhe zhvilluar sa më mirë leksionet, seminarat, praktikat mësimore si dhe aktivitetet e punës në grup të studentëve.</i> • <i>Zyrat e stafit akademik dhe administrativ janë të pajisura me PC, mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për t'i shërbyer sa më mirë procesit mësimor dhe nevojave të studentëve.</i> • <i>Për studentët e programit të studimit Bachelor në Ekonomi me profilet: Administrim Biznesi dhe Finance Kontabilitet, janë në funksion 2 Laboratorët e Informatikës. Këta laboratorë kanë një kapacitet prej 70 vende, i pajisur me PC, projektorë, në të cilat janë</i>

	<p>të instaluar, programet aplikative të kontabilitetit (Financa 5, Alpha ëeb, Bilanc), për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe praktikave mësimore për studentët.</p> <ul style="list-style-type: none"> • KUB disponon 5 Laboratorë, (2 Laboratore të Informatikës, Laboratori i Mekanikës, Laboratori Elektrik dhe Elektronikës), me kapacitetet e nevojshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, puneve laboratorike dhe praktikave profesionale të studentëve sipas programeve specifike të studimit. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ kofirmon se, Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, literatura bazë e përdorur në modulet e këtij programi studimi ofrohet në gjuhën shqipe.</p> <p>Baza mësimore që u ofrohet studentëve, në varësi të modulit, përfshin: tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt, materiale në web, etj.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të këtij programi studimi, rezulton se literatura bazë apo ndihmëse garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme për studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Nga vizita e GVJ në mjediset e KUB, u konstatua se për realizimin e procesit mësimor, biblioteka e KUB luan një rol të rëndësishëm duke mbështetur me literaturë shtesë studentët për procesin mësimor dhe kërkim shkëncor. Misioni dhe qëllimi i bibliotekës është që të plotësojë nevojat e studentëve dhe stafit akademik me materiale dhe informacione në funksion të programit mësimor.</p> <p>Literatura bazë ofrohet nga tekstet ose leksione e printuara që gjenden në bibliotekë, si dhe fotokopje të leksioneve disponohen nga libraria e institucionit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe listës së inventarit të librave në bibliotekë dhe të dhënave të RVB, rezulton se KUB ka mbi 7.000 tituj librash. Në dispozicion vihen edhe adresat e Bibliotekave</p>

	<p>elektronike online. Gjithashtu KUB vendos në dispozicion dhe një fond çdo vit për të shtuar fondin e Bibliotekës së KUB.</p> <p>GVJ konstaton vazhdimin e përdorimit të platformës Google Classroom nga periudha e pandemisë Covid 19. Studentëve iu adresohen leksione dhe slide të lëndëve e moduleve, në version elektronik, në adresat e tyre të emailit si dhe në faqen personale të çdo pedagogu, në portalin e KUB.</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSc në Ekonomi me 2 profilet; Evidenca 62.4. Relacioni për infrastrukturen e KUB; Evidenca 67.2. Model përmbledhje Cikël Leksioni nga libraria e KUB; Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_Ekonomi; Tabela 17 - Të dhëna për Platformat Online/Struktura e IT/Biblioteka online; Evidenca 67.1. Lista e tekseteve të reja për programin e studimit Bsc në Ekonomi; Evidenca 67.3. Marrëveshje bashkëpunimi JSTOR/e-biblioteka; Evidenca 62.1. Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB; Evidenca 62.2. Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit në dispozicion si dhe gjatë vizitës dhe takimit të GVJ me përfaqësues të IAL-KUB, u konfirmua se në funksion të mësimit dhe kërkimit shkencor, institucioni parashikon fonde të veçantë për pasurimin e bibliotekës me tekste dhe literaturë shtesë.</p> <p>Drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë dhe stafi akademik, bashkëpunojnë për të shtuar dhe përditësuar fondin e bibliotekës me botime dhe materiale bashkëkohore (mundësisht të 5 viteve të fundit) në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor. Njësia bazë me stafin e saj identifikojnë nevojat për shtesa dhe përditësime të librave në Bibliotekë, bëjnë listimin dhe identifikimin e burimeve dhe kërkojnë nga drejtimi i KUB për të bërë blerjen e tyre.</p> <p>Botimet e stafit akademik, materialet e konferencave shkencore të KUB, të përmbledhura në Proceedings, me ISBN, publikimet në Revistën shkencore të KUB, publikimet nga institucione publike brenda vendit dhe jashtë vendit, të gjitha këto pasurojnë fondin e bibliotekës të institucionit.</p> <p>Nga institucioni, parashikohet një fond i veçantë në buxhet, për shtimin e fondit të bibliotekës me libra të rinj nga autorë vendas dhe të huaj.</p>

	<p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSC në Ekonomi me 2 profilet; Lista e inventarit të librave të bibliotekës;</i></p> <p><i>Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, faqe 65; Evidenca 67.1 Lista e teksteve të reja për programin e studimit Bsc në Ekonomi]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në mjediset e KUB, konstatohet se institucioni disponon dhe vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore brenda mjediseve të saj. Sipas dokumentacionit në dispozicion të RVB si dhe nga vizita në institucion, rezulton se biblioteka e KUB ka një kapacitet prej rreth 70 vendesh të disponueshëm me një sipërfaqe 47 m². Nga takimi i GVJ me punonjësin e bibliotekës u konfirmua se biblioteka ka në fondin e saj mbi 7.000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj që përfshin (tekste, scripture, revista, botime të ndryshme, si dhe materiale të tjera etj.).</p> <p>Pasurimi i bibliotekës bëhet çdo vit, bazuar në kërkesat e personelit akademik, njësisive bazë, njësisive kryesore dhe miratimit nga drejtuesit e institucionit. Kjo bibliotekë është në shërbim të studentëve nga e hëna deri ditën e premte, ndërsa gjatë sezonit të provimeve qëndron e hapur edhe ditën e shtunë. Kancelaria, libraria dhe shërbimet për fotokopje, janë pjesë e mjediseve të KUB.</p> <p>Biblioteka siguron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe për persona të tjerë të interesuar të KUB.</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSC në Ekonomi me 2 profilet; Lista e inventarit të librave të bibliotekës;</i></p> <p><i>Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, faqe 65; Evidenca 67.1 Lista e teksteve të reja për programin e studimit Bsc në Ekonomi]</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për</p>	<p>Nga vizita e GVJ në mjediset e KUB, konstatohet se kërkesat e këtij kriteri për tipet e ndryshme të literaturës fizike përmbushen plotësisht.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, literatura bazë e përdorur në modulet e këtij programi studimi ofrohet në gjuhën shqipe.</p> <p>Baza mësimore që u ofrohet studentëve, në vartësi të modulit, përfshin: tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt, materiale në web, etj.</p>

<p>mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të këtij programi studimi, rezulton se literatura, qoftë bazë apo ndihmëse, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të këtij programi studimi.</p> <p>Referuar informacionit të ofruar nga punonjësja e bibliotekës si dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se biblioteka ka në fondin e saj mbi 7.000 tituj në gjuhën shipe dhe të huaj që përfshin (tekste, scripture, revista, botime të ndryshme, si dhe materiale të tjera etj.), për fakultetin e Ekonomisë, Drejtësisë si dhe Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale.</p> <p>Nga takimi i GVJ me përfaqësues të institucionit, si dhe të dhënave të raportit financiar për vitin 2022, është parashikuar një fond i veçantë në buxhet për shtimin e fondit të bibliotekës me libra të rinj nga autorë vendas dhe të huaj.</p> <p>Biblioteka ka një literaturë të pasur dhe të mjaftueshme, e cila u shërben studentëve në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor, si dhe përgatitjen e temave të diplomës.</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSC në Ekonomi me 2 profilet; Lista e inventarit të librave të bibliotekës; Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, faqe 65; Evidenca 67.1 Lista e tekseteve të reja për programin e studimit Bsc në Ekonomi]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit në DVV dhe vizita në institucion, konstatohet se biblioteka është në funksion të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ në orare shërbimi të përshtatshme.</p> <p>Sipas të dhënave të dokumentacionit (tabelat përmbledhëse) për platformat online, studentëve dhe stafit akademik u ofrohet akses online në bibliotekat virtuale siç janë Questia FE, FD, JSTOR, Academia.edu, elibrary, ebsco, gutenberg, cobis, readprint, etj.</p> <p>Institucioni bën abonimin 1 vjeçar, duke u ofruar akses dhe shërbimin pa pagesë të bibliotekave online për stafin akademik dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kjo literaturë synon të jetë bashkëkohore dhe të përmbajë titujt më në zë të fushave që ndërthuren në programin e studimit Bachelor në Ekonomi.</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSC në Ekonomi me 2 profilet; Lista e inventarit të librave të bibliotekës;]</i></p>

	<p><i>Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, faqe 65; Evidenca 67.1 Lista e tekseteve të reja për programin e studimit Bsc në Ekonomi]</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ, referuar dokumentacionit në DVV në sistemin e ASCAL (Infrasktruktura dhe mjediset e KUB), si dhe takimi me stafin e bibliotekës, konfirmon se biblioteka, ka një kapacitet prej 50 vendesh, përveç sallave të laboratorëve të cilat KUB janë të lira mund të përdoren si biblioteka.</p> <p>Ajo është e pajisur me disa kompjutera dhe ndriçues dhe me internet falas. Biblioteka është e organizuar në orare shfrytëzimi të përshtatshme për studentët dhe pedagogët.</p> <p>Biblioteka është në shërbim të studentëve për sigurimin e literaturës në bibliotekat virtuale, si dhe për t'u përdorur për përgatitjen e detyrave të KUBsit, temat e diplomës, si dhe nevoja të tjera për studentët.</p> <p>Biblioteka është e mbështetur në një program kompjuterik dhe sistem dokumentacioni të organizuar mirë për administrimin e librave fizikë, në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për studentët.</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSC në Ekonomi me 2 profilet; Lista e inventarit të librave të bibliotekës; Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, faqe 65; Evidenca 67.1 Lista e tekseteve të reja për programin e studimit Bsc në Ekonomi; Evidenca 67. Rregullore e bibliotekës.]</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Nga takimi me studentët, stafin akademik dhe administrativ të këtij institucioni, GVJ konfirmon se mësimi për programin e studimit Bachelor në Ekonomi me profile AB dhe FK, realizohet paradite.</p> <p>Biblioteka apo sallat e leksioneve u mundësojnë studentëve studimin në orare të ndryshme. Biblioteka ofron shërbimin nga dita e hënë deri ditën e premte nga ora 09.00-15.00 dhe 16.00 - 20.00. Shërbimet në bibliotekë ofrohen nga një punonjës që është caktuar si person përgjegjës.</p> <p>GVJ konstatoi se biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi të përshtatshme, në përputhje me nevojat dhe numrin e studentëve.</p> <p>Njëkohësisht, për shkak të disponimit të bibliotekës online, oraret e aksesimit të informacionit nga studentët janë fleksibël dhe mundësojnë kapacitetet për përdorimin optimal të mjedisit fizik të bibliotekës. Shërbimi cilësor i bibliotekës mbështetet edhe nga Rregullorja e funksionimit të saj.</p>

	<p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSC në Ekonomi me 2 profilet; Lista e inventarit të librave të bibliotekës;</i></p> <p><i>Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, faqe 65; Evidenca 67.1 Lista e tekseteve të reja për programin e studimit Bsc në Ekonomi; Evidenca 67. Rregullore e bibliotekës.]</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues, si dhe gjatë vizitës të GVJ, u konfirmua se në funksion të mësimdhënies, institucioni parashikon fond të veçantë për pasurimin e bibliotekës me tekste dhe literaturë shtesë. Referuar kërkesës së personit përgjegjës të bibliotekës, personelit akademik dhe drejtuesve të njësisë bazë, parashikohen blerjet e teksteve dhe librave të rinj duke pasuruar dhe përditësuar fondin e bibliotekës me botime dhe materiale bashkëkohore.</p> <p>Institucioni parashikon çdo vit një fond të veçantë në buxhet, për shtimin e fondit të bibliotekës me libra të rinj nga autorë vendas dhe të huaj, të cilët shërbejnë si literaturë plotësuese në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor.</p> <p>Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse për programin e studimit raportojnë vazhdimisht se cila ka qenë shkalla e shfrytëzimit të bibliotekës, me sa tituj të rinj është përditësuar biblioteka në shërbim të programit të studimit, si është shfrytëzuar fondi fizik dhe fondi online nga stafi akademik dhe studentët, kërkesat për tituj dhe cila ka qenë performanca e përdoruesve të fondit të Bibliotekës.</p> <p>Nga vizita në bibliotekë u konfirmua se fondi dhe database i librave dhe materialeve të tjera në bibliotekë është i informatizuar.</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSC në Ekonomi me 2 profilet; Lista e inventarit të librave të bibliotekës;</i></p> <p><i>Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, faqe 65; Evidenca 67.1 Lista e tekseteve të reja për programin e studimit Bsc në Ekonomi; Evidenca 67. Rregullore e bibliotekës.]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Nga vizita e GVJ në mjediset e KUB, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • biblioteka e KUB, luan një rol të rëndësishëm duke mbështetur me literaturë shtesë studentët dhe stafin akademik për procesin mësimor dhe kërkimor shkencor;

	<ul style="list-style-type: none"> • në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, institucioni parashikon fonde të veçantë për pasurimin e bibliotekës me tekste të reja dhe literaturë shtesë. Bazuar në kërkesat e personelit akademik, njërive bazë, njërive kryesore dhe miratimit nga drejtuesit e institucionit. • biblioteka ka në fondin e saj mbi 7.000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj që përfshin (tekste, scripture, revista, botime të ndryshme, si dhe materiale të tjera etj.). • Studentëve dhe stafit akademik u ofrohet akses online në bibliotekat virtuale. • Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi të përshtatshme, në përputhje me nevojat dhe numrin e studentëve. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues si dhe gjatë vizitës në KUB, përkatësisht në zyrat përkatëse dhe sekretarinë mësimore, konstatoi se, institucioni disponon një sistem përmes të cilit administron dokumentacionin që lidhet për informimin e studentëve, regjistrimet, dhe zhvillimin e procesit mësimor dhe deri në diplomimin e tij.</p> <p>Nga takimi i realizuar me përfaqësues të institucionit, stafin akademik dhe studentët, u konfirmua se portali i KUB, si një platformë teknologjike ofron një sërë shërbimesh dhe informacionesh të nevojshme për studentët dhe stafin akademik lidhur me zhvillimin e procesit mësimor. Logimi në këtë sistem bëhet përmes adresave personale të email-it, për stafin akademik dhe studentët. Gjithashtu, nga takimi me përfaqësues të zyrave të KUB, u konfirmua se gjithë ky proces bazohet në akte administrative, rregullore dhe udhëzime përkatëse nga ana e institucionit.</p> <p><i>[Evidenca 46. Rregullore e Sekretarisë Mësimore, kreu II; Evidenca 46.1. Regjistri i të dhenave të studentëve/AMZA; Evidenca 46.2. Regjistri i Rezultateve/performances se</i></p>

	<p><i>studentit; Evidenca 19. Organigrama e Kolegjit Universitar i Biznesit]</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues (<i>Organigrama e KUB</i>), ky institucion ka në strukturën e vet, Zyrën e Burimeve Njerëzore, që administron dosjet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p><i>Nga vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, u konstatua se kjo zyrë mban një dokumentacion të plotë të stafit akademik dhe jo akademik, si KUBse edhe pedagogëve të ftuar për realizimin e programit të studimit. Ky dokumentacion ruhet manualisht dhe elektronikisht, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</i></p> <p><i>[Evidenca 1. Statuti i KUB, neni 15, 16; Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit", neni 5, 7; Evidenca 19. Organigrama e Kolegjit Universitar i Biznesit & Vendimi i Senatit Akademik; Evidenca 32.4. Përmbajtja dokumentare e dosjes së stafit FT; Evidenca 32.5. Përmbajtja dokumentare e dosjes së stafit PT]</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit shoqërues, konsultimi me faqen e web-it si dhe gjatë vizitës në KUB, GVJ konstatoi se institucioni ka faqen e tij të ëeb-it (https://kub.edu.al/).</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët dhe personelin akademik, u konfirmua se ata disponojnë adresen e tyre të email-it, të unifikuar nën domain e KUB. Përmes adresës realizohet komunikimi i vazhdueshëm dhe i shpejtë i pedagogut me studentët, me stafin akademik, ndihmës akademik dhe personelin administrativ.</p> <p>KUB ka investuar në krijimin e një portali të personalizuar për të informuar maturantët dhe më gjerë, bizneset, institucionet publike e private rreth misionit të tij. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumentacion për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Në faqen e KUB gjendet informacioni i kërkuar lidhur me stafin akademik, në linkun përkatës dhe në përbërjen e Portalit të KUB.</i></p> <p><i>[Evidenca 62. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative "GOOGLE APPS", portali KUB; Evidenca 62.1. Guida e stafit për</i></p>

	<p><i>përdorimin e platformës classroom_KUB; Evidenca 62.2. Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB]</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga vizita e GVJ dhe komunikimi me përfaqësuesit e KUB, si dhe verifikimi i dokumentacionit shoqërues, u konfirmua se gjatë periudhës së pandemisë COVID 19, janë përdorur platformat online të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit si Google Classroom, Zoom, Meet.</p> <p>Çdo student dhe pedagog është pajisur me kredencialet e veta për përdorimin e këtyre platformave online, duke u loguar nëpërmjet portalit të KUB.</p> <p>Këto platforma janë përdorur gjatë periudhës së pandemisë për zhvillimin e mësimi (leksioneve, seminareve dhe provimeve online).</p> <p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platformën e portalit të KUB, i cili mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p>Stafi akademik menaxhon një llogari individuale dhe një link për çdo modul të zhvilluar, i cili shërben si një mjet efikas komunikimi midis pedagogëve, studentëve dhe administratës (kontakti me sekretariatë mësimore, lidhur me vlerësimin e studentëve, me detyrat e KUBsit materialet mesimore, leksione, prezantime, ushtrime, teste etj.)</p> <p>Dosjet e studentëve që në rregjistrimin e tyre pranë fakulteteve, administrohen nga zyrat e sekretarisë së fakultetit.</p> <p>GVJ nga dokumentacioni i DVV dhe kontaktet me stafin e BNJ dhe Finances, informohet se KUB ka kontraktuar dhe po instalon një program informatik, që do të mundësojë dhe do të administrojë në mënyrë të automatizuar dhe të integruar të gjithë procesin mësimor dhe të gjitha komunikimet dhe shkëmbimet e informacionit midis personelit akademik dhe studentëve, për të bërë një zgjidhje integrale për të gjithë strukturat dhe gjenerimin e informacioneve në nivel institucioni të KUB.</p> <p><i>[Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 7. Rregullore e zhvillimit të procesit mësimor online, Evidenca 57. Rregullore “Për procedurën e mësimdhënies online, në Kolegjin Universitar të Biznesit (KUB), në kushte situate të jashtëzakonshme dhe fatkeqësie natyrore”; Evidenca 62.1. Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB; Evidenca 62.2. Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB]</i></p>

<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të ngarkuar në sistemin e ASCAL-it, GVJ konstaton se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si pjesë e strukturës së KUB, ka të përcaktuar në rregulloren e saj, procedurat për të monitoruar në kohë reale dhe periodike, zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor.</p> <p>Strukturat e tjera të KUB, sigurojnë mbarëvajtjen e aktiviteteve administrative duke siguruar një mjedis dhe klimë bashkëpunuese për studentët dhe stafin akademik në drejtim të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Në KUB është ngritur dhe operon një sistem kamerash, për të garantuar dhe raportuar në kohë reale për sigurinë dhe kujdesin e shërbimeve që ofron cdo strukturë e institucionit.</p> <p>GVJ informohet në vizitat në IAL se Stafi akademik raporton në kohë reale lidhur me zhvillimin e procesit akademik online, nëpërmjet PORTALIT, i cili akseson çdo punonjës dhe student të KUB, duke përdorur pasëordin/kodin e tij personal të adresës së emailit të tij. (emer.mbiemer@kub.edu.al).</p> <p>GVJ vlerëson se Fakulteti në fund të çdo semestri harton raport për analizën e punës dhe të rezultateve të arritura dhe problematikat për ndjektje, ndërkohë çdo fundviti akademik harton raportin vjetor në të cilin paraqet të gjithë performancën akademike të fakultetit dhe çdo departamenti e programi studimi në përbërje të tij. Këto raporte shërbejnë si bazë informacioni për hartimin e Raportit Vjetor Institucional të KUB.</p> <p><i>[Evidenca 1. Statuti i IAL; Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 5. Dosja e Programit të Studimit, Evidenca 14. Rregullore e NjsBC; Evidenca 19. Organigrama e KUB; Evidenca 62.2 Guida e studentit dhe stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB; Evidenca 62.5 Rregullore për përdorimin e Videosurvejimit në KUB]</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga konsultimi dhe logimi në faqen zyrtare të këtij institucioni, dhe PORTALIN e KUB, GVJ konstaton se informacioni ofrohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.</p> <p>Faqja zyrtare e KUB-it http://kub.edu.al është dy gjuhëshe. Në të gjenden shume informacione për kolegjin, programet e studimit, kurrikulën e programit të studimit, programin e lëndës/modulit, (syllabusin), personelin akademik dhe joakademik, aktivitete të ndryshme.etj.</p>

	<p>Në faqen zyrtare të KUB gjenden të publikuara edhe Statuti, Rregullore e Përgjithshme e KUB, Raporti Vjetor të Institucionit, Plani Strategjik i KUB, Raportit vjetor të NJSBC, Raporti i Auditimit të jashtëm të Pasqyrave Financiare vjetore të KUB, Guida e studentit etj, e shumë materiale të tjera për ngjarje dhe evente të ndryshme të Institucionit.</p> <p>Informacioni i përgjithshëm mbi veprimtarinë e KUB-it përcillet nëpërmjet të gjitha kanaleve të informimit dhe social media si: Web, Instagram, Twiter. LinkedIn.</p> <p><i>[Evidenca 1, Statuti i IAL; Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 5. Dosja e Programit të Studimit, Evidenca 63. Guida Studentore 2022-2023; https://en.kub.edu.al/]</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ konkludon se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>institucioni disponon një sistem përmes të cilit administron dokumentacionin që lidhet për informimin e studentëve, regjistrimet, dhe zhvillimin e procesit mësimor;</i> • <i>portali i KUB, si një platformë teknologjike ofron një sërë shërbimesh dhe informacionesh të nevojshme për studentët dhe stafin akademik lidhur me zhvillimin e procesit mësimor;</i> • <i>Nga konsultimi dhe logimi në faqen zyrtare të këtij institucioni, GVJ konstaton se informacioni ofrohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Në këtë faqe, jepet informacion për IAL-KUB, fakultetet, programet e studimit, KUBrikulat, stafin akademik, aktivitete dhe njoftime të ndryshme rreth institucionit si dhe i gjithë dokumentacioni kryesor rregullativ i KUB.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve



<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionin e DDV konstaton se, KUB, bazuar në Ligjin 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, referuar dokumentacionit të depozituar në ASCAL (<i>Statutit të KUB, Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit 2021-2026, Rregullores së KUB, si dhe Rregullores së Programit të Studimit Bachelor ne Ekonomi, me profile: Administrim Biznesi dhe Finance Kontabilitet</i>, siguron financimin dhe mbështetjen financiare për procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor si dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, (<i>Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2022 dhe parashikimi për vitin 2023</i>), konstatohet se janë parashikuar treguesit për të ardhurat, shpenzimet dhe mbështetjen financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>GVJ vlereson se Në Pasqyrat Financiare Vjetore (PF)te KUB jepen të plota dhe të detajuara informacionet për drejtimet se ku janë kryer shpenzimet, duke siguruar kostot sipas zërave kryesore të shpenzimeve për njësinë bazë, përgjegjëse për programin e studimit dhe kryesisht: Kosto dhe burimet e financimit të burimeve njerëzore, në shërbim të realizimit të programeve, kostot operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive, mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, për libra dhe atë on line, kosto për kërkimin shkencor, kosto e reklamës dhe publicitetit, për mirëmbajtje e riparime, kancelari, amortizimet e tjera.</p> <p><i>[Evidenca 1. Statuti i IAL, neni 35-40; Evidenca 2. Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit 2021-2026, Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 6. Rregullore e Dep. AB dhe FK; Evidenca 7. Rregullore e Programit te Studimit BSC ne Ekonomi; Evidenca 20. Raporti vjetor 2021-2022 i KUB; Evidenca 30. Relacion për Realizimin e Buxhetit 2022 dhe Planifikimi 2023 KUB; Evidenca 40. Vendim BA për mbështetjen financiare për Kërkimin Shkencor të KUB]</i></p>
--	---

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.

GVJ, referuar shqyrtimit të dokumentacionit në DVV (*Statutit të KUB, Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit 2021-2026, Rregullores së KUB, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit*, KUB harton planin buxhetor në nivel institucioni, dhe të ndarë sipas njësive kryesore dhe njësive bazë.

GVJ vlerëson se nga shqyrtimi i dokumentacionit, (*Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2021 dhe parashikimi për vitin 2022 si dhe raportit vjetor të KUB për vitin 2022-2023*), konstatohet se janë parashikuar në mënyrë të detajuar të dhënat për të ardhurat që përfshijnë (të ardhurat nga tarifat e studentëve, projektet dhe trajnimet si dhe të ardhura të tjera) dhe shpenzimet të detajuara (në shpenzime operative, për procesin mësimor, kërkimor-shkencor, për investime, për paga, etj) në funksion të mbështetjes financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Gjithashtu konstatohen dhe strukturimi i shpenzimeve duke i detajuar përveç në nivel institucioni, sipas njësive kryesore dhe njësive bazë e deri në nivel programi studimi të tyre.

Gjithashtu institucioni, parashikon, fonde të veçantë për pasurimin e bibliotekës me tekste të reja dhe literaturë shtesë si dhe akses për studentët dhe stafin akademik në bibliotekat online lidhur me procesin mësimor dhe kërkimin-shkencor.

[Evidenca 1. Statuti i IAL, neni 35-40; Evidenca 2. Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit 2021-2026, Evidenca 4. Rregullore e përgjithëshme dhe specifike e funksionimit të njësisë kryesore/bazë; Evidenca 6. Rregullore e Dep. AB dhe FK; Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit BSC në Ekonomi; Evidenca 20. Raporti vjetor 2021-2022 i KUB; Evidenca 30. Relacion për Realizimin e Buxhetit 2022 dhe Planifikimi 2023 KUB; Evidenca 40. Vendim BA për mbështetjen financiare për Kërkimin Shkencor të KUB]

Referuar shqyrtimit të Raportit Vjetor për vitin 2021-2022, analizohen të dhënat për zbatimin e planin buxhetor, strukturën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas viteve dhe për mbështetjen financiare të programeve të studimit. KUB, bazuar në ligjin 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" përgatit, auditon dhe publikon çdo vit pasqyrat financiare. GVJ vlerëson se në Relacionin e PF dhe në Raportin e auditimit financiar, të realizuar nga Kompania ndërkombëtare Grant Thornton, jepen informacione të dedikuara lidhur me politikat

	<p>dhe masën e tarifave që arkëtohen nga studentët, mënyra dhe drejtimet e përdorimit të tyre, duke i dhënë mundësinë për të gjykuar se burimet financiare përdoren në mbështetje dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve të tjera për studentët dhe trajtimin e stafit akademik.</p> <p>Referuar të dhënave të raporteve vjetore buxhetore, institucioni dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare dhe se ka kapacitete të mjaftueshme financiare për mbështetjen në vazhdimësi të programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar në DVV, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, institucioni për çdo vit akademik, organizon mbledhje të hapur me Senatën Akademik, Bordin e Administrimit mbi rezultatet dhe problematikat, referuar raporteve të vlerësimit dhe auditimit.</p> <p>Në takimin e GVJ me përfaqësues të KUB, u konfirmua se në këto mbledhje marrin pjesë pedagogë, studentë dhe personel administrativ.</p> <p>Në raportet vjetore jepen informacione për burimet financiare për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe atij kërkimor-shkencor.</p> <p>Ne përfundim të vitit akademik drejtuesit e institucionit, mbi bazën e raportit vjetor për realizimin e buxhetit të miratuar, raportojnë deri në nivelin e njësisë përgjegjëse për programin e studimit realizimin e buxhetit sipas zërave, duke nxjerrë dhe shkaqet për çdo rast.</p> <p><i>[Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, faqe 63; Evidenca 39.1. Raport Grant Thornton mbi çertifikimin e pasqyrave financiare vjetore, 2022; Evidenca 39. Relacion për Realizimin e Buxhetit 2022 dhe Planifikimi 2023 FE; Evidenca 39.2. Vendim SA dhe Vendimi BA për miratimin e buxhetit 2022]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre</p>	<p>GVJ referuar shqyrtimit të raporteve vjetore buxhetore, konstaton se KUB, disponon burime financiare të qëndrueshme që sigurohen kryesisht nga tarifat e studentëve (80-85%).</p> <p>Gjithashtu, institucioni siguron të ardhura dhe pjesëmarrjet në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Një burim tjetër i të ardhurave sigurohen nga trajnimet dhe kualifikimet e profesionistëve kontabël dhe të Ndermjetësve të Pasurive të Paluajtshme që realizohen edhe nga Instituti për</p>




<p>programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Studime dhe Aplikime në Biznes (ISAB), si pjesë e strukturës së KUB.</p> <p>Referuar të dhënave të dokumentacionit të ngarkuar në faqen e ASCAL-it, (<i>Raport/Relacion për realizimin e treguesve financiar për vitin 2022 dhe parashikimet për vitin 2023</i>), konstatohet se institucioni garanton në vijimësi qëndrueshmëri financiare dhe se ka burime të mjaftueshme për mbështetjen dhe ecurinë normale të programeve të studimit.</p> <p><i>[Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, faqe 61; Evidenca 30.3. Raport i Përfutueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët për Programe e Projekte në kuadër të Erasmus +; Evidenca 28.1. Raporti Vjetor i Punës Kërkimore Shkencore dhe Projektet, Kolegjit Universitar "I Biznesit"; Evidenca 28.2. Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare që janë zhvilluar në KUB përgjatë viteve akademike 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023; Evidenca 28.5. Rankimi i Universiteteve për punën shkencore, 2022; Evidenca 39. Relacion për Realizimin e Buxhetit 2022 dhe Planifikimi 2023 KUB]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • IAL-KUB siguron financimin dhe mbështetjen financiare për procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor si dhe mbarëvajtjen e programit të studimit; • janë parashikuar në mënyrë të detajuar të dhënat për të ardhurat që përfshijnë (të ardhurat nga tarifat e studentëve, projektet dhe trajnimet si dhe të ardhura të tjera) dhe shpenzimet të detajuara (në shpenzime operative, për procesin mësimor, kërkimor-shkencor, për investime, për paga, etj) në funksion të mbështetjes financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit; • Institucioni, parashikon fonde të veçantë për pasurimin e bibliotekës me tekste të reja dhe literaturë shtesë si dhe akses për studentët dhe stafin akademik në bibliotekat online lidhur me procesin mësimor dhe kërkimin-shkencor; • është ngritur dhe funksionon një Sistem Kontrolli i Brendshëm i cili kryen auditimin e brendshëm të institucionit; • Gjithashtu, KUB, i nënshtrohet kontrollit dhe vlerësimit periodik, institucional dhe të programeve të studimit nga ASCAL dhe pasqyrave financiare nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

	<ul style="list-style-type: none"> • Pasqyrat Financiare vjetore të KUB, auditohen gjithashtu nga një kompani ndërkombëtare auditimi "Grant Thornton"; • Raportet e vlerësimit, dhe auditimit, nga strukturat e KUB, si dhe institucionet e pavaruara jashtë KUB-it, publikohen në faqen zyrtare të KUB. • Pasqyrat Financiare se bashku me raportin e auditimit depozitohen ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), ku dhe behen te aksesueshme per cdo person dhe nevoje per publikun. • IAL-KUB, disponon burime financiare të qëndrueshme dhe garanton në vijimësi mbështetjen dhe ecurinë normale të programeve të studimit. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konstaton se KUB ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit që mbulojnë një cikël të plotë të Bachelor në "Ekonomi", me profil: "Administrim Biznesi" dhe "Finance Kontabilitet", nga hyrja deri në diplomim të studentëve. Këto procedura janë të sanksionuara respektivisht në nenin 58-761 të rregullores së institucionit, si dhe në planit strategjik 21-26 të KUB, ku ndër objektivat e kësaj strategjie gjenden edhe objektivat specifike për mësimdhënien dhe mësimnxënien. <i>Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar i Biznesit.pdf</i>

	Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se dokumentet strategjike të KUB, si strategjia e institucionit, rregullore e institucionit 101-113, rregullore e fakultetit, rregullore e programit, rregullore e zhvillimit të provimeve neni 3-6, fokusohen në trajtimin e barabartë dhe sipas meritokracisë, referuar procedurave të përzgjedhjes së studentëve si dhe atyre të vlerësimit të avancimit akademik të tyre. Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar Biznesit.pdf Evidenca 33. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit".pdf
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Referuar takimeve me drejtues së njësisë kryesore dhe asaj bazë, webit zyrtar si dhe DVV, rezulton se institucioni publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u pranuar në programin e studimit Bachelor në "Ekonomi", me profil: "Administrim Biznesi" dhe "Finance Kontabilitet". Këto kriteret miratohen nga senati akademik dhe publikohen në faqen zyrtare. Referuar vendimit të senatit për kriteret e vitit akademik 2022-2023 dhe '23-'24, aksesuar nga GVJ në faqen zyrtare të internetit, rezulton se kriteret janë vetëm kriteret të përgjithshme dhe konkretisht nota mesatare e shkollës së mesme, sipas bazës ligjore. Kriteri për tu pranuar, është mesatarja e shkollës së mesme. Linku në vijim: <u>Pranimet - Kolegji Universitar i Biznesit (kub.edu.al)</u> Evidenca 25.2. Propozimi i Krieteve në MAS 2023-2024.pdf)
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ konstaton se kriteret dhe procedurat e pranimit së studentëve janë të publikuara në webin zyrtar të KUB dhe mund të aksesohen nga të gjithë të interesuarit. Informacioni në ëeb ofrohet edhe për mundësitë e përfitimit të bursës, transferimet, oraret mësimore si dhe për kalendarin e provimeve. Informacioni në web për studentët është i plotë dhe jepet në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Më poshtë linqet e konsultura nga GVJ për këtë kriter. <u>Pranimet - Kolegji Universitar i Biznesit (kub.edu.al)</u> Evidenca 25.2. Propozimi i Krieteve në MAS 2023-2024.pdf) Evidenca 64. Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit të studentëve 2022-2023.pdf Evidenca 25.1. Propozimi i Kuotave në MAS 2022-2023.pdf

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ duke iu referuar DVV si dhe webit të institucionit, konstaton se Kolegji Universitar Reald, realizon informimin e publikut për kërkesat e pranimit në Bachelor në “Ekonomi”, me profil: “Administrim Biznesi” dhe “Finance Kontabilitet” nëpërmjet webit të institucionit, ku publikohen vendimet e senatit akademik të institucionit rreth kriterëve të pranimit apo guides studentore (nenet 12-26)</p> <p><u><i>Kolegji Universitar i Biznesit (kub.edu.al)</i></u></p> <p><i>Evidenca 25.2. Propozimi i Kriterëve në MAS 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 64. Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit të studentëve 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 63. Guida Studentore KUB Viti Akademik 2023-2024.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Referuar dokumentacionit si dhe takimit me drejtues të njësisë kryesore dhe atyre bazë përgjegjëse për programin, ata propozojnë kriteret dhe kuotat për PS, të cilat miratohen nga senati akademik si dhe nga bordi i administrimit dhe i përcillen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përcaktimi i kriterëve për shtresat e marginalizuara si dhe për kandidatët nga shtete të tjera, mbështetet në udhëzimet e MAS. Për sa më sipër, GVJ konsultoi webin e institucionit dhe konstaton se institucioni i publikon në faqen zyrtare, kriteret për pranimin në programet e studimit.</p> <p><i>Evidenca 25.2. Propozimi i Kriterëve në MAS 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 25.3. Miratimi i Kuotave në MAS 2022-2023.pdf</i></p> <p><u><i>Pranimet - Kolegji Universitar i Biznesit (kub.edu.al)</i></u></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Referuar njoftimeve në faqen zyrtare të institucionit, rezulton se kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera si dhe kuotat për ta janë hartuar në përputhje me udhëzimin e MAS nga departamenti, janë miratuar nga senati akademik dhe bordi i administrimit i KUB, si dhe janë publikuar për informim të gjerë të palëve të interesuara. Fokusi i këtyre kriterëve, vendoset tek mesatarja e shkollës mesme.</p> <p><i>Evidenca 25.2. Propozimi i Kriterëve në MAS 2023-2024.pdf</i></p> <p><u><i>Pranimet - Kolegji Universitar i Biznesit (kub.edu.al)</i></u></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për</p>	<p>Referuar faqes zyrtare të internetit të institucionit si dhe DVV, GVJ konstaton se institucioni ofron informacion të plotë për përfitimin e bursave, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Këto bursa parqiten</p>

<p>shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>si bursa merite ose bursa financiare apo përjashtim nga pagesat e tarifave për shtresat në nevojë në përputhje me vendimet që Bordi i Administrimit merr. Në DVV institucioni vendos në dispozicion edhe vendime të BOA për bursat. Në këtë vendim GVJ konstaton se për 2022-23, bursat janë 100% për studentët ekselentë me mesatare 10 dhe 50% bursë për studentët e komunitetit romë-egjiptian apo që janë me aftësi ndryshe.</p> <p><i>Evidenca 49. Listat e miratimit të studentëve të cilët përfitojnë Bursa për Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 64. Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit të studentëve 2022-2023.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, mbështetur në dokumentacion në DVV si dhe nga vizita në institucion, është e mendimit se institucioni, harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Bachelor në Ekonomi me profile. Këto gjenden në rregulloren e institucionit, të fakultetit, të programit si dhe ato publikohen e janë të aksesueshme në ëeb e institucionit në dy gjuhë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga DVV, GVJ konstaton se KUB ofron informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregulloren e institucionit neni 101, të njësisë kryesore si dhe të programit bachelor në “Ekonomi” me profile, neni 3. GVJ vlerëson se ky informim bëhet në forma alternative, nëpërmjet sekretarisë mësimore, nëpërmjet zyrës së këshillimit si dhe nëpërmjet ëebit të fakultetit.</p>

	<p><i>Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit".pdf</i></p> <p><i>Evidenca 50. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karierrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se KUB në faqen zyrtare publikon kriteret për transferimet për informim të gjerë, gjithashtu nga takimi me studentët rezulton se informohen parimisht nëpërmjet akteve të cituara në kriterin më sipër dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit, por ata preferonin më tepër informimin fizikisht, nëpërmjet zyrës së këshillimit dhe karrierës, sekretarisë mësimore dhe departamenteve përkatëse.</p> <p><u><i>Pranimet/transferimet - Kolegji Universitar i Biznesit (kub.edu.al)</i></u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Referuar DVV, por edhe takimeve me studentët e programit si dhe stafin e programit, GVJ konstaton nga takimet me stafin dhe studentët, se ata informohen nga pedagogët e çdo lënde në orën e parë të semestrit për syllabuset, detyrimet lëndore, kriteret e vlerësimit, etj, këto kritere janë pjesë të rregullores së institucionit dhe të rregullores së programit që gjithashtu rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të IAL.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Për GVJ rezulton se informimi për punimin e diplomës bëhet nga udhëheqësit e studentëve dhe nëpërmjet Udhëzuesit të punimit të diplomës si dhe nëpërmjet sekretarive për afatet dhe detyrimet, që duhen përmbushur para diplomimit. Përveç kësaj, institucioni ka rregulluar me akt të posaçëm rregullativ procesin e diplomimit dhe informon studentët nëpërmjet webit si dhe stafit akademik apo administrativ për detyrimet që kanë sipas kësaj rregulloreje të diplomimit.</p> <p><i>Evidenca 59. Udhëzuesi për punimin e temës së diplomës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 59.1. Miratimi i temës së diplomës nga dekani FE.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve</p>	<p>Rezultun nga DVV se institucioni organizon ditë informuese dhe orientuese për studentët e ardhshëm të programit në shkollat e mesme. Të interesuarit informohen edhe me anë të mesazheve promociionale, nëpërmjet shpërndarjes së fletëpalosjeve si dhe pjesëmarrjes në panairin e studimeve.</p> <p><i>Evidenca 63. Guida Studentore KUB Viti Akademik 2023-2024.pdf</i></p>

të ardhshëm mbi programin e studimit.	<i>Evidenca 65. Fletë Palosje Informative për Vitin Akademik 2023-2024.pdf</i> <i>Evidenca 66. Program i panairit Work and Study.pdf</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni ofron mundësi informimi për studentët për: <ul style="list-style-type: none"> - procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve - kuotat, transferimet, - për detyrimet lëndore, - për punimin e temës së diplomës - si dhe informim për studentët e ardhshëm. <p>Kanalet e informimit janë të ndryshme, nëpërmjet sekretarisë mësimore, nëpërmjet zyrës së këshillimit, nëpërmjet webit të fakulteti, ditëve të informimit, etj.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstatoi se institucioni informon studentët me informacion të plotë lidhur me programin. Ky informacion konsiston, në kohëzgjatjen e programit, strukturën e çdo semestri, formën e organizimit, detyrimet që studentët kanë etj. GVJ konstatoi se ky informim realizohet nga departamenti dhe stafi akademik nëpërmjet syllabuseve, strukturat e sekretarisë mësimore si dhe zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës për orarin mesimor si dhe për kalendarin e provimeve etj. Studentët rezultojnë se informohen gjithashtu në distancë nëpërmjet faqes zyrtare, apo fletëpalosjeve që paraqesin informacion për programin e studimit bachelor në Ekonomi me profile. <i>Orari i Semestrit të dytë - Kolegji Universitar i Biznesit (kub.edu.al)</i> <i>Evidenca 33.1. Urdhër Rektori për miratimin e Kalendarit të Provimeve.pdf</i> <i>Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit 1-5.pdf</i>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se gjatë takimeve me drejtues të njësisë bazë, me stafin e programit dhe studentët e PS në Bachelor në Ekonomi me profile, se çdo pedagog gjatë javës së parë të çdo viti, informon në mënyrë specifike për studentët për lëndën, syllabusin, literaturën dhe detyrimet akademike të çdo lënde, format dhe skemat e vlerësimit që janë të sanksionuara në rregullore dhe në syllabuse, etj.</p> <p><i>Evidenca 15. Dosja e Programit të Studimit 1-5.pdf (plan mësimor dhe syllabuseve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësues të zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, rezulton se kjo zyrë zhvillon aktivitete për orientimin në tregun e punës, pjesëmarrje në panairë të punës. Gjithashtu nga takimet rezulton se në bashkëpunim me kompanitë që ka bashkëpunime, informon studentët për mundësitë e punësimit që ato ofrojnë. GVJ konstaton në webin e IAL, njoftime të shpeshta për mundësi punësimi të studentëve, duke ofruar informim, orientim dhe mentorim për ta.</p> <p><i>Evidenca 66. Program i panairit Work and Study.pdf</i></p> <p><u><i>Leksion i hapur mbi mundësitë e punësimit të studentëve të KUB nga TSTS Group - Kolegji Universitar i Biznesit</i></u></p> <p><u><i>Explore Deloitte tashmë në ambientet e KUB për mundësi kntershipi, praktike dhe punësimi për studentët tanë - Kolegji Universitar i Biznesit</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët rezultojnë të informuar rreth procesit mësimor, lëndëve, programeve, formave të vlerësimit, infrastrukturës në shërbim të tyre etj. Rezultoi se institucioni realizon edhe ditë të hapura për studentët e rinj sipas një kalendari informues, jo vetëm për procesin mësimor por edhe për aktivitete të tjera dhe shërbimet që ofrojnë zyrat mbështetëse, për shërbimet e sekretarisë, të sektorit të bibliotekës etj.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i</p>	<p>GVJ konstaton gjatë vizitës në institucion, se sistemi elektronik (portali), mundëson akses në informacion lidhur me procesin mësimor, syllabuset, leksionet e parashkuara apo prezantimet në poëerpoint në hapësirën e pedagogut, detyrimet lëndore, oraret e mësimit dhe kalendarin e provimeve, vlerësimin e çdo lënde etj. Gjithashtu për studentet e ardhshëm apo për publikun e gjerë, një pjesë esenciale e këtij informacioni konstatohet se ofrohet edhe nepërmjet ëebit zyrtar në dy gjuhë: shqip, anglisht. <u><i>GVJ sugjeron</i></u></p>

arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<i>intensifikimin e procesit për të implementuar sistemin elektronik të manaxhimit të informacionit të integruar.</i>			
	<i>University College of Business - (ucb.edu.al)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ është e mendimit se institucioni informon për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet nëpërmjet sekretarisë mësimore, stafit akademik, portalit si dhe faqes zyrtare të internetit në dy gjuhë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4													
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.													
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga takimet me drejtues të njësive bazë dhe me sekretarinë, konstaton se KUB harton dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në PS Bachelor në “Ekonomi” me profile. Referuar regjistrave themeltarë, nga vizita në institucion dhe nga tabela 21 në Aneksat e RVB, rezulton se numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik është:</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td>2019</td> <td>2020</td> <td>32 studentë</td> </tr> <tr> <td>2020</td> <td>2021</td> <td>36 studentë;</td> </tr> <tr> <td>2021</td> <td>2022</td> <td>33 studentë;</td> </tr> <tr> <td>2022</td> <td>2023</td> <td>20 studentë;</td> </tr> </table> <p><i>Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_TI.pdf</i> <i>Evidenca 46.1. Regjistri i te dhenave te studenteveAMZA.pdf</i></p>	2019	2020	32 studentë	2020	2021	36 studentë;	2021	2022	33 studentë;	2022	2023	20 studentë;
2019	2020	32 studentë											
2020	2021	36 studentë;											
2021	2022	33 studentë;											
2022	2023	20 studentë;											
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e	GVJ referuar të dhënave dhe regjistrave që institucioni mban, konstaton se KUB mban të dhëna të vazhdueshme për ecurinë e studentëve deri në diplomim, vlerësimet e tyre në çdo lëndë, rregjistrime këto që përveç procesverbaleve analitike të çdo lënde në												

<p>studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>hard copy, hidhen edhe në regjistrat themeltar ku çdo student rezulton i regjistruar dhe është pajisur me numer matricullimi. Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e shkollës së mesme, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit, mandat pagesë, etj.</p> <p><i>Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_TI.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 46.2. Regjistri i Rezultateveperformances se studentit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se, të dhënat për studentët si regjistrimet, vlerësimet e çdo lënde, detyrimet akademike të studentëve, mbahen manualisht ne sekretarine e KUB, si dhe në mënyrë elektronike në sistemin e kompjuterik nga sekretaria, sipas procedurave që parashikohen për këtë system dhe në portalin e IAL. Këto forma të kombinuara të mbajtjes së të dhënave, fizikisht dhe elektronikisht, GVJ i vlerëson pozitivisht, sepse rrisin sigurinë e ruajtjes së të dhënave, por edhe shpejtësinë e sigurimit të informacionit nga përdoruesit e autorizuar të sistemit.</p> <p><i>Evidenca 46.2. Regjistri i Rezultateveperformances se studentit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 46.1. Regjistri i te dhenave te studenteveAMZA.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar, konstaton se proceset mbikqyrëse si dhe strukturat që kanë përgjegjësinë e kryerjes së proceseve mbikëqyrëse dhe të monitorimit janë të sanksionuara në aktet rregullative të institucionit. Këto përgjegjësi ushtrohen nga strukturat e departamentit apo fakultetit.</p> <p>GVJ konstaton nga vizita në institucion, se KUB emeton në mënyrë të vazhdueshme akte të brendshme rregullative, për të orientuar mirëfunksionimin e strukturave të brendshme, si sekretaria, burimet njerëzore, zyrat e këshillimit të karrierës dhe Alumnit, etj</p> <p>Në këto akte të brendshme të institucionit, një hapësirë të vecantë, konstatohet se zënë aktet e monitorimit dhe kontrollit për funksionimin efektiv të këtyre strukturave, për zbatimin e ligjshmërisë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për studentët.</p> <p><i>Evidenca 33.6. Proces Verbal Verifikimi te dhenash regjistër amze arritje akademike.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i KUB.pdf</i></p>

<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>KUB disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi (mesataren në hyrje dhe në dalje), deri në diplomimin e tyre dhe rezultojnë se i analizojnë ato në analizat vjetore. GVJ mbështetur në DVV, konstatoi se këto të dhëna bëhen pjesë e analizës së departamentit dhe raportit vjetor në nivel institucioni dhe shoqërohen me plan masash.</p> <p><i>Evidenca 72. Tabelat Përmbledhëse ANEKS_RVB_BSc_TI.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 21.2. Analiza Mësimore Kërkimore DFK 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 21.3. Analiza Mësimore Kërkimore DM 2022-2023.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ gjykon se institucioni administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit Bachelor në "Ekonomi" me profile, nga pranimi deri në diplomim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>E drejta për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është e sanksionuar në LAL 80/2015, dhe në Statutin e KUB neni 17. GVJ konstatoi nga RVB dhe nga informacioni në DVV se studentët janë të përfaqësuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësine e Sigurimit të cilësisë; - Senatin akademik; - Grupin e vlerësimit të brendshëm institucional dhe GVB programore; <p>Gjithashtu studentët kanë krijuar këshillat studentore për të cilët rezultojnë se institucioni i mbështet me financim si dhe me infrastrukturë që të funksionojnë.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i KUB.pdf</i></p>



	<p><i>Evidenca 50. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit, studentët rezultojnë pjesë e komisioneve të vetëvlerësimit të institucional dhe programor. Pjesëmarrja e tyre në këto procese të vlerësimit të brendshëm, krijon mundësinë që studentët të përcjellin përceptimin e tyre, sugjerimet e tyre për proceset mësimore, funksionimin e strukturave të institucionit etj. Studentët përcjellin mendimet e tyre edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në anketimin që bëhet çdo semestër për vlerësimin e procesit akademik dhe të infrastrukturës së institucionit që zhvillohen nga Njësia e Sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe nga struktura të jashtme të pavarura si Instituti për cilësi në edukim.</p> <p><i>Evidenca 41.3. Pyetësor i plotësuar i një studenti të programit të studimit BSc Ekonomi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 41.2. Plani i aktiviteteve për përmbushje të rezultateve të pyetesorëve në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga takimi me drejtues të njësisë bazë, rezultoi se përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të PS në Bachelor në Ekonomi me profile, është indirekt nëpërmjet feedbackut që njësia bazë merr prej pyetësorit të studentëve që zhvillohen dy herë në vit nga NJSBC, si dhe nëpërmjet përfshirjes së tyre në GVB si dhe feedbackut të pyetësorit të IQE (Instituti për cilësi në edukim)</p> <p>GVJ vlerëson përfshirjen e studentëve në anketat e zhvilluar për vlerësimin e procesit mësimor, megjithatë <i>rekomandohet që krahas zhvillimit të pyetësorit të përdoren edhe instrumenta të tjerë në funksion të përmirësimit të programit, nëpërmjet përfshirjes së përceptimit të studentëve.</i> Psh, mbledhjet e hapura të departamenteve, me pjesëmarrjen e studentëve etj. Këto mund të shërbejnë si instrumente për të matur përceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi dhe përmirësimin e tij në vazhdimësi, nëse pyetësorët nuk e ofrojnë këtë informacion.</p> <p><i>Evidenca 41.3. Pyetësor i plotësuar i një studenti të programit të studimit BSc Ekonomi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 41.2. Plani i aktiviteteve për përmbushje të rezultateve të pyetesorëve në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 41. Raporti i NJSBC për rezultatet e pyetesorëve në Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p>

<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre. Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët, studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit, konsultimit me tezën e provimit e më pas pedagogu i lëndës vendos notën përfundimtare. Nëse studenti sërish e ankimon këtë rezultat, i drejtohet me shkrim përgjegjës të departamentit, për të ngritur një komision të ri për rishikimin e rezultatit. Gjithashtu nëpërmjet anketimeve semestrale, studentët kanë të drejtë të shprehin përceptimet e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.</p> <p><i>Evidenca 41.3. Pyetësor i plotësuar i një studenti të programit të studimit BSc Ekonomi.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ është e mendimit se studentët rezultojnë të përfaqësuar në një sërë komisionesh dhe strukturash vendimarrëse. Pavarësisht sa më sipër, rekomandohet që krahas zhvillimit të pyetësorit të përdoren edhe instrumenta të tjerë në funksion të përmirësimit të programit, nëpërmjet përfshirjes së përceptimit të studentëve. Psh, mbledhjet e hapura të departamenteve, me pjesëmarrjen e studentëve etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se KUB nëpërmjet njësisë të posaçme në strukturën organizative, zhvillon procedura në shërbim të informimit të studentëve mbështetur në statutin edhe rregulloren e tij. Përsa më sipër, është zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës dhe sekretaria mësimore, të cilët në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe atë bazë, informojnë studentët.</p> <p>Nga dokumentacioni i depozituar në DVV, si dhe nga takimi me përfaqësues të zyrave si dhe studentët, rezultoi se këto zyra, informojnë periodikisht, studentët për vlerësimet lëndore, për kriteret dhe procedurat e regjistrimit të studentëve,</p>

	<p>mundësitë e leksioneve të hapura, të trajnimeve të mundshme, të mobiliteteve Erasmus +, mundësitë e kryerjes së praktikave apo edhe punësimit potencial, etj. Këto zyra informojnë studentët edhe për kërkesa specifike dhe të vazhdueshme që studentët mund të kenë, përvec informimit periodik të strukturuar që ato bëjnë.</p> <p><i>Evidenca 50. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KUB ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, që kanë përbërje të tyre, struktura në nivel institucioni siç është, zyra Studentëve dhe Këshillimit të Karrierrës si dhe sekretaria mësimore. Në ndihmë të këtij informimi është edhe faqja zyrtare e KUB, portal I KUB si dhe rrjetet sociale të tij. GVJ u informua gjatë vizitës në institucion se KUB është angazhuar në përmirësimin e sistemit të informacionit si si një sistem i integruar bashkëkohor, por që është ende në process.</p> <p><i>GVJ sugjeron intensifikimin e procesit për të implementuar sistemin elektronik të manaxhimit të informacionit të integruar.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Referuar Statutit dhe Rregullores së institucionit janë të sanksionuara detyrat që zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierrës, duhet të kryejë. GVJ konstatoi aktivitete informimi me maturantët të kryer nga kjo zyrë mbi bazën e një kalendari paraprak, aktivitete informimi për studentët e vitit të parë etj. Nga vizita në institucion dhe takimet me përfaqësues të zyrës së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierrës si dhe studentët e programit, rezultoi se studentët informohen për mundësitë e zhvillimit të praktikës profesionale si dhe institucionet disponibël.</p> <p><i>Evidenca 63. Guida Studentore KUB Viti Akademik 2023-2024.pdf</i> <i>Evidenca 50. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni si dhe nga takimet me përfaqësues të zyrës së studentve dhe të këshillimit të karrierës si dhe me studentët e programit, konstatoi se KUB ka krijuar Rrjetin Alumni. GVJ konstatoi se institucioni mban statistika të punësimit të studentëve</p>

<p>punësimin të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>që kanë mbaruar Bachelor në “Ekonomi” me profile dhe i analizon dhe raporton ato për vendimmarrësit.</p> <p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se IAL, se nëpërmjet një pyetësori, rezultoi se zyra e studentëve dhe këshillimit të karrierës, mbledh informacionin për studentët e diplomuar si dhe për punësimin e tyre post diplomimi, përveçse në mënyrë të vazhdueshme i informon ata për mundësi internshipi, punësimi etj.</p> <p>Të dhënat e siguruara, rezultojnë se përpunohen analizohen dhe hartohet një raport, për shkallën dhe cilësinë e punësimin të tyre.</p> <p><i>Evidenca nr. 24. Të dhëna përmbledhese për punësimin real të studentëve.pdf</i></p> <p><i>Dok. 54. Të dhënat e punësimin të StudentëveAlumni në KUB 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca Alumni.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ është e mendimit se KUB ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme dhe janë të arritshme nga studentët. Zyra e studentëve dhe këshillimit të karrierës, ofron informim të vazhdueshëm, për mundësitë e praktikave apo mundësitë për punësim të studentëve si dhe gjurmon studentët dhe analizon shkallën dhe cilësinë e punësimin. Mbi gjetjet nga ky Gjurmim, rezultojnë të bëhen analiza dhe të hartohet një raport që i vendoset vendimmarrësve në institucion , në dispozicion.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ referuar dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimeve me stafin akademik dhe atë drejtues të programit, konstaton se KUB në mënyrë të përvitshme harton plan masash para fillimit të vitit akademik ku orientohet dhe nxitet përdorimi i metodave innovative në funksion të objektivave të mësimdhënies. Gjithashtu konstatohet se KUB ka hartuar udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit në mësimdhënie me qëllimin e lehtësimit të komunikimit për stafin akademik dhe studentët. Rezulton se platforma e përdorur është Google4Education. Studentët dhe stafi logohen nëpërmjet portalit në platformë dhe mund të aksesojmë hapësirën e rezervuar student/staf për leksionet ppt, quizze etj.</p> <p><i>Evidenca 3. Plani i masave të Kolegjit Universitar "I Biznesit", për vitin akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 62.2. Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 62.1. Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 63. Guida Studentore KUB Viti Akademik 2023-2024.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe takimeve me strukturat drejtuese dhe mbështetëse, GVJ konstaton se strukturat e njësitë bazë DFK dhe DM si dhe njësitë kryesore përgjegjëse për programin si dhe njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zbatojnë disa instrumenta të monitorimit të mësimdhënies, si kontrolli i zhvillimit të mësimin, aplikimin e pyetësorëve si instrument i vlerësimit të procesit të mësimdhënies, vlerësimit të performancës së stafit akademik në disa fusha, pyetësorëve për vlerësimin e infrastrukturës së KUB etj. GVJ konstatoi se përveç strukturave të brendshme të kontrollit të cilësisë KUB përdor edhe mekanizma monitorimes dhe struktura të jashtme, sic janë pyetësorët e stafit dhe studentëve nga Instituti për cilësi në arsim, që prodhon raporte periodike për cilësinë në KUB.</p> <p><i>Evidenca 45.1. Format Pyetësori i Studentëve IQE.pdf</i></p>

	<p><i>Evidenca 44.1. Format Pyetësori i Stafit IQE.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 43.1. Format Pyetësori i Stafit KUB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca Raporti i NJSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca Raporti i IQE për Staf Akademik, 2021.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit si dhe me stafin e zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se pyetësori zhvillohet para përfundimit të çdo semestri dhe synon përfshirjen e të gjithë studentëve të programit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, format alternative të saj, vlerësimin e dijeve etj. Zhvillohen dy lloj pyetësorësh, prej KUB dhe nga IQE. Gjithashtu nga takimi me NJSBC dhe studentët rezulton se përdoren edhe instrumente si focus grupet me studentët për të siguruar një feedback më të plotë, më të argumentuar dhe qasjen e studentëve për cilësinë.</p> <p>Ankimimi rezulton të jetë i sanksionuar në rregullore dhe shqyrtohen mbështetur në procedurat që rregullorja e fakultetit parashikon (neni 16).</p> <p><i>Evidenca 45.1. Format Pyetësori i Studentëve IQE.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 43. Format Pyetësori i Studentëve KUB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 41.3. Pyetësori i plotësuar i një studenti të programit të studimit BSc Ekonomi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FE.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se zyra e NJSBC, zyra e Kurrikulave si dhe njësitë bazë DFK dhe DM janë strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. NJSBC harton një raport vjetor me rezultatet e pyetësorit, i cili shqyrtohet nga strukturat vendimmarrëse në nivel institucioni njësie kryesore dhe njësie bazë. Të dhënat e pyetësorëve bëhen pjesë e analizave vjetore të njësive bazë të cilat shqyrtohen në mbledhjet e departamenteve, ndërkohë që rezultatet për çdo anëtar stafi diskutohen individualisht me drejtuesit të njësisë bazë dhe çdo anëtar stafi akademik. Pjesë të këtij raporti përfshihen edhe në raportin vjetor të institucionit i cili bëhet public. Nga takimi me NJSBC rezulton se të dy vlerësimet dhe raportet e hartuara nga NJSBC dhe nga Instituti për Cilësi në Arsim i drejtohen Senatit akademik të KUB, i cili i analizon dhe në varësi të gjetjeve lihen rekomandime dhe hartohet plan masash për ti përmbushur ato.</p>

	<p><i>Evidenca 41. Raporti i NjSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 21.3. Analiza Mësimore Kërkimore DM 2022-2023.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Raporti publikohet në terma të përgjithshëm të gjetjeve, ndërsa rezultatet individuale ndahen në mënyrë konfidenciale anëtarëve të stafit akademik. Në analizat e departamenteve rezultojnë se diskutohen gjetjet kryesore duke synuar edhe përforsimin e praktikave të mira.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ lidhur me këtë standard, është i mendimit se KUB, ka një politikë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të mësimdhënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Referuar strukturave të sigurimit të cilësisë, rezultojnë se KUB, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Cilësisë në nivel IAL, që nga 2012 me vendim të BA, (sipas ligjit 80/2015), që kryejnë procedurat administrative për monitorimin e cilësisë, organizimin e pyetësorit, përpunimin e tij dhe hartimin e raportit si dhe strukturat e njësisë bazë dhe kryesore, të cilat ndjekin monitorimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes së programit të studimit Bachelor në Ekonomi me profile. Këto struktura funksionojnë mbi bazë të statutit (neni 81, 82) dhe rregullores së KUB (neni 111, 112) si dhe rregullores së NJSBC, neni 21.</p> <p><i>Evidenca 14. Rregullore e zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf</i></p>

	<p><i>Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit".pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i KUB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Referuar përbërjes së Njësisë të Sigurimit të Cilësisë, ai rezulton të ketë në përbërje 6 anatarë, ndër të cilët ka të paktën një përfaqësues nga cdo njësi kryesore si dhe një anatar përfaqësues të studentëve (tabela 24, ankeset). Kjo strukturë funksionon mbi bazë të rregullores së NJSBC. Kjo njësi ka rol kryesor në implementimin e strategjisë së KUB së bashku me strukturat e tjera, por me fokus përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. IAL synon të sigurojë edhe një qasje të pavarur për cilësinë, ku nëpërmjet marrveshjes me Institutin për Cilësi në Arsim, realizohen një vlerësim I pavarur I cilësisë nga IQE, nëpërmjet pyetësorëve drejtuar studentëve dhe stafit akademik si dhe vlerësimin e tyre dhe hartimin e një raporti. GVJ vlerëson pozitivisht këtë praktikë të ndjekur nga institucioni, për të realizuar një vlerësim sa më të plotë dhe objektiv të cilësisë në KUB.</p> <p><i>Evidenca 14. Rregullore e zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit".pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i KUB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>KUB rezulton të ketë përfunduar akreditimin institucional si dhe i nënshtrohet akreditimit të programit, siç është edhe ky proces vlerësimi. Përveç akreditimit institucional si sigurimi i jashtëm i cilësisë, institucioni realizon procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë nga NJSBC.</p> <p>Referuar raportit të cilësisë, rezulton se analizohen disa indikatorë në terma sasiorë sipas frekuencës në përgjigje të studentëve, fokus grupeve etj, për pyetjet që përmban pyetësori dhe mbi to konstatohet se janë lënë rekomandime nga grupi zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të cilat rezulton se është hartuar edhe plan masash.</p> <p>Sigurimi jashtëm i cilësisë realizohet edhe nëpërmjet pyetësorëve të që IQE aplikon.</p> <p><i>Evidenca 14. Rregullore e zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 41. Raporti i NJSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p>

	<i>Evidenca 41.2. Plani i aktiviteteve për përmbushje të rezultateve të pyetësorëve në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB.pdf</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	<p>Nga dosja e vlerësimit të brendshëm dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se përdoren disa mekanizma, si monitorim i vazhdueshëm nga njësi bazë/kryesore, sondazhi i studentëve me një periodicitet dy herë/vit për vlerësimin akademik nga KUB si dhe nga IQE, pyetësi për vlerësimin e infrastrukturës si dhe pyetësi i për stafin akademik, focus grupe me studentët etj.</p> <p>Siç u konstatua dhe diskutua edhe gjatë vizitës në institucion, rezultatet e pyetësorëve iu shpërndahen edhe individualisht stafit akademik dhe rezultatet diskutohen individualisht duke orientuar dhe rekomanduar nëse ka vend për përmirësim.</p> <p><i>Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 41. Raporti i NjsBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KUB, harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Ekonomi" me profile, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij.	GVJ identifikoi disa mekanizma të përdorur formal - sondazhe çdo fund semestri nga KUB dhe IQE, për të vlerësuar aspekte të cilësisë së programeve të studimit, relacion mbi sezonet e provimeve, kontroll i evidencave dhe regjistrave, anketimet periodike të studentëve si dhe relacion për zhvillimin e praktikave dhe të diplomave, etj. Nga vizita në institucion dhe takimet me përfaqësues të zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezultojnë se rezultatet e sondazheve të studentëve dokumentohen dhe analizohen, hartohet në vijim një raport përmbledhës që përmban rekomandime sipas gjetjeve, duke synuar të

<p>Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>adresoje problematikat e hasura nga sondazhet nëpërmjet drejtuesit të njësisë bazë, të njësisë kryesore apo strukturave të tjera që kanë në përgjegjësinë e tyre problematikën e identifikuar dhe që gjetjet i bëjnë pjesë të analizës vjetore të njësisë bazë. Gjithashtu institucioni nëpërmjet një procesi formal, ka ngritur GVB, që ka hartuar RVB dhe ka përgatitur dosjen e vetëvlerësimit për qëllim akreditimi, dokumentacionit të së cilës, i jemi referuar vazhdimisht si GVJ, gjatë këtij procesi.</p> <p><i>Evidenca 21.2. Analiza Mësimore Kërkimore DFK 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 41. Raporti i NjSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 45.3. Vendim i SA për miratimin e planit të punës për realizimin e rekomandimeve të IQE 2021.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Referuar RVB, rezulton se raporti i vlerësimit të brendshëm, përmban pikat e forta dhe të dobta të PS Bachelor në “Ekonomi” me profile.</p> <p>Gjithashtu referuar raportit vjetor të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ai përmban analizën e gjetjeve kryesore dhe rekomandime të lëna për adresimin e problematikave, për strukturat specifike akademike dhe/ ose administrative të KUB. <i>GVJ konstaton se është hartuar edhe plani masave për adresimin e problematikave të identifikuara.</i></p> <p><i>Evidenca 45.3. Vendim i SA për miratimin e planit të punës për realizimin e rekomandimeve të IQE 2021.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 41. Raporti i NjSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së</p>	<p>GVJ konstatoi se në programin e studimit Bachelor në “Ekonomi” me profile, përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, të cilat shihen se janë të përfshira në seksionet e pyetësorit që aplikohet deri tani, në sondazhet e studentëve. Gjithashtu nga takimi me NJSBC në institucion u konstatuan edhe përdorimi i mekanizmave të tjerë si kontrolli i një kampioni provimesh, kontrolle në auditor si dhe kontrolli i respektimit të standardeve në hartimin e tezës etj.</p> <p><i>Evidenca 43. Format Pyetësori i Studentëve KUB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 41.3. Pyetësori i plotësuar i një studenti të programit të studimit BSc Ekonomi.pdf</i></p>

<p>ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Evidenca 41.2. <i>Plani i aktiviteteve për përmbushje të rezultateve të pyetësorëve në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB.pdf</i></p> <p>Evidenca 41.5. <i>Raport mbi kontrollin provimeve online.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Siç GVJ është shprehur edhe për vlerësimin e kritereve më sipër, KUB për vlerësimin e cilësisë, përdor sondazhin e studentëve dhe sondazhin e stafit akademik nëpërmjet NJSBC si dhe nëpërmjet IQE, monitorimin e proceseve mësimore dhe vlerësimin e performances së stafit akademik.</p> <p><i>GVJ sugjeron krijimin e një Keshilli/Bordi Pune formal, i cili do të krijonte mundësi për të tërhequr opinionin e bizneseve lokale dhe Alumnit dhe sugjerimet për përshtatjen me kërkesat në zhvillim të tregut të punës për aftësi dhe zotësi që studentët e diplomuar duhet të kenë, në përfundim të programit të studimit Bachelor në “Ekonomi” me profile, për të qenë më konkurrues në tregun rajonal dhe më gjerë.</i></p> <p>Evidenca 43. <i>Format Pyetësori i Studentëve KUB.pdf</i></p> <p>Evidenca 41.3. <i>Pyetësor i plotësuar i një studenti të programit të studimit BSc Ekonomi.pdf</i></p> <p>Evidenca 41. <i>Raporti i NJSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p>Evidenca 42.1. <i>Vlerësim Performance stafi personalizuar.pdf</i></p> <p>Evidenca 41. 33.3. <i>Formular i vlerësimit të vazhduar_TIP.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ është e mendimit se KUB monitoron dhe vlerëson përmes NJSBC, njësisë bazë dhe kryesore, në mënyrë periodike programin e studimit, Bachelor në “Ekonomi” me profile, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në përbërje të njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se çdo njësi kryesore ka përfaqësues të saj. Gjithashtu, studentët përfaqësohen nga një anëtar, duke garantuar përfaqësim të gjithë aktorëve të brendshëm, staf akademik dhe studentë. GVJ sugjeron që pjesë e NJSBC, të jetë edhe një ekspert i jashtëm nga i cili institucioni mund të marrë sugjerime për përputhshmërinë e programeve të studimit me kërkesat e biznesit lokal dhe tregut të punës, pavarësisht se një process I jashtëm zhvillohet nga IQE.</p> <p><i>Evidenca 43. Format Pyetëtori i Studentëve KUB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 41.3. Pyetësor i plotësuar i një studenti të programit të studimit BSc Ekonomi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 41. Raporti i NJSBC për rezultatet e pyetësorëve në Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Të gjitha strukturat e përfshira në sigurimin e cilësisë, si NJSBC, njësia kryesore, njësia bazë etj, i kanë të sanksionuara të drejtat dhe detyrimet e tyre në Rregulloren e institucionit. NJSBC, gjithashtu operon mbështetur në rregulloren e organizimit të NJSBC. Në këto akte rregullative rezultojnë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e palëve si dhe procedurat që ndiqen.</p> <p><i>Evidenca 14. Rregullore e zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i KUB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 4. Rregullore e "Kolegjit Universitar i Biznesit".pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe</p>	<p>Konstatohet se anëtarë të njësisë kryesore janë pjesë e NJSBC përveç faktit që siç rezultoi nga vizita në institucion, anëtarët e departamentit janë pjesë edhe e grupeve të vlerësimit të brendshëm programor. Gjithashtu studentët kanë përfaqësuesin e vetë, në NJSBC si dhe në GVB. Përfshirja e të gjitha palëve krijon mundësinë e sjelljes së këndvështrimeve të ndryshme dhe adresimin e çështjeve që janë me interes të gjerë për cilësinë e PS Bachelor në "Ekonomi" me profile, si për stafin akademik, studentët dhe institucionin në tërësi.</p> <p><i>Evidenca 58. Vendim SA për përberjen e anëtarëve të NJSBC.pdf</i></p>

studentëve e programit të studimit.				
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se pyetësorët zhvillohen anonim, që studentët të trajtojnë me sa më shumë objektivitet informacionin konfidencial, përpunimi i tyre dhe analizimi bëhet në terma të përgjithshëm, publikimi i gjetjeve është në respekt të integritetit akademik dhe synon të shmangë diskriminimin apo pabarazinë kundrejt personelit të vlerësuar dhe studentëve që kanë vlerësuar. Rezultatet e pyetësorëve ju shpërndahen stafëve individualisht dhe çështjet problematike, rezulton se diskutohen në diskrecion, për të ruajtur integritetin akademik.</p> <p><i>Evidenca 21.3. Analiza Mësimore Kërkimore DM 2022-2023.pdf</i> <i>Evidenca 41.5. Raport mbi kontrollin provimeve online.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Refereuar NJSBC ka në përbërje të saj edhe një student, që parimisht mund të sjellë një këndvështrim të rëndësishëm, nën optikën e kërkesve të studentëve, duke garantuar përfaqësim të gjithë aktorëve të brendshëm, staf akademik dhe studentë. GVJ në vendimin e senatit për krijimin e NJSBC, nuk konstatoi ekspertë të jashtëm. Institucioni, siguron edhe një proces vlerësimi të jashtëm nëpërmjet IQE dhe GVJ vlerëson pozitivisht këtë praktikë të ndjekur nga institucioni. Pavarësisht sa më sipër, GVJ do të sugjeronte që institucioni të përfshinte në NJSBC edhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programet e studimit dhe që mund të ofrojnë ekspertizë në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij.</p> <p><i>Evidenca 58. Dok. 58. Vendim SA për përberjen e anëtarëve të NJSBC.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ është e mendimit se KUB përfshin të gjithë aktorët e brendshëm, staf akademik, njësi kryesore, bazë dhe NJSBC, në sigurimin e cilësisë. Në këto struktura ka përfaqësues të studentëve. GVJ sugjeron edhe përfshirjen e një eksperti të jashtëm në NJSBC, që mund të ofrojnë ekspertizë në lidhje me cilësinë e programeve dhe përmirësimin.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.5




Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ referuar DVV dhe webit zyrtar të KUB, konstaton se rregullore e NJSBC, përbërja e NJSBC si raporti i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p>Nga informacioni që GVJ siguroi nga webi zyrtar, rezultojnë se janë publike edhe raportet e pyetësorëve të IQE dhe raporti i pyetësorëve që KUB realizon për monitorimin e cilësisë, si dhe raportet vjetore të KUB.</p> <p>https://kub.edu.al/lajme/pyetesoret-e-studenteve-njsbc/ https://kub.edu.al/njsbc/ https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rregullore e NJSBC, Plani i punës së NJSBC dhe raporti vjetor i KUB, raportet vjetore të pyetësorëve të studentëve, rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare. Raporti, respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>https://kub.edu.al/lajme/pyetesoret-e-studenteve-njsbc/ https://kub.edu.al/njsbc/ https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Ky raport rezulton të ketë të përcaktuara edhe masat edhe rekomadimet për përmirësim të mëtejshëm në nivel institucioni,</p> <p>GVJ konsultoi disa raporte, raportin vjetor të institucionit, raportin e NJSBC, raportin e pyetësorëve të IQE, që një nga çështjet që trajton kanë sigurimin e cilësisë. Raporti i NJSBC, përmban analizë përshkruese të rezultateve të anketimeve, ai shoqërohet me përfundime si dhe rekomandime.</p> <p><i>Evidenca 41. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf</i></p> <p>https://kub.edu.al/lajme/pyetesoret-e-studenteve-njsbc/ https://kub.edu.al/njsbc/ https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, raporton në mënyrë të vazhdueshme, për procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, në të cilën adresohen edhe rekomandime mbi gjetjet e sondazhit të studentëve. GVJ konstatoi se KUB ka hartuar edhe një plan masash për përmbushjen e rekomandimeve si dhe një raport për përmbushjen e tyre. Zbatimi i këtij plani masash ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 20. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidenca. 20.1. Vendimi i Senatit Akademik të KUB për miratimin e raportit vjetor të Vitit Akademik 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidenca. 21. Shkresa dërguar Ascal për përmbushjen e rekomandimeve.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 28.1. Raporti Vjetor i Punës Kërkimore Shkencore dhe Projektet, Kolegjit Universitar i Biznesit.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me strukturat drejtuese rezulton se KUB, nëpërmjet strukturave drejtuese, njësive kryesore apo/edhe njësisë bazë, organizon veprimtari me stafin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, nëpërmjet promovimit të pjesëmarrjes në trajnime, për akreditimin institucional dhe atij programor.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ është e mendimit se proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, janë publike dhe transparente dhe synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë së PS në Bachelor në “Ekonomi”.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Ekonomi”,
me profil: “Administrim Biznesi” dhe “Finance Kontabilitet”, ofruar nga Institucioni i
Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “I Biznesit”**

1. Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” dhe “Finance Kontabilitet” ofruar nga KUB, është konceptuar dhe realizohet në përputhje me kërkesat e Legjislacionit të Arsimit të Lartë në fuqi, duke respektuar dhe nxitur lirinë akademike.
2. Strukturat drejtuese në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë, demonstrojnë motivim të lartë, angazhim dhe mbështetje që programi i studimit Bachelor “Ekonomi”, me profil: “Administrim Biznesi” dhe “Finance Kontabilitet”, të realizojë objektivat dhe të jetë atraktiv për studentët dhe orientimin e tyre në tregun e punës.
3. Infrastruktura fizike cilësore, inovative dhe efektive në shërbim të studentëve dhe stafit akademik.
4. Staf akademik efektiv dhe me kontrata me eksperiencë, i motivuar dhe i angazhuar, i orientuar drejt kulturës së cilësisë.
5. Shërbime mbështetëse efektive për stafin dhe studentët
6. Mbështetje financiare për studentët, nëpërmjet bursave të meritës dhe atyre sociale
7. Sistemi dhe strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë, efektive. Instrumentet e aplikuara nga institucioni i shërbejnë krijimit të kulturës së cilësisë në rang institucional.
8. Në mbështetje të veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve të KUB, ofrohet revista shkencore si dhe organizohen konferenca ndërkombëtare, kombëtare dhe studentore të përvitshme të cilat janë të publikuara edhe në website zyrtar të KUB.
9. Në kuadër të ndërkombëtarizimit vlerësohet me rëndësi realizimi i diplomave të dyfishta me Webster University.
10. Bashkëpunimi i pasur i Institucionit me shoqata dhe rrjete profesionale të fushës garanton maksimumin e cilësisë përsa i përket përmirësimit në vijimësi të programit të studimit.
11. Institucioni angazhohet në trajnime të vazhdueshme të stafit dhe studentëve në kuadër të marrëveshjeve të shkëmbimit Erasmus + me partnerë të tjerë jashtë vendit.
12. Institucioni garanton qëndrueshmërinë e stafit dhe personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.
13. Studentëve dhe stafit akademik të KUB u ofrohet akses online pa pagesë në bibliotekat virtuale JSTOR etj.
14. KUB, disponon burime financiare të qëndrueshme dhe garanton në vijimësi mbështetjen dhe ecurinë normale të programit të studimit.
15. Institucioni ka një një numër të lartë marrëveshjesh dhe bashkëpunimesh me një sërë institucionesh publike dhe biznese private, që mundësojnë kryerjen e praktikës profesionale dhe mundësi punësimi për studentët. Gati mbi 90% e studentëve të këtij program janë të punësuar.

Pika të dobta

1. KUB është ende në proces të implementimit të sistemit të integruar të informacionit.
[[Standardi V.6, Kriteri 2]]



2. NJSBC ka përfaqësues vetëm të aktorëve të brendshëm të institucionit. [(Standardi VI.4, Kriteri 1)]

Rekomandime

1. GVJ sugjeron intensifikimin e procesit për zbatimin e sistemit të integruar të menaxhimit elektronik të informacionit, megjithëse kane funksional sistemin e Portalit KUB. [(Standardi V.6, Kriteri 2)]

2. GVJ sugjeron që në përbërje të NJSBC, të jetë një ekspert i jashtëm nga i cili institucioni mund të marrë sugjerime për përputhshmërinë e programeve të studimit me kërkesat e biznesit vendas dhe të tregut të punës. [(Standardi VI.4, Kriteri 1)]

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Economy" with profile: "Business Administration" and "Finance-Accounting", provided by the Higher Education Institution "KUB"

Strengths and affirmations

1. The Bachelor study program in "Business Administration" and "Finance Accounting" offered by KUB, has been conceived and implemented in accordance with the requirements of the higher education legislation in force, respecting and promoting academic freedom.
2. The leadership structures at the main unit and base unit levels, demonstrate high motivation, commitment, and support for the Bachelor's degree program in 'Economics', with profiles in 'Business Administration' and 'Finance and Accounting', to achieve its objectives and be attractive to students and their orientation in the job market.
3. Quality, innovative and effective physical infrastructure at the service of students and academic staff
4. The full-time and part academic staff, experienced, motivated and committed, oriented towards the culture of quality.
5. Effective support services for staff and students
6. Financial support for students, through merit and social scholarships
7. Effective internal quality assurance system and structures. The instruments applied by the institution serve to create a culture of quality at the institutional level.
8. In support of the scientific research activities for KUB academic staff and students, is offered a scientific journal as well as international, national and student annual conferences are organized which are also published on the official website of KUB.
9. Within the framework of internationalization, the achievement of double degrees with Webster University is highly valued.
10. The rich cooperation of the Institution with associations and professional networks in the field guarantees maximum quality in terms of continuous improvement of the study program.



11. The institution engages in continuous training of staff and students within the framework of Erasmus + exchange agreements with other abroad partners.
12. The institution guarantees the stability of the staff and academic personnel engaged in this study program.
13. KUB students and academic staff are offered free online access to JSTOR virtual libraries etc.
14. KUB has stable financial resources and guarantees ongoing support and normal progress of the study program.
15. The institution has a high number of agreements and collaborations with a number of public institutions and private businesses, which enable professional practice and employment opportunities for students. Almost over 90% of the students of this program are employed.

Weaknesses

1. CUB is still in the process of implementing the integrated information system. [(Standard V.6, Criterion 2)]
2. IQAU has representatives only of internal stakeholders of the institution. [(Standard VI.4, Criterion 1)]

Recommendation

1. EEG suggests intensifying the process to implement the integrated electronic information management system, however the system "Portal KUB" is functional. [(Standard V.6, Criterion 2)]
2. EEG suggests that part of the IQAU, to be an external expert from whom the institution can receive suggestions for the compatibility of the study programs with the requirements of the local business and the labor market. [(Standard VI.4, Criterion 1)]



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

